

Bassam Saeh




GJUHA E MREKULLUESHME E KURANIT

Dëshmi e origjinës hyjnore





GJUHA E MREKULLUESHME E KURANIT
Dëshmi e origjinës hyjnore



Bassam Saeh

Gjuha e mrekullueshme e Kuranit: Dëshmi e origjinës hyjnore (Albanian)

Titulli original

The Miraculous Language of the Qur'an: Evidence of Divine Origin

Copyright © 2015 The International Institute of Islamic Thought, Herndon

Botimi i parë në gjuhën shqipe. Copyright © 2020 The International Institute of Islamic Thought, Herndon

Ky libër është e drejtë e autorit. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe në dispozitat e marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, asnjë riprodhim i asnjë pjese nuk mund të bëhet pa lejen me shkrim të botuesve.

BOTUES: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, www.aiitc.net

PËRKTHIMI: Roald Hysa, Armanda Hysa

REDAKTIMI SHKENCOR: Alban Kodra

KORREKTIMI LETRAR: Oriola Sula

FAQOSJA DHE DIZAJNI: Suhejb Xhemaili

SHTYTPUR NGA: Shtypshkronja dhe Shtëpia Botuese

'Mileniumi i Ri'

Autostrada Tiranë - Durrës, km 26

Cel: +355 672063702

Email: info@milenumiri.al

Web: www.milenumiri.al

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Saeh, Bassam

Gjuha e mrekullueshme e Kuranit : dëshmi e origjinës hyjnore /

Bassam Saeh ; përkth. Roald Hysa, Armanda Hysa ; red. shkenc.

Alban Kodra. - Tiranë : AIITC, 2020

107 f. ; 21 cm.

Tit. origj.: The miraculous language of the Qur'an : evidence of divine origin

ISBN 978-9928-126-33-7

1.Kurani 2.Gjuha arabe 3.Stilistika

811.411.21 '38 :28 -23

Bassam Saeh



Gjuha e mrekullueshme e Kuranit

Dëshmi e origjinës hyjnore

Përkthimi:

Roald Hysa, Armanda Hysa



Tiranë, 2020



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Dy fjalë..... | 7 |
| Parathënie / Pagabueshmëria e Kuranit..... | 11 |
| Gjuha e mrekullueshme e Kuranit - Dëshmi e originës hyjnore..... | 15 |
| Hyrje | 15 |
| Mrekulli apo thjesht gjeni..... | 19 |
| Kuptimi i termit ixhaz (i mrekullueshëm) për mendimtarët e hershëm islamë..... | 21 |
| Ndikimi i risisë së Kuranit tek arabët e ditëve të Profetit (a.s.) | 25 |
| Shkalla e vërtetë e mrekullisë e manifestuar në risinë gjuhësore të Kuranit | 26 |
| Frekuenca e mrekullueshme e risive kuranore..... | 28 |
| Efekti hutues i strukturës së re ritmike te dëgjesit e parë arabë të Kuranit..... | 30 |
| Një makinë për të më kthyer në kohë | 31 |
| Tre fjalorë: fjalori kuranor, ai paraislam dhe fjalori profetik | 33 |
| Revolucioni i ri gjuhësor | 34 |
| Personaliteti kuranor i sureve..... | 36 |
| A mbivendosen karakteret e sureve? | 37 |
| Karakter i unik i Kuranit | 39 |
| Formulimi i ri gjuhësor..... | 42 |
| Pjesa më e madhe e formave gjuhësore kuranore nuk përsëriten..... | 43 |

| | |
|---|-----|
| Ndërtimet kuranore unike dhe intensive | 45 |
| Modelet gjuhësore kuranore: natyra dhe përbërja e tyre | 48 |
| “Atëherë, krijo një sure të ngjashme me këtë!” (Kuran, 10:38)..... | 51 |
| Modelet që shënjuan të folurën profetike | 52 |
| Risia e ndërtimit dhe e shprehjes | 54 |
| Ndërtimi i strukturës kuranore (<i>Tarkib</i>)..... | 55 |
| Fjalët e veçanta dhe mrekullia e kombinimit të risisë me qartësinë | 61 |
| Rëndësia e termave të reja që gjenden në Kuran | 63 |
| Fjalët e reja të sures El Muddeththir | 67 |
| Përdorimi i ri i pjesëzave në suren El Muddeththir | 68 |
| Rikonfigurimi i njësisë gjuhësore | 71 |
| Gjendja e re e lidhëzave tradicionale..... | 72 |
| Marrëdhëniet e reja mes fjalëve | 75 |
| Repertori i ri kuranor i figuracionit letrar..... | 76 |
| Figura letrare me shumë përmasa..... | 79 |
| Figura hipotetike | 80 |
| Llojet e figurave letrare në suren El-Muddeththir (74) | 81 |
| Gjuha e hapur..... | 91 |
| Shembuj të “gjuhës së hapur” në suren El-Muddeththir..... | 96 |
| Leximet e ndryshme kuranore të gjuhës “së hapur” | 98 |
| Gjuha e hapur dhe zbulimet shkencore | 100 |
| Burimet dhe bibliografia e përzgjedhur..... | 105 |
| Burimet në gjuhën arabe | 105 |
| Burimet në gjuhën angleze | 106 |



Dy fjalë

Muslimanët janë të urdhëruar, së bashku me pjesën tjetër të njerëzisë, “të lexojnë” dhe të meditojnë për mesazhin e Kuranit dhe të reflektojnë mbi origjinën e tij si një shpallje hyjnore. Në këtë studim tërheqës autori është përpjekur të sqarojë aspektet e shumta gjuhësore të mrekullueshme të tekstit të shenjtë dhe se pse bukuria dhe përsosmëria e tij ishte krejtësisht e re dhe mahnitëse për veshët e arabëve së shek. VII, të mbetur pa fjalë nga admirimi në dëgjimin e vargjeve të tij, të recituara për herë të parë nga Profeti (s.a.u.s.)¹. Si mjeshtër të arabishtes dhe kështu, në një farë kuptimi, të trajnuar për të dëgjuar dhe vlerësuar Kuranin, përshtypjet e tyre mund të bëhen vëllime.

Po, Shpallja është shumë e bukur në brendi dhe vetë ajo, por Kurani natyrisht që është më shumë se kaq. Pa teprime, gjenia e gjuhës së vet, eleganca, ritmi, shëmbëlltyrat e pasura, rrjedhshmëria, ndërthurja e metaforave dhe e koncepteve të veta, stilet e tij të ndryshme e të shumta, të padëguara më parë, dhe teknikat e prozës, po aq sa edhe përdorimi i shquar i fjalorit, e bëjnë atë një vepër të përkryer përjetësisht. Ai e preku menjëherë dhe fuqimisht intelektin dhe sjelljen njerëzore, duke e

1 Sal Allahu alejhi ue selem - Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të. Kjo thuhet kurdoherë që përmendet emri i Profetit Muhamed (a.s.).

transformuar në mënyrë spektakolare gjuhën arabe dhe duke sjellë në ndërgjegjen e njeriut një vizion madhështor, duke e drejtuar vëmendjen e tij në gjërat më të larta. Janë disa nga këto tipare, që ky punim përpiqet të shpjegojë dhe të nxisë. Autori dukshëm i ka dhënë përparësi çështjes së këtij subjekti dhe kontributi i tij përqendrohet në thelbin e pyetjes, se çfarë e bën saktësisht Kuranin gjuhësisht të mrekullueshëm?

Ky punim është përkthimi në anglisht i botimit të shkurtuar original në arabisht të librit me titull *El-Muxhizeh*, vëllimi I, IIIT, 2012. Ai i drejtohet lexuesit të zakonshëm, kështu që njohja e arabishtes nuk është thelbësore për të kuptuar çështjet e morfologjisë dhe teknikat e tjera gjuhësore që diskutohen, megjithëse aftësia e leximit në arabisht do të ishte e dobishme, edhe pse nuk kërkohet. Në përpjekje për të zgjidhur sekretet e kompozimit dhe gjuhës së tij, Bassam Saeh i udhëzon lexuesit të vlerësojnë bukurinë e Kuranit, të zhyten më tepër në të dhe të kenë një kuptim më të kthjellët të strukturës dhe rrjedhës së tij. Duke i përkushtuar një vëmendje të posaçme sures El Muddeththir, kreu 74, për të përforcuar analizën e tij, ai e sjell në jetë kështu Shpalljen, për të tre-guar që secila sure ka tipare dhe karakteristika të dallueshme, që e bëjnë atë jashtëzakonisht unike, brenda konstruktit dhe në tërësi.

Asnjë shpjegim në vetvete nuk është i mjaftueshëm për një kuptim të plotë të Kuranit. Por ky punim është një shoqërues i nevojshëm në kërkimin e një kuptimi më të mirë dhe një lidhjeje më të ngushtë me tekstin e shenjtë. Përkthimi i përdorur është kryesisht "Mesazhi i Kuranit" i Muhamed Asadit, gjithashtu edhe nga "Kuptimet e Kuranit të Shenjtë", të Abdulla Jusuf Aliut. Datat e cituara sipas kalendarit islam hixhri, etiketohen si AH. Përndryshe, ato ndjekin kalendarin gregorian dhe janë të etiketuara CE, aty ku janë të nevojshme. Fjalët arabisht janë bërë me kursive, përveç atyre që kanë hyrë në përdorimin e zakonshëm. Shenja diakritike u janë shtuar vetëm atyre emrave që nuk janë konsideruar bashkëkohorë.

IIIT, i themeluar më 1981, ka shërbyer si një qendër kryesore për të lehtësuar përpjekjet diturore serioze, të bazuara në principet, vlerat dhe vizionet islame. Programet e kërkimit, seminarët dhe konferencat e Institutit, përgjatë tridhjetë viteve të fundit, kanë rezultuar me botimin e më shumë se katërqind e pesëdhjetë titujve në anglisht, arabisht dhe në gjuhë të tjera kryesore. Ne i shprehim falënderimet dhe mirënjohjen tonë autorit Bassam Saeh për bashkëpunimin përgjatë fazave të ndryshme të prodhimit. I jemi mirënjohës gjithashtu, përkthyeses Nensi Roberts dhe stafit editorial e prodhues të zyrës së Londrës IIIT, si dhe të gjithë atyre që janë përfshirë drejtpërdrejt ose jo në kompletimin e këtij botimi.

Zyra e IIIT Londër
Maj 2015



“Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti”. (Kuran, 2: 32)²

Parathënie Pagabueshmëria e Kuranit

Fakti që Kurani është një kryevepër letrare, është jashtë diskutimit. Fakti që ai ka një gjuhë unike, të përkryer e të pakrahasueshme, stili, elokuence dhe fuqie, në të cilën populli i Gadishullit Arab i shek. VII nuk kishte hasur kurrë më parë dhe që nuk ishte ndeshur asokohe, është gjithashtu një çështje përtej diskutimit. Megjithatë, ajo që debatohet, është fakti, nëse është i mrekullueshëm ose jo. Me fjalë të tjera, nëse është i këtij dimensionit, apo i një tjetri hyjnor. Provat e atij autoriteti hyjnor shpërfaqen në nivelet shumëdimensionale dhe vazhdimisht në rritje të dijes, ndërsa njerëzimi evoluon dhe i vazhdon shekujt e tij me vlerësimin e gjatë të shkrimeve. Por për qëllimet e këtij studimi, është një element i veçantë i fjalëve të Kuranit, deri tani i pakuptuar plotësisht, i cili është sjellë në vëmendjen tonë, që vërteton faktin se ai është një mrekulli gjuhësore me origjinë hyjnore.

2 Në këtë përkthim, në disa raste, kemi përdorur versionin shqip të Kuranit të Madhërishtëm, nga Prof. Hasan I. Nahi, botim i AIITC, ndërsa në raste të tjera kemi përkthyer vetë nga anglishtja, për shkak të domosdoshmërisë së interpretimit studimor.

Diferencimi i gjuhës kuranore nga gjenia njerëzore, është një mënyrë tjetër për të shpallur qartësisht, se Profeti (a.s.) ishte thjesht një kanal për të përhapur mesazhin përmbyllës të Zotit, saqë deri edhe mendjet plot dhunti, apo ato jashtëzakonisht të talentuara në artet e letërsisë, oratorisë dhe të poezisë, nuk mund të prodhonin një kapitull të vetëm “të ngjashëm me të” (Kuran, 10:38). Ky pohim i sigurt kuranor për të provuar deklarinimin e tij si fals, është jo vetëm një apel tërësisht intelektual dhe një sfidë e hapur për kritikën, duke tërhequr rastësisht vëmendjen ndaj rëndësisë së logjikës deduktive shekuj më herët sesa koha e saj. Por është, gjithashtu, fantastik për thjeshtësinë absolute me të cilën ai paraqet këtë sfidë të madhe.

Cila ka qenë përgjigja? Dy fakte të rëndësishme në lidhje me sfidën kuranore, i kanë qëndruar provimit të kohës dhe mbetet një problem sëmbues për ata që ia njohin autoritetin e tij gjuhësor, por që nuk e zgjidhin dot origjinën e tij hyjnore. Këto janë pjesë integrale të çdo debati, por shpesh, për leverdi, të anashkaluara nga kritikët:

1. Asnjë gabim i vetëm, i çdo tipi, nuk është gjendur në mbi gjashtë mijë vargje (jo për mungesë përpjekjeje).
2. Pavarësisht nga përpjekjet e shumta historike të nxitura, disa në tallje të drejtpërdrejtë me Profetin (a.s.) dhe disa të tjera të ndershme, nga autoritete udhëheqëse në arabisht (duke pasur parasysh që koha e Profetit (a.s.) dëshmon për përfaqësuesit më të mirë të gjuhës arabe, që bota ka parë ndonjëherë), e deri në ditët tona, e gjithë kjo përpjekje ka qenë as më pak e as më shumë, sesa krejtësisht e kotë dhe turpëruese.

Dhe, në këtë pikë, nuk po i referohemi thjesht gjuhës, sepse, qoftë për herë të parë, apo pas leximesh të panumërta, do ta kishim të vështirë të përcaktonim vetëm një faktor që e bën Kuranin krejtësisht unik. Një nga cilësimet për njësimin e Kuranit është

paimitueshmëria dhe për qëllimet e këtij studimi paimitueshmëria e gjuhës së Kuranit shënjon një aspekt domethënës të autorësisë së tij hyjnore dhe, së këndejmi, një mrekulli thelbësore që analizohet me kuptimin e qartë, natyrisht, se gjuha studiohet për të arritur një vlerësim më të thellë të mesazhit kryesor të Kuranit. Në thelb, idetë, këndvështrimet dhe bota ku e zhyt Kurani njeriun, ndjesitë e lartësuara të virtyteve morale dhe të besimit të sinqertë, filtrat e vetëvlerësimit, nëpërmjet të cilave ai i kërkon njeriut të vlerësojë veprimet dhe motivet e tij të vërteta, janë fuqimisht domethënëse në termat e vigjilencës me të cilat ne duhet të kuptojmë realitetin dhe vendin tonë në kozmos, si dhe Gjyqin e Fundit, i cili do të vijë atëherë kur iluzioni i kësaj jete dhe të gjitha ekzistencat fizike do të shuhen.

Dijetarët muslimanë, përgjatë historisë, kanë shpjeguar elementet estetike të gjuhës së mrekullueshme të Kuranit dhe faktorë të tjerë letrarë, përmbajtjen dhe ajetet mahnitëse shkencore. Sidoqoftë, sipas autorit, askush nuk është përpjekur të hedhë dritë në atë që ai e emërton si një aspekt sekret të gjuhës së tij, diçka që, për shkak të familjaritetit me Zbulesën, ne kemi menduar pak për të, me kalimin e kohës. Ai sekret është thjesht ky: dihet që Kurani u shpall në gjuhën arabe, megjithatë, në të njëjtën kohë, ishte një arabishte e re që i mahnitë arabët të cilët e dëgjuan për herë të parë. Sa ishte e re, ky është subjekt i këtij punimi.

Prandaj dëgjuesit e parë dhe të hershëm muslimanë iu përgjigjën fjalëve, tingujve dhe ritmeve të Kuranit në një mënyrë të qëndrueshme, me një vlerësim shumë të thellë për bukurinë dhe madhështinë e tij. Diçka që veshët tanë modernë, të zbutur nga familjariteti, edhe pse të rrethuar nga të gjitha llojet e studimeve dhe fjalorëve, shpesh nuk e kapin dot. Autori përpiqet ta heqë këtë vello disi dhe ta fusë lexuesin përsëri te Kurani me sy të freskuar, duke sjellë në jetë diçka nga kjo mrekulli. Megjithëse gjuha e mrekullueshme e Kuranit është pranuar pa diskutim nga muslimanët, prapë se prapë, një studim sistematik që ta provojë

këtë besim, nëpërmjet një studimi metodik të gjuhës së tij, me sa ka dijeni autori, deri tani nuk është ndërmarrë. Kështu që ai përpiket ta provojë shkencërisht, përmes krahasimit ndërmjet gjuhës kuranore nga njëra anë, dhe gjuhës së poezisë para-islame, fjalëve të Profetit (haditheve) dhe gjuhës së arabëve të së tashmes dhe së shkuarës, nga ana tjetër. Gjithashtu, kërkon të tregojë se një fije e rëndësishme e mrekullisë gjuhësore kuranore është fakti që kjo arabishte është krejtësisht e re.

Studimi përpiket, në mënyrë empirike, të provojë që arabët nuk e dinin këtë gjuhë përpara Kuranit dhe nuk mundën ta përsërisnin më pas atë. Ndërsa gjuha e Profetit (a.s.), pavarësisht rrjedhshmërisë së saj, ishte e kapshme dhe e imitueshme, thjesht sepse ajo është, para së gjithash, gjuha e një qenieje njerëzore, ku rezultati i pafat i kësaj qenieje është një ndërthurje e stërmadhe e haditheve autentike dhe të sajuara. Kjo nuk ka ndodhur kurrë me Kuranin dhe nuk ka për t'i ndodhur atij, gjithashtu një dëshmi tjetër kjo, që Kurani është fjalë e Zotit.

“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë”. (Kurani 15: 9).

Zyra e Londrës IIIT



Gjuha e mrekullueshme e Kuranit - Dëshmi e originës hyjnore

HYRJE

E gjitha nisi më 1989, kur Qendra për Studime Islame e Oksfordit më kërkoi t'u paraqes një numër ligjëratash studentëve britanikë që kërkonin të kuptonin më mirë gjuhën arabe, nëpërmjet Kuranit të Shenjtë. Pasi u përpoqa të përkthej kuptimet e Kuranit në anglisht për studentët e mi, e gjeta veten të mbytur nga pyetjet e tyre sfiduese, përtej kufijve të traditave gjuhësore dhe konvencioneve familjare për interpretuesit dhe gjuhëtarët.

Asokohe ndodhi që unë po redaktoja një libër të shkruar në periudhën andaluziane me një mik dhe orientalist britanik në Institutin Oriental të Universitetit të Oksfordit. Një ditë, miku im më pyeti: “- Cila është korrekte në arabisht: *ma zala* apo *la zala*?”. Pa u menduar gjatë, u përgjigja: “- *Ma zala*”. Megjithatë, pas disa diskutimesh, ai këmbënguli që *la zala* ishte korrekte, ndërsa unë këmbëngulja për *ma zala*. Në fund, ai më befasoi, kur tha: “- Mirë, atëherë, ose je ti gabim, ose është Zoti! Në fund të fundit, Kurani përdor vetëm *la zala*!”

Për një moment, mbeta pa fjalë. Atëherë përmblodha të gjithë arsenalin tim dhe ia ktheva: “- Po si do ta përktheje foljen

kana në arabisht?" Ai u përgjigj pa hezituar: "- Ishte". "- Nëse është kështu - vazhdova unë, - si do ta përktheje frazën vijuese nga Kurani: *ue kana Allahu gafuran rahima?*" "- Dhe Zoti është Mëkatfalësi, i Shumëmëshirshmi", - u përgjigj i sigurt si më parë. "- Ku është folja *kana* në këtë përkthim?" - i kërkova unë. Por ai nuk mund të më përgjigjej, përderisa e vetmja folje që mund të përdoret për të përkthyer këtë fjali, është "është", e cila mund të jetë e barasvlershme me *jekunu* ose *inna* në arabisht, por jo me formën e kohës së shkuar të foljes *kana*.

Kurani ka përdorime unike gjuhësore, të cilat ndryshojnë nga përdorimi ynë njerëzor i gjuhës, formal dhe joformal. Askush, deri edhe vetë Profeti Muhamed (a.s.), nuk e ka përdorur ndonjë herë kohën e shkuar të foljes *kana* me kuptimin "është". Sidoqoftë, ky lloj përdorimi shfaqet 190 herë në Kuran. Kur iu ktheva Kuranit për të verifikuar atë që më kishte thënë miku im orientalist për *ma zala*, u befasova kur pashë se ajo çka kishte thënë ai, nuk ishte e saktë dhe se Kurani e përdor pjesëzën mohore *ma* vetëm në kohën e shkuar, që është *ma zala*, dhe pjesëzën mohore *la* vetëm me kohën e tashme, ashtu si në frazën *la jezalu*. Së këndejmi, ne nuk e gjejmë as *la zala*, as *ma jazalu*, asgjëkund në Kuran. Megjithatë, befasia më e madhe që hasa, ishin mënyrat e përdorimit kuranor të foljeve në të dyja format e saj, të shkuarës *zala* dhe të tashmes *jezalu*, që ndryshojnë nga përdorimi ynë njerëzor i tyre. Kur ne themi *ma zala al-mataru jahtulu*, që fjalë për fjalë, do të thotë: shiu nuk ka pushuar së rëni, dëgjuesi e kupton këtë formulim, se do të thotë që po binte shi më herët dhe se po vazhdon të bjerë shi në atë moment. Përdorimi i shprehjes *ma zala* kështu, na jep kuptimin që përfshin të shkuarën dhe të tashmen, por jo të ardhmen. Ky është përdorimi i zakonshëm njerëzor i pranuar i kësaj foljeje. Sidoqoftë, fraza në kohën e shkuar *ma zala*, në të dy vargjet e vetme kuranore në të cilat shfaqet, përfshin vetëm të shkuarën. Me fjalë të tjera, jep ndjesinë e diçkaje që vazhdon në të kaluarën, por që nuk vazhdon në të tashmen. Vargjet janë si në vijim:

“Këto rënkime të tyre nuk pushuan (*ma zalat tilke da’uahum*), derisa Ne i palosëm si drithë i korrur”. (Enbija, 21:15).

“Shumë kohë më parë, ju pati ardhur Jusufi me prova të qarta, por ju nuk reshtnit së dyshuari në atë që ai ju kishte sjellë (*ma ziltum fi shekkin mimma xha’ekum bihi*). E, kur ai vdiq, ju thatë: “Allahu nuk do të nisë më të dërguar pas tij!” (Gafir, 40:34).

I pari nga këto dy vargje do të thotë që njerëzit vazhdonin të rënkonin, derisa ata u shkatërruan, dhe e gjitha kjo ndodhi në të shkuarën. Ndërsa vargu i dytë do thotë se populli i kohës së Jusufit u kap pas dyshimeve në lidhje me mesazhin e tij, derisa ai vdiq. Edhe kjo gjithashtu, ndodhi krejtësisht në të shkuarën. Në të dyja këto raste, veprimi në fjalë filloi dhe mbaroi në të shkuarën, dhe nuk u shtri brenda sferës së të tashmes.

Sa për përdorimin kuranor të frazës në kohën e tashme *la jezalu*, ajo përfshin të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Çfarëdolloj veprimi që po i referohet se po bëhet në të shkuarën, po vazhdon të bëhet edhe në të tashmen dhe do të vazhdojë të bëhet edhe në të ardhmen. Ky fenomen semantik është i vëzhgueshëm në të tri vargjet vijuese:

“(Armiqtë tuaj) nuk do të reshtin së luftuari kundër jush (*la jezalune jukatilunekum*), derisa të mund t’ju kthejnë nga besimi juaj, nëse do të munden”. (Bekare, 2: 217)

“Ndërtesa që ata kanë ndërtuar, nuk do të reshtë së qeni (*la jezalu bunianuhum ul-ledhi banau*) burim turbullimi në zemrat e tyre, derisa zemrat t’u shkërmoqen në copëza”. (Teube, 9: 110).

“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, por (Ai dëshiroi ndryshe dhe kështu) ata vazhdojnë të kenë këndvështrime të ndryshme (*ue la jezalune mukhtelifin*), përveç atyre të cilëve Zoti yt i ka mbuluar me hirin e Tij”. (Hud, 11: 118-119).

Takimet intelektuale me “Tjetrin”, që po zhvillohen në Perëndimin modern, nxitën vendimin tim për të rishqyrtuar leximin tim

të zakonshëm të Kuranit. Ky lexim më ishte mpirë nga efektet e rrezikshme të familjaritetit dhe të përsëritjes së përditshme, të cilat na pengojnë të shohim shumë nga ajo që përjetuan dhe kuptuan arabët e ditëve të Profetit (a.s.), kur ata dëgjuan vargjet e para që kishin filluar t'i zbrisnin njëri pas tjetrit të Dërguarit të Zotit. Këta pranues të hershëm të Kuranit u tronditën dhe u hutuan nga risia e tij, përderisa gjetën tek ai një stil që ishte i largët nga gjithçka me të cilën ata kishin qenë të familjarizuar. Kjo tronditje dhe hutim, më pas, u kthye në pyetje kritike: Çfarë po ndodh përreth meje? Çfarëdo qoftë, ajo duhet të jetë shumë larg dhe vendimtare, për të qenë stili i dallueshëm i një shkrimtari të ri, i një poeti në ngjitje, ose i një mëtuesi fatthënës.

Në vëllimin e parë të këtij libri përpiqem t'i fus lexuesit e këtij sekreti kuranor sa më butë dhe me kujdes që është e mundur. Në këtë mënyrë, nxjerr në pah ndryshimet që Kurani paraqiti në kornizën gjuhësore të gjuhës arabe, duke e prezantuar çdo element të ri me një shpjegim të imtësishëm për natyrën dhe tipat e tij. Mbështetja tekstuale merret nga sure të ndryshme të Kuranit, me një vëmendje të posaçme që i përkushtohet sures El Muddeththir, një nga suret më të hershme, dhe mënyrat me të cilat ajo u përplas me konvencionet gjuhësore arabe. Shumë krerë në këtë pjesë merren pjesërisht me aspektet e saposhaqura gjuhësore, gramatikore dhe retorike të kësaj sureje.

Në vëllimin e dytë zbatohet fenomenin e diskutuar në vëllimin e parë, për secilën sure të Kuranit në veçanti. E nis me suret më të shkurtra dhe të kënduara më shpesh, pra me suren El Fatiha (I). Pastaj merrem me njëzet suret e fundit, duke nisur nga sure Nas, 114; suren Felek, 113; suren Ihlas, 112 e kështu me radhë, duke ecur mbrapsht te surja Tin, 95.

Pavarësisht nga natyra e padyshimtë pioniere e punimit që i kemi hyrë, pa u kufizuar nga tendenca e gjatë për të errësuar natyrën e vërtetë të inovacionit gjuhësor që e karakterizon Kuranin, një hulumtuesi të hollë nuk duhet t'i humbasë nga

vështrimi fakti se, pa marrë parasysh se çfarë formash apo qasjeje objektive merr çdo lloj interpretimi njerëzor ose analize gjuhësore e Kuranit, apo çdo lloj zbulimi i mrekullisë së tij, qoftë në sferën e retorikës, gjuhës apo shkencës, është një proces i peshimit të mundësive, që doemos mbeten subjekt i mundësisë së gabimit njerëzor. Së këndejmi, gjithçka që propozojmë në këtë drejtim, nuk është më tepër sesa një përpjekje e sinqertë për t'iu qasur së vërtetës absolute, të cilën, në fund të fundit, ne e gjejmë veten të paaftë për ta arritur, për aq kohë sa merremi me pafundësinë, hyjnoren dhe të mrekullueshmen, të armatosur me asgjë tjetër, përveçse me aftësitë tona të dobëta dhe të kufizuara.

MREKULLI APO THJESHT GJENI

Në të gjithë jetën time kam pasur besimin e prerë në mrekullinë e gjuhës së Kuranit. Në fillim e kisha këtë besim, në sajë të të qenit musliman, megjithëse, në të vërtetë, isha i paaftë për të vlerësuar këtë mrekulli me arsytën time. Më mungonin aftësitë për ta dalluar qartë atë me mjetet primitive të kërkimit që zotëroja. Sidoqoftë, në gjuhën e Kuranit pashë një bukuri magjepsëse, shprehi të pakufishme, rrjedhshmëri, ritëm, magji dhe shkëlqim. Ajo që nuk arrita të kuptoja, ishte që këto cilësi ishin një gjë, dhe kjo mrekulli ishte diçka tjetër, diçka më e thellë, më e paarritshme, më delikate dhe shumë më përtej arritjes njerëzore. Gjithmonë kam qenë i kënaqur me shpresën se, sapo, të arrija zotërimin e duhur të retorikës arabe, do të isha i aftë të identifikoja mrekullinë në Kuran, që asnjë nga librat që kisha lexuar, nuk kishte qenë i aftë ta tregonte për mua, në një mënyrë të pafuzueshme shkencore.

Autorët e librave të tillë, natyrisht që e kishin përdorur fjalën "Ixzaz" (Mrekulli) në titujt e tyre. Sidoqoftë, të gjithë këta

libra kishin folur përreth elokuencës, shkëlqimit, bukurisë dhe saktësisë së shprehjes së Kuranit. Të gjitha këto janë veçori që ne mund t'i gjejmë në një shkallë apo tjetër, në punimet letrare të prodhuara në gjuhë të ndryshme dhe nga popuj të ndryshëm të botës. Mund të mendojmë për gjenitë e shumtë, të cilët e kanë mbajtur botën të magjepsur me krijimet e tyre artistike, letrare dhe intelektuale. Por çfarëdojloj përshkrimi të meritojnë krijime të tilla, asnjë prej tyre nuk mund të përshkruhet me të drejtë, si e mrekullueshme. Përse atëherë këmbëngulim për ta veçuar vetëm Kuranin me këtë përshkrim? Ku është mrekullia në Kuran, nëse ajo përkufizohet si diçka që e tejkalon aftësinë njerëzore? Të marra të gjitha së bashku, veçoritë e ndryshme të këtyre krijimeve fisnike mund ta kufizojnë mrekullinë. Megjithatë, edhe kjo nuk do të mjaftonte për të treguar në një mënyrë të pafuzueshme shkencore mrekullinë, ekzistencën e së cilës ne shpresojmë ta zbulojmë.

Më vonë, në jetën time, pasi kreu studimet universitare në arabisht, u ballafaqova me të njëjtën pyetje pa përgjigje. Më pas, u kompletova me një Master të ndjekur nga një PHD (doktoratë) në Letërsinë arabe. Përsëri e gjeta veten të paafte për të shikuar aspektin e mrekullueshëm të gjuhës së Kuranit, pavarësisht faktit se nga perspektiva ime, më e pakta isha bërë një kërkues dhe kritik letrar i praktikuar mirë në artet e gjuhës dhe letërsisë.

Ndërsa po kërkoja për bazat e besimit tim në mrekullinë e Kuranit, vazhdimisht përballesha me një dilemë metodologjike. Përkatësisht, si të pajtoja brenda vetes muslimanin dhe kërkuesin. Apo më thjesht, si do të pajtoja ndjenjën fetare me aftësinë e saj për të dhënë e marrë, besimin tim të natyrshëm në natyrën e mrekullueshme të Kuranit dhe të vërtetën e Islamit e të shkrimeve të tij me analizën hermetike abstrakte shkencore, vendimet e së cilës nuk preken nga emocionet, besimi, interpretimi individual ose paragjykimet. Ku shtrihen kufijtë e pakapshëm mjegullorë ndërmjet gjenisë njerëzore, nga njëra anë, dhe

mrekullisë hyjnore që provohet nga fakte shkencore dhe të dhëna, nga ana tjetër? Po vendimet lidhur me të cilat nuk kanë të bëjnë me parapëlqimin personal, qëndrimin e ndryshueshëm njerëzor, kushtet, mundësitë dhe pritshmëritë?

Pastaj erdhi faza e tretë e jetës sime akademike, kur u gjenda ballë për ballë me pyetjen kokëfortë dhe hutuese: Ku qëndron mrekullia (ixhaz) e gjuhës së Kuranit? Duke ngritur këtë pyetje, përdora fjalën “mrekulli” në kuptimin e saj të vërtetë, jo thjesht në kuptimin e gjenisë, rrjedhshmërisë, shkëlqimit, saktësisë dhe bukurisë. Fillova të pyesja veten, nëse fjala “mrekulli” kishte humbur domethënien e saj reale për ne, duke u kthyer në një term, domethënien origjinale të të cilit ne nuk e kujtojmë më, ose nuk e njohim, dhe që nuk do të thoshte asgjë për ne, përveçse epërsi, përsosmëri ose madhështi.

KUPTIMI I TERMIT IXHAZ (I MREKULLUESHËM) PËR MENDIMTARËT E HERSHËM ISLAMË

Mendimtarë muslimanë nga të dy periudhat, të hershme dhe të vonshme, ndër morën studime të plota dhe të palodhshme të asaj që i referoheshin si mrekullia e Kuranit (ixhaz al-Kur’an). Studime të tilla kanë të bëjnë me tri sfera të ndryshme:

I. Aspekti retorik ose estetik i Kuranit: Studime që merren me këtë aspekt të gjuhës së Kuranit, kanë si qëllim të vërtetojnë se Kurani është një mrekulli estetike në gjuhën dhe kompozimin e tij. Dijetarët e parë që e zhvilluan këtë temë, përfshijnë Xhahidhin (vd. 255 h./869 e.s.), Ebul Hasan Ali al-Rumani (vd. 374 h./984 e.s.), Muhamed ibn Jezid el-Uasiti (vd. 306 h./918 e.s.), Ebu Zejd el-Belkhi (vd. 323 h./934 e.s.), Ebu Hilal el-Askeriu (vd. 395

h./ 1005 e.s.), Hatabi (vd. 378 h./ 988 e.s.), Ebu Bekr Muhamed ibn Tajib el-Bakilaniu (vd. 404 h./ 1013 e.s.), Kadi Abdel-Xhabar el-Asadabadi (vd. 416 h./ 1025 e.s.), Abdel-Kahir el-Xhurxhani (vd. 474 h./ 1078 e.s.), Ibn ebi el-Ishba (vd. 654 h./ 1256 e.s.), Ibn Kajim el-Xheuzije (vd. 751 h./ 1350 e.s.) etj. Sidoqoftë, bukuria mbetet një fenomen relativ, i cili, si i tillë, mbetet subjekt i debatit dhe standardet për të cilin mund të ndryshojnë nga një individ në tjetrin, një shoqëri në tjetrën dhe nga një periudhë në tjetrën. Së këndejmi, na duhet të pranojmë se, nëse virtualisht ndonjë gjuhëtar jomusliman perëndimor do të përshtaste të njëjtat qasje dhe metoda që ndoqën dijetarët muslimanë në studimet e tyre për Kuranin, ai mund të dilte në përfundimin se gjëni si Shekspiri, Dantja, Rusoja dhe Gëtja janë gjithashtu “zota”.

2. Aspekti shprehës: Studime që merren me përmasat shprehëse të Kuranit, synojnë të vërtetojnë që Kurani është një mrekulli gjuhësore, duke u bazuar në saktësinë e tij të të shprehurit. Autorë të studimeve të tilla, diskutojnë dallimet eprore ndërmjet termave, strukturave dhe shprehjeve kuranore, të cilat, megjithëse duken sikur janë të ngjashme, aktualisht nuk janë të tilla. Këto terma, struktura dhe shprehje që njihen ndërmjet dijetarëve si *muteshabih al-Kur’an*, janë vënë në dukje nga Xhahidhi në librin e tij *“El-Bejan uel Tabjin”*. U janë referuar atyre Kadi Abdel-Xhabari në librin e tij *“Muteshabih al-Kur’an”*; Muhamed ibn Abdullah el-Iskafi (vd. 420 h./ 1029 e.s.) në librin e tij *“Durrat el-Tenzil ue Ghurrat el-Teuil”*; Fahrudin Raziu (vd. 606 h./ 1209 e.s.) në *“Esrar el-Tenzil”*; Mahmud ibn Hamzah el-Kirmani (vd. 505 h./ 1111 e.s.) në *“El-Burhan fi Teuxhah Muteshabih al-Kur’an”* dhe të tjerë.

3. Aspekti shkencor: Ndryshe nga ç’besohet gjerësisht, kjo temë nis të shfaqet mjaft herët në traditën e shkruar islame. Dijetarët e hershëm islamë, por edhe ata të vonshmit, u përpoqën të vërtetojnë natyrën e mrekullueshme të Kuranit, bazuar në faktin që ai

flet për realitetet kozmike dhe fenomenet natyrore që nuk ishin zbuluar deri shumë mbrapa shfaqjes së vetë Kuranit. Nëse këto shkrime nuk do të ishin kaq kuturu dhe joshkencore, ato do të ishin virtualisht të pakundërshtueshme. Megjithatë, fatkeqësisht, pjesa më e madhe e dijetarëve bashkëkohorë që e kanë trajtuar këtë temë, janë tallur me veten dhe me lexuesit e tyre. Ata nuk kanë arritur as të tregojnë ndonjë dije të specializuar të mrekullisë që synojnë të vërtetojnë dhe as që e paraqesin rastin e tyre në mënyrë akademike, përderisa shkrimet e tyre janë me mungesë të çdo lloj dokumentacioni ose citimi nga shkrimet akademike dhe kërkimet perëndimore, në lidhje me fenomenin shkencor që i referohen. Dijetarët e hershëm mund të justifikohen në një masë të madhe për dështimin e tyre, që nuk iu referuan burimeve të tilla, dhe në fakt, ata ishin më sistematikë sesa homologët e tyre modernë. Mendimtarët e hershëm muslimanë i kishin zotëruar disiplinat dhe zbulimet shkencore të kohës. Ata ishin autoritetet primare në çështje të tilla, ndërsa qytetërimi njerëzor i asaj kohe shkruante nga e majta në të djathtë. Muslimanët flisnin dhe bota dëgjonte. Bota muslimane diktonte dhe pjesa tjetër e botës shkruante. Në dallim, sot gjërat janë saktësisht në të kundërt. Qendrat e kërkimit, zbulimit, inovacionit, të vendimmarrjes akademike dhe shkencore kanë lëvizur për në anën tjetër të botës dhe qytetërimi shkruan nga e majta në të djathtë. Dijetarët muslimanë që shkruan të parët për temën e “mrekullisë shkencore” (*el-ixhaz el-ilmî*), ishin Xhahidhi, Ibn Surakah (vd. 415 h./ 1023 e.s.), Maverdiu (vd. 450 h./ 1058 e.s.), Gazaliu (vd. 505 h./ 1111 e.s.), Kadi Ijadi (vd. 544 h./ 1149 e.s.), Fahrudin Raziu, Ibn ebi Fadl Mursiu (vd. 655 h./ 1257 e.s.), dhe Davud el-Antaki (vd. 1008 h./ 1599 e.s.). Shkrimtarët e vonshëm muslimanë që u morën me këtë temë, përfshijnë El-Iskandarani (vd. 1307 h./ 1889 e.s.), Abdu-Rrahman al-Keuakibi (vd. 1320 h./ 1903 e.s.), dhe Tantau Xheuheri (vd. 1359 h./ 1940 e.s.).

Lëvizja e shkrimtarëve mbi këtë subjekt mori vrull në shekullin e njëzetë, me përfundim e botimit të një serie librash, që merren me atë gjini të cilësuar mrekullia numërore (*el-ixhaz el-adadi*) e Kuranit. Një nga librat më të hershëm në këtë kategori, është "*El-Ixhaz el-Adadi fil Kur'ani Kerim*", i studiuesit Abdurrezak el-Naufal, i cili doli në fillimvitet 1970. Në librin e tij, Naufali përfshin lista të gjata me çifte fjalësh përsëritëse (*el-methani*), në të cilat bazohet gjuha e Kuranit. P.sh., ne gjejmë që fjalët natë (*lejl*) dhe ditë (*nahar*) shfaqen me të njëjtin numër herësh në Kuran. Ngjashëm, fjalët që i referohen parajsës (*Xhennet*) dhe ferrit (*el-nar*), përsëriten në mënyrë të barasvlershme, dhe fjalët që i referohen engjëjve (*melaikeh*) dhe djajve (*shejatinë*), përmenden gjithashtu njësoj. Ai gjithashtu vëren se fjala "muaj" (*shahr*) shfaqet saktësisht 365 herë. Fahrudin Raziu ishte i pari që tërhoqi vëmendjen për këtë mister gjuhësor në Kuran, në kontekstin e diskutimit të termit *methani* në suren Zumer (39:23), e cila flet për Kuranin si "një shkrim hyjnor, plotësisht i qëndrueshëm brenda vetes (*kitabën muteshabihan*), duke përsëritur secilën shpallje (të së vërtetës) në forma të shumëllojshme (*methanija*). {Një shkrim hyjnor}, ku i rrëqethet lëkura të gjithë atyre që qëndrojnë përpara Zotit të tyre të frikësuar..."³

Sa për këtë libër, do të fokusohet ekskluzivisht në atë që unë e konsideroj të jetë aspekti i vërtetë i mrekullisë së gjuhës së Kuranit, përkatësisht, risia e tij. Është një risi që nuk kufizohet në një fjalë aty, ose në një shprehje atje. Përkundrazi, ajo përfshin gjuhën e krejt Kuranit, nga fillimi në fund: vertikalisht dhe horizontalisht, gjuhësisht dhe në retorikë, në nivelin e fjalëve, pjesëzave, strukturave dhe shprehjeve; në termat e formulimit, ritmit, imazhit dhe shpjegimeve, dhe me një intensitet të atillë, që asnjë qenie njerëzore nuk mund të ketë prodhuar, ose t'i jetë qasur diçkaje të ngjashme me të. Megjithatë, përkundër kësaj risie gjuhë-

3 Fahrudin El-Raziu, *El-Tefsir el-Kebir* (Beirut: Dar Ihja el-Turath el-'Arabi, 2001), pjesa e 9-të, f. 446.

sore, Kurani ruan themelet e gjuhës arabe dhe ishte qartësisht i kuptueshëm për njerëzit që e dëgjonin atë. Në të vërtetë, jo vetëm që ata e kuptonin Kurantin, pavarësisht risisë së tij gjuhësore, por u befasant në mënyrë të papërshkrueshme prej tij.

NDIKIMI I RISISË SË KURANIT TEK ARABËT E DITËVE TË PROFETIT (A.S.)

Risia e Kuranit që e manifeston veten në nivele të ndryshme të përmbajtjes dhe stilit – nga fjala zgjedhje, te shprehjet, gramatika, morfologjia dhe retorika - ka qenë një burim hutimi dhe mahnitjeje për ata që e dëgjuan shpalljen për herë të parë. Një frazë e thjeshtë tri-fjalëshe kuranore, si *fashda bi ma tu'mar* (Prandaj shpallni haptas të gjitha ato që keni qenë urdhëruar të thoni!... Hixhr, 15:94), e nxiti një farë beduini arab të thërriste: “Çfarë po dëgjoj me këto veshë? Kjo nuk është thjesht fjalë njerëzore!” Më pas, ai e përuli veten me këto fjalë: “Ky fjalim kishte aq oratori, sa që unë i përulem me adhurim atij që e tha atë!”⁴

Diçka eprore dhe misterioze po ndodh këtu, të cilën veshët tanë modernë janë të paaftë për ta dalluar. Si mund të dëgjojmë ne me veshin e Omer ibn Hatabit, apo të beduinit arab që iu referuam më sipër, apo me veshët e arabëve të tjerë, të cilët ia dorëzuan vullnetin e tyre Zotit, në çastin kur ata dëgjuan gjuhën e Kuranit të Shenjtë? Nëse do të mund të zëvendësonim disi veshët tanë me të tyre, a do të mundeshim të dallonim të njëjtën cilësi të mrekullueshme që ata dalluan? A mund të përjetojmë përmes gjuhës së tij, atë që përjetuan ata dhe të rrokim atë që deri më tani nuk ishim të aftë për t’ia drejtuar gishtin?

4 Xhelaledin El-Sujuti, *El-Itkan fi'Ulum el-Kur'an* (Beirut: Dar el-Kutub el-'Ilmijjah, 2003), pjesa e 2-të, f. 108.

Gjithmonë e kam pyetur veten, se si Kurani mundi t'i sfidojë arabët e atyre ditëve për të prodhuar diçka të ngjashme me të. Një sfidë e tillë ishte provokuese, por ishte gjithashtu realiste dhe e arsyeshme. Më pas, t'i sfidonte ata të prodhonin vetëm dhjetë sure të ngjashme me të tijat, ishte befasuese deri edhe paksa turbulluese, duke qenë një shenjë e fuqishme dhe e jashtëzakonshme e vetëbesimit të palës që bënte sfidën. Por që më pas t'i sfidonte ata, jo një, por dy herë në dy sure të ndryshme, të shpallura në kohë krejt të ndryshme (suren Bekare, 2:23 dhe suren Junus, 10:38), që të prodhonin një sure të vetme të ngjashme me to, ishte më tepër sesa e jashtëzakonshme. Kjo sinjalizonte shumë më tepër sesa besimin e zakonshëm të dikujt që ka guxim. Po sikur t'i ishin përgjigjur me të vërtetë sfidës?! Po sikur poetët e shquar, letrarët, oratorët, gjuhëtarët dhe gjenitë të kishin bashkuar forcat për të shkruar një sure të vetme të vogël, e gjatë sa surja Duha (93), ose ndoshta të gjatë edhe sa surja Asr (103), apo surja Keuther (108)?! Do të kishte qenë vetëm çështje e kompozimit të një vargu të vetëm, jo më shumë! A do të kishte qenë kjo kaq e vështirë për ata?! A nuk ishte Kurani në vetë gjuhën e tyre dhe a nuk ishin ata mjeshtër të po kësaj gjuhe?!

SHKALLA E VËRTETË E MREKULLISË E MANIFESTUAR NË RISINË GJUHËSORE TË KURANIT

Kur vendosa t'u përgjigjem këtyre pyetjeve, duke e futur gjuhën e Kuranit në laboratorin tim gjuhësor dhe duke e vendosur punimin e tij nën mikroskop, unë nuk kisha asnjë koncept real të tipit të sfidës që i kisha vendosur vetes. Kurrë më parë nuk e kisha kuptuar me besim dhe qartësi të plotë, që pas çdo vargu, pas çdo shprehjeje dhe mund të them pothuajse pas çdo fjale të

Kuranit, gjendet një mrekulli apo një “risi”, madje jo, më shumë sesa një risi e vetme, në shumë raste. Më shqetësonte fakti që, me sa duket, nuk mund të gjeja diçka më të mirë sesa këtë term njerëzor të papërshtatshëm për të përshkruar një mrekulli që gjuha njerëzore nuk mund ta përmbajë. Në fund të fundit, “Zotit i përket shembulli më i lartë”⁵. Kështu, e ula kokën me frikërespekt ndaj urtësisë së lartë, që qëndron e fshehur në këtë guxim hyjnor.

Unë zbulova se kurdo që i qasesha gjuhës së Kuranit, në përpjekje për të zhgroposur sekretet e tij, e ndieja veten si një pigme⁶, duke u përpjekur për t’u ngjitur në gishtin e një gjiganti të stërmadh. Ajo çka zbuluam në këtë gjuhë, nuk është një zbulim shkencor i llojit që dëshmojmë në ditët dhe kohët e sotme. Por, për më tepër, qëndron në një seri të vazhdueshme risish mahnitëse gjuhësore, me forma dhe tipare të ndryshme. Ato janë të lidhura njëra me tjetrën, në një mënyrë të tillë, që kushdo që përpiket t’i imitojë, gjendet përballë një muri të padepërtueshëm dhe ai/ajo e kupton që nuk ka vend për vrazhdësi dhe mendjemadhësi.

Imagjinoni sikur keni një kopsht shumë të bukur, ku ju kaloni kohën përditë, duke i marrë erë një luleje këtu, duke zbuluar një gonxhe atje dhe duke mbledhur fryte sa në një pemë, në tjetrën. Dhe mendoni sikur dikush vjen e ju thotë se në kopshtin të cilin e gëzoni çdo ditë dhe shihni rregullisht objekte të një bukurie të parrëfyer, ka me mijëra sekrete mahnitëse në të cilat ju nuk i keni hedhur sytë, megjithëse kanë qenë mu nën hundën tuaj. Për më tej, mendo sikur ky person t’ju ofrojë syze që mund t’ju hapin sytë ndaj një skene krejtësisht të ndryshme nga ajo që ishit mësuar të shihnit në të kaluarën, të tillë si në të tashmen. Nën çdo gur të kopshtit gjeni një perlë të çmuar, midis çdo çifti

5 Surja En-Nahl 16:60, A. J. Arberry, *The Koran interpreted* (New York: Macmillan 1955).

6 Banor vendës i disa zonave të Afrikës e të Azisë, me trup shumë të shkurtër; njeri me shtat të vogël.

trëndafilash qëndron një fletë delikate argjendi, nën lehet e çdo peme ka një përzierje parfumeshe sublime dhe ndërmjet çdo çifti thërrmijëzash pluhuri ka një pjesëz metalesh të çmuara. Mendo sikur sapo zbulove se të gjitha këto kanë qenë në kopshtin tuaj, pa ditur asgjë rreth tyre!

Pjesa më e mirë e punës që bëra në përgatitjet për të shkruar këtë libër, qëndron në kërkimin e këtyre syzeve të posaçme. Dhe, sapo i gjeta ato, vendosa t'i marr në dorë, miq të mi lexues të Kuranit! Kështu që, duke ia dhuruar këto syze të reja syve të mi, ata të mund ta çlironin vetveten nga ky familjaritet vdekjeprurës, që kishte shkatërruar aftësinë e tyre për të parë mrekullitë e pakufishme dhe misterioze të gjuhës, aftësi që kishin qenë përpara syve për një kohë të gjatë dhe për të cilat nuk kishin marrë vesh asgjë.

FREKUENCA E MREKULLUESHME E RISIVE KURANORE

Mbaj mend njëherë, të kem parë një gjëgjëzë vizuale. Ishte fotografi e diçkaje që dukej si vargmal i çuditshëm dhe i lartë. Ajo kishte cilësi habitëse, të tilla, sa që dukej si të ishte bërë në sipërfaqen e Hënës apo të Marsit. Kur e ktheva letrën mbrapsht, për të gjetur se çfarë përfaqësonte fotografia, pashë me habi, se nuk ishte gjë tjetër, vetëm se zmadhim i linjave delikate të shenjave të gishtave. Mendoj se këtë lloj ndjenje provojnë njerëzit, kur shohin kornizat e gjuhës kuranore, apo atë ç'ka kemi mundur të zbulojmë prej saj, deri më tani, përmes lenteve zmadhuese me të cilat ky studim përpiqet t'i pajisë ata. Shpresojmë që me ndihmën e tyre, lexuesit të mund të kapin të paktën diçka nga dukuritë e mahnitshme gjuhësore kuranore, me gjithë lavdinë e tyre madhështore.

Po t'i shihnim këto dukuri si të izoluara nga njëra-tjetra, mund të tundoheshim ta përmbanim gjykimin, duke menduar: sigurisht, kjo dukuri është risi. Por, që kur paska nisur të quhet risia mrekulli?! Dhe, me të drejtë, do ta bënim një kundërshtim të tillë, sepse, në fakt, nuk do të ishte e justifikueshme ta quanim Kuranin një mrekulli, bazuar në dy apo tri dukuri të izoluara. Kur zbulojmë shpeshësinë dhe dendësinë e dukurive të reja që përshkojnë vargjet dhe suret kuranore, kur shohim se ato e ndjekin njëra-tjetrën pa ndalur - në një frymë të vetme - pa ndërprerje apo boshllëqe të asnjë lloji; kur shohim se si çdo fjalë, strukturë dhe shprehje në Kuran shpreh risi të habitshme, në të gjitha ngjyrat e format, atëherë nisim të perceptojmë mrekullinë e vërtetë gjuhësore të Kuranit dhe pamundësinë për ta imituar apo krijuar atë.

Ndonjë edhe mund të pyesë: A ekziston ndonjë gjë në këtë botë, që nuk mund të falsifikohet? Njerëzit kanë arritur të falsifikojnë dollarin amerikan, paundin britanik, euron dhe pothuajse të gjitha kartëmonedhat në botë. Ata kanë prodhuar imitime të skulpturave, veprave letrare, monedhave e kolonave antike, pikturave të artistëve më të mëdhenj e të njohur botërorë etj. Ndaj, pse qenka e pamundur të shkruash një apo dy sure a vargje si ato të Kuranit?! Gjithsesi, një gjë është të imitosh diçka në mënyrë kaq të suksesshme, saqë njerëzit të mos e zbulonin mashtrimin, të paktën në fillim. Por, kur ajo zbulohet, të ndëshkojnë, ndërsa fshehtazi të admirojnë për mënyrën se si e ke perfeksionuar zanatin. Ndërsa një gjë krejt tjetër është të tallin dhe të akuzojnë për mashtrim, që në fillim, pasi falsifikimi duket qartazi. Dhe kjo e dyta i ka ndodhur gjithkujt që është përpjekur të imitojë gjuhën e Kuranit.

EFEKTI HUTUES I STRUKTURËS SË RE RITMIKE TE DËGJUESIT E PARË ARABË TË KURANIT

Për arabët beduinë primitivë që jetuan në kohën e Profetit Muhamed (a.s.), Shpallja e Kuranit ishte e krahasueshme me zbritjen e një disku të madh fluturues përpara syve: i çuditshëm, i sofistikuar, i punuar me mjeshtëri. Njësoj si njerëzit e tjerë nëpër botë, edhe arabët e asaj kohe nuk i pranonin lehtë format e reja të të shprehurit, qofshin poezi apo prozë, derisa t'u mësoheshin veshët me ritmin, stilin dhe strukturat e dallueshme përgjatë disa brezave. Nëse një shkrimtar do të largohej prej formave familjare, dëgjuesit nuk do të ndienin tjetër, përveçse një turbullirë të dhimbshme dhe vetëm pasi të përsëritej dëgjimi i tyre gjatë viteve, do të pranoheshin si pjesë e repertorit të tyre gjuhësor.

Megjithatë, ata nuk përjetuan diçka të tillë, kur u përballën për herë të parë me tufën e madhe të risive verbale, gramatikore dhe shprehëse në Kuran. Këto dukuri gjuhësore në shfaqje e sipër, me togjet e tyre periodike unike, kishin prirje të ndërtonin repertorin e tyre të dallueshëm ritmik në veshët, zemrat dhe mendjet e dëgjuesve, në një periudhë të shkurtër kohore, të pazakontë. Përkundër asaj që mund të pritej, ajo që më së pari i tërhoqi arabët e kohës së Profetit (a.s.) drejt Kuranit, ishte ritmi dhe muzika e gjuhës së tij, që përfshin tingujt e prodhuar nga recituesit e tij, emocionet dhe ndjesitë e krijuara nga imazhet dhe metafora që ai përçonte. Pavarësisht se ishte krejtësisht i ri për arabët, ky ritëm e intonacion u pranua dhe madje u mirëprit prej tyre, edhe pse krijoi hutim në rrethin e politeistëve më të rrjedhshëm e me prirje letrare. Ishte pikërisht ky grup i fundit, që, kur dëgjuan Kuranin, nuk mundën të mos shprehnin admirim për të, pavarësisht mosbesimit të tyre. Megjithëse refuzoi të pranonte Islamin, El Uelid ibn Mugira, një prej politeistëve më të shquar të kohës, e lartësoi Kuranin, duke thënë:

Betohem për Zotin, nuk ka njeri më të ditur se unë, sa i përket poezisë, më të aftë për të dalluar një varg të mirë, nga një varg i keq! Jo, nuk ka njeri më të ditur se unë, as për poezitë e xhindeve! Megjithatë, për atë Zot, kjo që po thotë ky njeri, nuk ka asnjë ngjashmëri, as me poezitë e njerëzve, as me të xhindeve! Fjalët e tij se ç'kanë një ëmbëlsi, një bukuri, një elegancë. (Si një pemë) ato mbajnë lart fruta dhe rrënjët e tyre shkojnë thellë. Ato ngrihen mbi të tjerat dhe asnjë nuk mund të ngrihet mbi to.⁷

NJË MAKINË PËR TË MË KTHYER NË KOHË

Herë pas here, mendoj me vete, sikur të kisha një makinë kohe, të më kthente katërmbëdhjetë shekuj më herët, në mënyrë që të dëgjoja Kuran për herë të parë, me veshët e një arabi të shkretëtirës së shekullit të shtatë. Sikur të ishte e mundur për mua, mendoja, që ta zhdukja kujtesën time kuranore, madje edhe atë islame, dhe të bëhesha tamam arab paraislam që jeton në periudhën e shpalljes kuranore. Sikur të ndodhte kjo, do ta dëgjoja Kuranin kur shpallej, varg pas vargu, me vesh të pamësuar, që nuk e ka dëgjuar ende Kuranin aq shpesh, saqë familjariteti me të, të më pengonte perceptimin e gjenialitetit, risisë dhe unikalitetit të tij. Çfarë eksperience mrekulluese duhet të ketë qenë për muslimanët e shekullit të shtatë, marrja e Shpalljes prej Vetë Zotit, për herë të parë! Sa dehëse do të ketë qenë për ta, të dëgjojnë thëniet e padiskutueshme dhe bindëse hyjnore “në transmetim të drejtpërdrejtë”, me gjithë çështjet e tyre praktike: përkufizime që mund të përmbajnë shfajësim apo dënim, premtime apo kërcënime, për njerëzit që bënin jetën e zakonshme mes tyre! Si duhet të ketë qenë për ta, të dëgjojnë çfarë kishte për t'u thënë

7 Kjo ndodhi u tregua nga Hakimi në *El-Mustadrak 'ala el-Sahihajn*. Tregime të tjera mbi qëndrimet e politeistëve ndaj Kuranit gjenden në: Samira El-Zajid, *Muhtasar el-Xhami' fi el-Sirah el-Nabaujjah* (Damask: El-Matba'ah el-Ilmijjah, 1995).

Zoti, kur e folura hyjnore i yshtte çdo ditë, madje çdo orë, nëpër botë kaq të gjera, saqë nuk mund t'ua zinte mendja?

Le të përpiqemi bashkë, të parashikojmë ç'lloj impakti që do të kishin vargjet e mëposhtme në mendjet e arabëve të shekullit të shtatë, që i dëgjonin ato për së pari:

Ata nuk e çmuan Allahun me Madhështinë që i takon, ndërsa në ditën e Kiametit e tërë toka është në grushtin e Tij, ndërsa qiejt të mbështjellë në të djathtën (forcën) e Tij. Ai është i Pastër nga të metat dhe është i lartë nga çka ata i shoqërojnë. Kur i fryhet Surit, bie e vdekur çka ka në qiej dhe çka ka në tokë, përveç atyre që do Allahu (të mos vdesin). Pastaj i fryhet herën tjetër, kur ja, të gjithë ata të ngritur e presin (urdhrin e Zotit). Toka është ndriçuar me dritën e Zotit të vet, libri (shënimet mbi veprat) është vënë pranë dhe sillen pejgamberët e dëshmitarët, kryhet mes tyre gjykimi me drejtësi dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi". (*Ez-Zumer, 39:67-69*)

Tani, katërmëdhjetë shekuj prej se u shpallën këto vargje, ti nuk percepton dot gjë tjetër, përveç mesazhit tokë-shkundës që ato mbartin, mesazh që do ta kishte shtrirë imagjinatën e arabëve të shekullit të shtatë, por ndoshta edhe të tjerëve, përtej limiteve të tyre. Por, sa akoma më sfidues do të ketë qenë ai atëherë, shpallur me një teshë të re verbuese, thurur me një koleksion mahnitës formash të reja gjuhësore, me të cilat arabët nuk ishin mësuar, me një intensitet të tillë, që mendjet e tyre do të qenë të paafta për ta përthithur?! A është e mundur për ne të rigjejmë ato momente ndriçuese që çliruan kaq fuqi, forcë, besim, vetëbesim dhe vendosmëri në mendjet dhe zemrat e muslimanëve të parë, saqë u bënë të aftë të ndërtojnë një qytetërim i cili ndryshoi rrjedhën e historisë?!

Poezia paraislame dhe hadithet profetike janë të vetmet burime të konfirmuara, mbi bazën e të cilave mund të rindërtojmë gjuhën që ishte bashkëkohëse e asaj të Kuranit. Ndaj, në përpyekjen për të risjellë ato momente të ndritura për të cilat fola, vendosa ta shkul kujtesën kuranore nga truri dhe ta zëvendësoj, në fillim me kujtesën poetike të arabëve paraislamë, pastaj me kujtesën e haditheve profetike.

TRE FJALORË: FJALORI KURANOR, AI PARAISLAM DHE FJALORI PROFETIK

Në përpjekjet për të identifikuar ndryshimet stilistike mes Kuranit të Shenjtë, poezisë paraislame dhe haditheve profetike, vendosa të fokusohem veçanërisht te poezia. Enciklopeditë elektronike na mundësojnë të lexojmë rreth njëzet mijë vargje të poezive paraislame. Ky numër është përafërsisht i njëjtë, ose pak më i madh se ai i vargjeve kuranore, edhe pse e dimë që poezia paraislame e humbur ka qenë më e madhe në numër, sesa ajo që ka mbijetuar.⁸

Poezia paraislame ka një cilësi gjuhësore të veçantë, që dallon nga gjuha e Profetit (a.s.), edhe pse ai lindi dhe jetoi në zemër të periudhës paraislame. Ngjashëm, Profeti Muhamed (a.s.) kishte një stil gjuhësor tërësisht të dallueshëm nga gjuha e librit që na solli. Mbi të gjitha, këto tri gjuhë nuk u ngatërruan ndonjëherë me njëra-tjetrën. Këto fakte shërbejnë si prova të qarta të besueshmërisë së teksteve që kanë arritur te ne prej këtyre tre stileve gjuhësore, duke mos pasur ndërfutje apo mbivendosje të njëra-tjetrës. Në të kundërt, stilet e poetëve paraislamë shpesh ngjajnë me njëri-tjetrin dhe mbivendosen në atë masë, sa që studiuesit e kanë të vështirë të bëjnë dallime të qarta mes dy suresh, bazuar te stilet dhe veçoritë gjuhësore të tyre. Edhe pse këta poetë ndryshojnë nga njëri-tjetri, sa u përket pikave të forta e të dobëta, pastërtisë së stilit, delikatesës, thjeshtësisë, thellësisë e të tjerave tipare, asnjë kritik letrar nuk do të guxonte të pohonte me siguri të plotë, se kjo apo ajo poezi është krijuar nga aksh poet dhe jo nga tjetri. Por një lexues i zakonshëm i Kuranit mund

8 Për dokumentimin e poezisë paraislame, në pjesën më të madhe kam përdorur enciklopedinë e poezisë (në CD), të përpiluar nga Akademia Kulturore e Emirateve të Bashkuara Arabe. Ekzistojnë disa botime të kësaj enciklopedie, i pari i shfaqur në vitin 1998, i dyti në 2000 dhe i treti në vitin 2003. Për hir të së vërtetës, më duhet të pranoj se, pa këtë enciklopedi dhe pa materiale të tjera që gjenden në versionin elektronik, do e kisha të pamundur ta ndërmerrja këtë studim.

ta thotë me siguri se kjo e ajo shprehje apo pjesë është nga Kurani, ndërsa kjo e ajo tjetra jo.

Pavarësisht se gjuha e haditheve profetike, pra gjuha e përdorur nga vetë Profeti (a.s.), duhet të jetë ndikuar nga Kurani, edhe pse në mënyrë sipërfaqësore, ky ndikim zor se mund të gjurmohet në më shumë se një për qind të të gjithë korpusit të hadithit. Ai nuk arrin të ndryshojë karakterin gjithëpërfshirës dhe të thellë të literaturës së hadithit. Prandaj, në rrjedhën e këtij studimi, jam përpjekur të identifikoj ndryshimet mjaft të përhapura stilistike radikale dhe gjuhësore mes haditheve profetike dhe Kuranit, me shpresë se do i vë në dukje ato mjaftueshëm për orientalistët dhe skeptikët që hedhin hije dyshimi mbi origjinën hyjnore të Kuranit dhe akuzojnë Profetin Muhamed dhe/ose bashkëkohësit e tij për sajimin e tij.

REVOLUCIONI I RI GJUHËSOR

Si e pritën arabët e kohës së Profetit (a.s.) gjuhën e re kuranore, kur ajo nuk kishte asnjë nga idiomat, frazat dhe strukturat me të cilat ishin mësuar deri atëherë? Thënë shkurt, ajo i përumbi fare. Në fakt, ajo mund t'i ketë lënë kaq të hutuar, sa që ata nisën ta merrnin veten, vetëm pasi nisën të familjarizoheshin pak me këtë gjuhë të re. Ndërrimi gjuhësor për të cilin po flas, nuk kishte të bënte vetëm me fjalorin e Kuranit. Ai kalonte përtej nivelit të fjalëve të veçanta dhe kishte të bënte me marrëdhënien mes fjalëve, vënien e tyre sipas konteksteve të ndryshme, me përdorimin e tyre dhe me elementet e reja gjuhësore, gramatikore dhe figurative, si dhe me konvencionet që e përshkojnë gjuhën e tij. Ky ndryshim përfshinte gjithashtu, njësitë gjuhësore të formuara prej këtyre marrëdhënieve, konvencioneve dhe fjalëve të veçanta. Nëse analizojmë secilën sure të Kuranit më vete, do të

shohim se vendet ku ndodhin dukuritë e reja gjuhësore, janë më të shumta se fjalët e vetë sures. Në një sure të shkurtër si El-Fatiha (I), të përbërë nga 29 fjalë, gjenden jo më pak se 58 “zhvillime të reja”. Në suren En-Nas (114), me 20 fjalë, gjenden jo më pak se 33 dukuri të reja; në Suren Felek (113), me 23 fjalë, shfaqen 38 të tilla dhe në suren Ihlas (112), me 15 fjalë, gjenden 22 dukuri të reja. Një model i ngjashëm mund të vërehet edhe në të gjitha suret e tjera. Duke pasur parasysh këtë, mund fillojmë të imagjinojmë përmasat e tronditjes që shkaktoi Kurani, me karakterin e tij gjuhësor të pasiq, në mendjet dhe zemrat e arabëve të Gadishullit Arabik të shekullit të shtatë.

Kurani, sigurisht, erdhi në arabishten që ishte në përdorim dhe jo në një gjuhë tjetër. Pikërisht këtu qëndron mrekullia e tij. Ai mbeti i rrënjëzuar në atë gjuhë. Megjithatë, unikaliteti i tij ka në thelb diçka që shkon përtej arabishtes, duke tejkaluar kufizimet e termave të saj, strukturave, idiomave, të formulimeve, figurave dhe marrëdhënieve të brendshme të saj. Mrekullia e Kuranit qëndron në mënyrën se si ai e zhvilloi gjuhën arabe, kushtet dhe rregullat e saj, pa i shpërbërë ato, duke hapur kështu rrugën për zhvillimin dhe pasurimin e saj, duke e pajisur me përmasa dhe horizonte për të cilat folësit e saj as që kishin ëndërruar ndonjëherë.

Mrekullia e Kuranit pra, nuk ka të bëjë me krijimin e një gjuhe të re nga hiçi. Po të kishte qenë kështu, do ta kishte ndarë veten dhe mësimet e tij nga qeniet njerëzore, pavarësisht gjuhëve që ata flasin. Në të kundërt, mrekullia e tij ka të bëjë me faktin që ai solli një gjuhë të re, ngritur mbi themelet e gjuhës së vjetër, duke zgjeruar fushat e saj në një mënyrë të panjohur për gjuhën tradicionale. Gjatë leksioneve mbi këtë temë, dëgjuesit e mi shpesh e kanë kundërshtuar përdorimin e termit "gjuhë e re", për t'iu referuar gjuhës së Kuranit, pasi kjo frazë mund të lërë përshtypjen e gabuar, se gjuha e Kuranit nuk është arabishtja dhe më kanë sugjeruar të përdor terma të tjerë të mundshëm.

Megjithatë, mrekullia e Kuranit qëndron pikërisht në këtë paradoks: ai është arabisht dhe njëkohësisht, një gjuhë e re. Kjo ndoshta mund të duket joreale. Megjithatë, logjika e një mrekullie qëndron pikërisht në faktin se ajo e tejkalon logjikën. Një mrekulli që bazohet në logjikë, nuk është më mrekulli.

PERSONALITETI KURANOR I SUREVE

Siç kemi pasur rastin të vëmë re, Kurani përdor foljen "ishte" (*kana*) për "është". Ky përdorim i ri i foljes *kana* ndodh të paktën 190 herë në Kuran. Megjithatë, ajo nuk është përdorur në këtë formë as më pas, në fakt asnjëherë më, në asnjë shkrim, madje as në hadithet profetike. Ndërkohë, shpërndarja e këtij përdorimi nëpër suret kuranore është edhe më e jashtëzakonshme. Është e natyrshme që surja dyrreshtore Ihlas (112) të ketë vetëm një nga 190 përdorimet e tilla të foljes *kana*.⁹ Por, në të kundërt të pritshmërive tona, surja El-Bekare (2), që përbën 1/12 të Kuranit, nuk përmban as edhe një rast të këtij përdorimi (pra që folja *kana* të jetë "është" dhe jo "ishte").

Po suret e tjera pak më të shkurtra se El Bekare, siç janë Al 'Imran (3), El-Maide (5), El-En'am (6), El Araf (7), El Enfal (8) dhe Et-Teubeh (9)? As në to nuk gjendet asnjë përmasë e tillë. Situata mbetet e njëjtë deri në suren e gjashtëmbëdhjetë, En-Nahl. Pra, ky lloj përdorimi pothuajse mungon në suret që përbëjnë gati gjysmën e parë të Kuranit.

Gjithsesi, midis kësaj fushe të gjerë, papritur kulmon një reliev ngjithës me suren En-Nisa' (4), ku, me një ndryshim radikal

9 Këtë pjesë e hasim në pohimin *ue lem jekun lehu, kufuuen ehad*, që do të thotë: "Nuk ekziston asgjë që mund të krahasohet me Të" (Sure El-Ihlas, 112:4). Frazja mohuese *lem jekun*, përkthyer si "nuk ekziston asgjë", në fakt do të thotë; "nuk ka pasur, nuk ka dhe kurrë nuk do të ketë asgjë". Kjo do të thotë se kuptimi i saj nuk kufizohet vetëm në të shkuarën, siç ndodh në përdorimet njerëzore të kësaj foljeje.

nga modeli mbizotërues, mund ta gjejmë këtë përdorim 53 herë. Pastaj zhduket deri në suren Isra (17), ku përsëritet 27 herë. Sërish zhduket në shtatë suret pasardhëse, derisa shfaqet 26 herë në suren El-Ahzab (33). Më pas, ajo shfaqet edhe në disa sure të tjera.

Kjo dukuri mbështet pretendimin tonë, se secila sure në Kuran ka muret e veta të papërshkueshme të llojeve dhe një vulë gjuhësore të dallueshme, që e veçon atë nga të tjerat, saqë do të ishte e vështirë që vargjet e një sureje të përziheshin apo të mbi- vendoseshin me njëra-tjetrën.

Një aspekt tjetër edhe më i rëndësishëm i kësaj dukurie, është se ajo shërben për të konfirmuar vendin aktual të një sureje në marrëdhënie me të tjerat, duke përjashtuar mundësinë për çdo lloj modifikimi njerëzor të rendit të tyre, që ka arritur deri te ne. Në kundërshtim me pohimet e pajustificueshme dhe paragjykuese të disa orientalistëve, kjo dukuri është dëshmi në favor të argumentit se kjo renditje ka origjinë hyjnore, ndërsa konfirmon se suret janë listuar në të njëjtën mënyrë, si u bë gjatë kohës së Profetit (a.s.).

Vula gjuhësore që shënjon secilën sure, është një dukuri e jashtëzakonshme kuranore, që i jep formë një pjese të strukturës dhe personalitetit të Kuranit si tërësi. Siç do të bëhet e qartë nga studimi i sureve, secila prej tyre veçohet sipas përdorimit të termave që nuk gjenden në suret e tjera, si dhe nga marrëdhëniet e reja gjuhësore, formulimet dhe ndërtimet që shënojnë vetëm atë sure specifike. Për më tepër, secila sure përshkohet nga një ritëm dhe rimë unike për të, që nuk gjendet te suret e tjera.

A MBIVENDOSEN KARAKTERET E SUREVE?

Kur mësojmë përmendësh disa sure, sidomos ato të shkurtrat, ndonjëherë na duket se mund t'i ngatërrojmë, të kalojmë nga një sure te tjetra, që mund të ketë të njëjtin ritëm dhe rimë të

ngjashme me atë që po recitojmë. Kjo mund të ndodhë, për shembull, në lidhje me suret El-Murselat (77) dhe El-Nazi'at (79), suret Et-Tekuir (81) dhe El-Inshikak (84), apo suret El-A'la (87) dhe El-Lejl (92). Ky lloj ndërrimi pa dashje, mund të na çojë në hamendësimin se ka një lloj mbivendosjeje mes karaktereve të sureve në fjalë dhe se kufijtë mes tyre janë të turbullt, gjë që do ta nxirrte të pabazë pohimin tonë, se secila sure ka karakterin e saj unik.

Surja El-A'la (87) dhe Surja El-Lejl (92)

Një krahasim i shpejtë mes këtyre sureve, do të tregojë se, pavarësisht ngjashmërive, karakteret e tyre gjuhësore janë të ndryshme dhe zor se kanë ndonjë frazë të përbashkët. Po marrim si shembull këtu, *suret El-A'la (87) dhe El-Lejl (92)*, për të krahasuar strukturat dhe shprehjet gjuhësore të secilës. Ky krahasim do të qartësojë se sa të ndryshme janë ato dhe se secila prej tyre kanë personalitet gjuhësor të dallueshëm, pavarësisht përkimit të linjës ritmike.

Surja El-A'la ka 72 fjalë, ndërsa *surja El-Lejl* ka 71 syresh. Këto sure kanë rimë të ngjashme, ku secili varg apo ajet mbaron me shkronjën *elif*. Po ashtu, fjala e fundit në vargjet e tyre vjen sipas modelit *fa'la* (فعلى), si dhe kanë një numër të kufizuar fjalësh të përbashkëta (*haleka, el-ashka, jasla, el-ahireh, rabbehu* dhe *el-a'la*). Këtu ngjashmëritë mbarojnë. Përveç këtyre ngjashmërive, secila sure ka shprehjet, idiomat dhe strukturat e saj të veçanta e të ndryshme. Akoma më karakteristik dhe më i mrekullueshëm është fakti se pjesa më e madhe e strukturave dhe shprehjeve të secilës prej tyre janë unike, përkatësisht vetëm për to.

Nga 26 strukturat dhe shprehjet që përbëjnë korpusin e *sures El-A'la*, nuk gjejmë më shumë se katër syresh nëpër suret e tjera të Kuranit. Ato janë *haleka fe saua, illa ma sha'a Allah, fe*

dhekkir, dhe *ue la jahja*. Ndërsa 22 prej tyre - ose 80% - janë unike për këto sure dhe nuk ndodhin në të tjera vende.

Sa për *suren El-Lejl*, nga 25 strukturat dhe shprehjet që e përbëjnë atë, vetëm tri shprehje gjenden edhe nëpër sure të tjera, që janë: *fe endhartukum*, *kedhdhebe ue teualla dhe ille ibtigha'a*. Gjithsesi, 22 të tjerat - ose 88% e totalit - nuk gjenden kund tjetër, pra, as në *suren El-A'la*.

KARAKTERI UNIK I KURANIT

Që në fillim të procesit të shpalljes, arabët që dëgjonin Kuran, e kuptuan instinktivisht, se çdo gjë e lidhur me të përbënte risi dhe veçanti. Këto cilësi mund të kuptoheshin që nga emri i tij i veçantë, “Kuran”, që arabët paraislamë nuk e kishin përdorur kurrë dhe unikaliteti i titullit të librit ishte tregues i veçantisë së vetë përmbajtjes së tij. E njëjta risi dhe veçanti reflektohen në titullin e sures hapëse të Kuranit, *El-Fatiha*, që ishte unik vetëm për Kuranin. Ndërsa emri sure, që u përdor për t’iu referuar kapitujve kuranorë, rridhte nga fjala *sur* (سور) dhe u referohej mureve të një qyteti apo kështjelle. Kuptimi i këtij termi pra, ishte si një shenjë qiellore, që shënjonte papërshkueshmërinë e “mureve” kuranore dhe pamundësinë e imitimit të kapitujve të tij dhe të gjetjes së hapësirave apo vrimave që do të mundësonin hyrjen në to. Pastaj vijmë te termi *ajet*, që do të thotë shenjë ose mrekulli, të cilin Zoti e përdori për t’iu referuar vargjeve të Kuranit.

Në këtë skicë shohim një tjetër shenjë hyjnore, treguese të karakterit mrekullues të librit si tërësi dhe të elementit të sfidës që qëndron në thelb të secilës njësi gjuhësore të tij, e gjatë apo e shkurtër qoftë. Dhe në fund, vjen termi *tilauah*. Ai rrjedh prej foljes *jetlu* (يتلو), që do të thotë: me ardhë pas diçkaje tjetër në radhë. Ky term u përdor për recitimin e Kuranit si një përkujtim

prej Qiellit, se i Dërguari i Zotit nuk ishte personi i parë që recitonte vargjet kuranore, por ishte “ndjekës”, meqë Xhebraili ishte i pari që i recitonte ato, ndërsa Profeti (a.s.) “e pasonte atë” (*telahu* تلاه), duke imituar recitimimin e engjëllit, ndërsa ne pasojmë vetë Profetin (a.s.).

Duhet theksuar këtu, se Kurani i Shenjtë është i vetmi libër në botë që ka vazhduar deri më sot të jetë i shënjuar nga tipare unike, që nuk i ka asnjë libër tjetër në Tokë. Krahasimin këtu nuk po e bëjmë për subjektin, idetë, gjuhën apo stilin e tij. Në fund të fundit, çdo libër në botë mendohet të ketë disa tipare të veçanta që e dallojnë nga të tjerët, për sa i përket temës, ideve që prezanton dhe stilit gjuhësor. Këtu ne po flasim për “gjenin” e librit në fjalë.

Nëse, për shembull, krahasojmë një libër që kemi në dorë, me libra të tjerë të bibliotekës sonë, atë nuk e dallojmë ndonjë gjë e veçantë, për vetë faktin se është libër. Mund të krahasojmë, sigurisht, një libër të shkruar në arabisht dhe një në anglisht. Në këtë rast, do të thoshim se ata dallojnë në dy drejtime: 1. Gjuha e tyre (njëri është shkruar në anglisht dhe tjetri në arabisht) dhe 2. Kahja e leximit (nga e majta në të djathtë dhe nga e djathta në të majtë). Këtu dallimi mbaron. Gjithsesi, edhe këto tipare nuk mjaftojnë për të bërë dallimin, meqë ka miliona libra të shkruar si në anglisht, si në arabisht. Ndërsa Kurani, në të kundërt, ka një sërë tiparesh që nuk i ka libër tjetër në sipërfaqe të tokës, përgjatë historisë. Unë kam gjetur njëzet syresh, dymbëdhjetë prej të cilave po i radhis këtu:

1. Termat unike që përdor për kapitujt dhe vargjet.
2. Mund të lexohet në disa mënyra, të gjitha me frymëzim hyjnor.
3. Mënyra e recitimit ndryshon nga mënyra se si shkruhet. Kështu, për shembull, janë fjalët lutje/falje (*el-salah*), takse (*el-zekah*) dhe jetë (*el-hajah*), të cilat në Kuran shkruhen me shkronjën uau (që është një u e gjatë), ndërsa ne e lexojmë si elif (që përfaqëson një tingull mes a dhe e). Një shembull tjetër për këtë është fjala *kauarira* në *suren*

El-Insan 76:11, që lexohet pa elifin në fund, edhe pse shkruhet.

4. Teksti i tij shqiptohet ndryshe nga çdo tekst tjetër në arabisht. Mënyrat e ndryshme të shqiptimit janë përpunuar me detaje, përmes artit të *texhuidit*, ose të recitimit kuranor, përmes rregullave të tij të shqiptimit dhe intonimit.
5. Është shkruar ndryshe nga çdo tekst tjetër arabisht. (Kjo për faktin se rregullat e germëzimit, mbi të cilat është shkruar Kurani, ndryshojnë nga ato të arabishtes moderne dhe asaj së përdorur katërmbëdhjetë shekuj më parë).
6. Mund të dokumentohet vetëm nga dëgjimi i recitimit të tij prej të tjerëve. Përveç rregullave të *texhuidit*, dokumentimi i Kuranit varet nga zinxhiri gojor i transmetimeve, që shkon deri te vetë Profeti Muhamed (a.s.).
7. Kurani recitohet me melodi. Vetë Profeti (a.s.) urdhëroi: “Recitoheni Kuranin me melodi, nuk është prej nesh ai që nuk e reciton ashtu!”¹⁰ Këtu, “nuk është prej nesh” do të thotë që nuk ndjek rrugën e Profetit (a.s.).
8. Stili gjuhësor i Kuranit është tërësisht i ndryshëm nga ai i njeriut që na e solli, pra, nga i Profetit Muhamed (a.s.).
9. Miliona njerëz nëpër botë e kanë mësuar atë përmendësh, fjalë për fjalë.
10. Pjesa më e madhe e atyre që e kanë mësuar përmendësh, nuk dinë arabisht, madje as nuk e kuptojnë atë. Arabët përbëjnë rreth 20% të muslimanëve në botë.
11. Tekstet e ndryshme të Kuranit konfirmohen miliona herë në ditë. Ai recitohet me zë tri herë në ditë: në namazin e sabahut (*el-fexhr*), në atë të akshamit (*el-magrib*) dhe në namazin e mbrëmjes (*el-isha*), në kuadër të faljeve të përbashkëta (me xhemat, nëpër xhami - sh.p.) nëpër botë. Përveç këtyre, ai recitohet me zë edhe gjatë namazit të xhumasë dhe në namazet e dy Bajrameve

10 Tregim i përcjellë nga Sa'd ibn ebi Uakkas, Sijar A'lam el-Nubala dhe El-Dhahabi.

(*Eid el-fitr dhe Eid el-adha*). Këto falje janë zhvilluar nëpër qindra e mijëra xhami nëpër botë, për katërmbëdhjetë shekuj, që prej ardhjes së detyrimit të namazit. Nëse një imam keqshqipton ndonjë fjalë, apo bën ndonjë gabim në recitim, do të korrigjohet menjëherë nga besimtarët që falen pas tij. Kjo metodë intensive dhe jashtëzakonshme e verifikimit e bën të pamundur shtimin apo heqjen e ndonjë fjale apo shkronje në Kuran, si dhe ngatërresën e tyre.

12. Kurani nxiti revolucionin shkencor më të përhapur në histori, në një kohë rekord. Asnjë libër përveç tij, nuk ka bërë dot një revolucion letrar, shkencor, intelektual dhe gjuhësor vetëm në pak dekada, në një gadishull të izoluar, ku Bibla ishte i vetmi libër në qarkullim.

FORMULIMI I RI GJUHËSOR

Njësoj si letrarët e vendeve të tjera, edhe poetët paraislamë zhvilluan një grup strukturash gjuhësore të përbashkëta, me anë të të cilave shprehnin idetë e tyre dhe prej të cilave nuk lëviznin lehtë. Për pasojë, ata krijuan kështu shabllone (modele) që përbënin sfondin gjuhësor të poezisë së tyre. Prej letërsisë paraislame që na ka ardhur deri sot, ne mund të gjurmojmë disa qindra modele ose forma gjuhësore bazë, që qarkullonin në tregun poetik, para shfaqjes së Shpalljes kuranore. Ato përbënin atë që mund ta quajmë infrastrukturë të *kasideve*, apo poemave paraislame. Shumë prej tyre vazhduan të ekzistojnë edhe pas Shpalljes kuranore, vazhdojnë të përdoren edhe sot nga disa poetë, në shkallë të ndryshme. Këto modele përbënin njësitë gjuhësore primare, që ishin bazë për tërë strukturën e një poeme a një teksti letrar dhe shumë rrallë mund të ketë ndodhur që një poet, shkrimtar

apo orator, t'u jetë shmangur atyre, apo të ketë propozuar forma të reja për të pasuruar strukturën e vjetër gjuhësore.

Këto forma gjuhësore mund të krahasohen me copëzat e një mozaiku, apo lojën me letra. Letrarët do të kishin copëza të gatshme, me të cilat mund të formonin figura gjuhësore, poezitë dhe pjesët letrare. Pasi formohen, poezitë mund t'i duken të reja vëzhguesve të jashtëm. Në të vërtetë, ato nuk ishin gjë tjetër, veçse lëndë e parë bazë, e përdorur për të krijuar forma të reja. Mjafton një shikim i shpejtë mbi vargjet hyrëse të poezive paraislame, për të ilustruar shkallën dhe shpeshhtësinë e kësaj dukurie në poezinë antike arabe: *“ue men jaku dha, ue inni imru'un in..., ala hal ata'anna..., ala lejte shi'ri hal..., ala an'im sabahan ejuha al-rab'..., halilaja murra bi..., amin ali asma' el-tulul el-dauarisu..., ja sahibaja teleueme, ueddi'umamata inne..., ehexhaka min esma'a rasmu el-manazili..., sama leke shaukun ba'da ma kana..., liman talalun bejne el xhadijeh...”*

Ndërsa gjuha e shpalljes kuranore ktheu gjithçka përmbys. Ajo shkallmoi format e vjetra të trashëguara, e grisi copa-copa pëlhurën gjuhësore tradicionale, për të thurur një të vetën dhe për të sjellë forma të reja gjuhësore, të përcaktuara për të tronditur gjerë e gjatë gjuhën letrare arabe. Këto forma të reja nuk kufizoheshin vetëm në një pjesë apo aspekt të Kuranit, por e përfshinin në tërësi atë libër, si pasojë e së cilit, kur njerëzit mësoheshin me të, mund ta dallonin menjëherë, nëse qoftë edhe një frazë e vetme e çfarëdoshme, konstruktim apo shprehje, ishin marrë prej tij.

PJESA MË E MADHE E FORMAVE GJUHËSORE KURANORE NUK PËRSËRITEN

“Shija” unike e ndërtimeve gjuhësore kuranore mund të na bëjë të besojmë se ato përsëriten shpesh gjatë gjithë Librit të Shenjtë, pavarësisht risisë dhe dallimit të tyre, përkundër atyre të

përdorura nga arabët e kohës së Profetit (a.s.), apo në kohën tonë. Është kjo përsëritje që na bën të dallojmë natyrën e tyre kuranore. Gjithsesi, do të habiteshim po të mësonim se numri i ndërtimeve, shprehjeve dhe frazave kuranore që *nuk* përsëriten, është shumë më i madh sesa i atyre që përsëriten përgjatë tekstit kuranor. Në fakt, pjesa më e madhe e ndërtimeve dhe shprehje unike për Kuranin, edhe aty, ndodhin vetëm njëherë. E megjithatë, pavarësisht këtij fakti, ato e ruajnë shijen e tyre të qartë e të dallueshme. Për sa u përket ndërtimeve gjuhësore të letërsisë jokuranore arabe, poezi a prozë qoftë, e kemi të vështirë t'i dallojmë dhe të nxjerrim format apo strukturat e tyre, nëse nuk i kemi dëgjuar apo lexuar shumë shpesh dhe të jemi mësuar me to. Ndaj një tipar tjetër i gjuhës së Kuranit të Shenjtë, është lehtësia me të cilën familjarizohemi me format dhe strukturat e tij, edhe kur ato nuk përsëriten.

Ndokush mund të kundërshtonte në këtë pikë, duke thënë: Pse duhet të pohojmë që vetëm Kurani përmban ndryshime unike ligjërimi? Në fund të fundit, çdo shkrimtar mbi faqen e dheut ka mënyrën e vet unike të të shprehurit dhe të ndryshimeve ligjëruese, të veçanta për shkrimin e tij apo të saj. Kjo sigurisht që është e vërtetë deri në njëfarë mase. Gjithsesi, pavarësisht se sa mund të ndryshojnë stilet gjuhësore njerëzore dhe pavarësisht se sa larg në kohë e hapësirë ndodhen, ato nuk na mundësojnë gjithnjë të dallojmë një autor nga tjetri. Ndodh shpesh, që dy autorë a më shumë, të kenë stile aq të ngjashme, saqë t'i ngatërrojmë. Kjo bëhet e qartë, nëse marrim një fjali nga vepra e një shkrimtari dhe e krahasojmë me fjali të shkrimtarëve të tjerë. Do të sjellim këtu si shembull, një përzgjedhje të rastësishme pohimesh, të bërë nga pesë shkrimtarë arabë, nga periudha letërore të ndryshme; El-Ma'rri, Ibn Mukaffa, Ibn Hazmi, Taha Hussein dhe Mustafa Sadik Rafiiu. Do t'ju kërkojmë të gjeni përkatësinë e shprehjeve sipas autorit. Pohimet janë si më poshtë:

1. Ue emma el-kitabu fe xheme'a hikmeten ue lehuen
(وأما الكتاب فجمع حكمة وهؤا)
2. Ue inne hedhe le juuellidu minel huzni uel asafi gajre ka-
lilin
(وان هذا ليولد من الحزن والأسف غير قليل)
3. Jabtadiun esalibe ue menahixha fi nadhmil kelam
(يبتدعون منهاج وأساليب في نظم الكلام)
4. La jekhafu 'ala ueledihi minel jutm
(لا يخاف على ولده من اليتيم)
5. Ue lakinne el fenne el bejanijje jertefi'u 'ala dhalike
(ولكننا الفنا بيانيز تفععلنذلك)

Nuk ka rëndësi se sa i aftë apo i zhvilluar mund të jetë nga ana letrare, apo sa i thellë e kritik. Edhe një folës i lindur i arabishtes do ta kishte të pamundur të gjente autorin e saktë, vetëm nëse kjo nuk ndodh rastësisht.¹¹ Nëse, në anën tjetër, do të përzgjidhnim vargje nga Kurani, në mënyrë të rastësishme, të gjatë a të shkurtër qofshin, bashkë me këto pesë pohime nga autorë njerëzorë, nga periudha kohore dhe shkolla letrare të ndryshme, edhe për një lexues të pa-praktikuar të Kuranit do të ishte e lehtë t'i dallonte ato.

NDËRTIMET KURANORE UNIKE DHE INTENSIVE

Ndërtimet unike kuranore që nuk përsëriten, janë me shumicë dhe mund të identifikojmë me lehtësi një numër syresh, në secilën faqe

11 Autorët e këtyre pohimeve janë: 1. Ibn Mukaffa', *Kalila ue Dimna*, f. 68; 2. Ibn Hazmi, *Tauk el-Hamama*, f. 216; 3. Taha Husejni, *Fil Edeb el-Xhahili*, f. 315; 4. El-Ma'arri, *Rasa'il Ebi el-'Ala el-Ma'arri*, vëll. 3, f. 587; dhe 5. El-Rafii, *Uehi el-Kelam*, vëll.1, f.16.

të Kuranit. Për t'u siguruar se përfundimet tona janë objektive dhe gjithëpërfshirëse, jo subjektive dhe përzgjedhëse, do të sjellim si shembull faqen e parë të plotë të Kuranit, që përfshin ajetet 6-16 të sures El Bekare. Ky shembull i vogël mjafton për të bërë të qartë, se sa të shumta dhe të larmishme janë këto ndërtime e shprehje. Vetëm në këtë faqe gjejmë 23 ndërtime unike, secila me një strukturë të veçantë, që e dallon dhe veçon, jo vetëm prej ndërtimit të poezisë e prozës arabe, të haditheve profetike, por edhe nga ato që ndeshen në të njëjtën faqe të Kuranit. Do të shohim se, përveç ndikimeve kuranore në gjuhën arabe në tërësi dhe tërheqjes që ajo ushtron mbi shkrimtarët arabë gjatë shekujve, për shkak të stilit elegant e të përpunuar, pjesa më e madhe e këtyre ndërtimeve dhe shprehjeve kanë mbetur unike vetëm për Kuranin. Për pasojë, janë të dallueshme nga çdo lloj shprehjeje gjuhësore njerëzore. Një dukuri të tillë të ngjashme nuk e gjejmë në asnjë gjuhë letrare tjetër në botë, përgjatë shekujve. Më poshtë, po paraqesim disa prej strukturrave për të cilat po flasim, nga paragrafi i përzgjedhur:

- **Ajeti 6:** *seua'un 'alejhim e'endhertehum em lem tundhir-hum, la ju'minun* ("Për ta është njësoj, si i paralajmërove, si jo, ata nuk do të besojnë").
- **Ajeti 7:** *ue lehum 'adhabun 'adhim* ("dhe një vuajtje e tmerrshme i pret ata").
- **Ajeti 8 a:** *ue minen-nasi mej jakulu amenna* ("Dhe ka njerëz që thonë, 'ne besojmë...").
- **Ajeti 8 b:** *ue ma hum bi mu'minin* ("ndërkohë që, në të vërtetë, ata nuk besojnë").
- **Ajeti 9:** *ue me jekhd'a'une il-le enfusehum me ma jesh'urun* ("Ata nuk gënjejnë tjetër veç vetes dhe nuk e kuptojnë").
- **Ajeti 10 a:** *fi kulubihim maradun fe zadahumull-llahu maradan* ("Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe Zoti e lë atë të rritet").

- **Ajeti 10 b:** *ue lehum 'adhabun elim* ("dhe një vuajtje e tmerrshme i pret ata"). Këtu kemi përsëritje të ndërtimit 2.
- **Ajeti 10 c:** *bi ma kanu jekdhibun* ("për shkak të gënjeshtres së tyre të vazhdueshme").
- **Ajeti 11 a:** *ue idha kile lehum la tufsidu fil-erd* ("Dhe kur u thuhet: 'mos përhapni korrupsion mbi tokë...").
- **Ajeti 11 b:** *kalu innema nahnu muslihun* (ata thonë: 'Ne po përmirësojmë gjërat').
- **Ajeti 12 a:** *ela innehum hum el-mufsidun* ("Oh, në të vërtetë, pikërisht ata po përhapin korrupsionin").
- **Ajeti 12 b:** *ue lakin la jesh'urun* ("por nuk e kuptojnë").
- **Ajeti 13 a:** *ue idha kila lehum aminu kema amanan-nasu* ("Dhe kur u thuhet: 'Besoni, siç besojnë të tjerët!...").
- **Ajeti 13 b:** *kalu enu'minu kema amanas-sufaha'u* ("ata përgjigjen, 'A të besojmë siç bëjnë mendjelehtë?...").
- **Ajeti 13 c:** *ala innehum humus-sufaha'u* ("Oh, në të vërtetë, ata vetë janë mendjelehtë"). Këtu kemi përsëritje të ndërtimit 11.
- **Ajeti 13 d:** *ue lakin la ja'lemun* ("por ata nuk e dinë"). Përsëritje e ndërtimit 12.
- **Ajeti 14 a:** *ue idha lakul-ledhine amenu kalu amenna* ("Dhe, kur takojnë ata që janë të lidhur pas besimit, pohojnë...").
- **Ajeti 14 b:** *ue idha khalau ile shejatinihim* ("Por, kur gjenden vetëm me të këqijtë...").
- **Ajeti 14 c:** *kalu... innema nahnu mustehzi'un* ("thonë... 'Vetëm po ngacmonim"). Përsëritje e ndërtimit 10.
- **Ajeti 15 a:** *Allahu jestehzi'u bihim* ("Zoti do t'i shpërblejë për atë tallje [ose: Zoti do të tallet me ta]").
- **Ajeti 15 b:** *ue jemmuduhum fi tughjanihim ja'mehun* ("Dhe do t'i lërë ata për ca kohë në arrogancën e tyre të tepruar, duke i ngecur aty").

- **Ajeti 16 a:** *ule'ike el-ledhine ishtarau el-dalalata bil-huda* ("sepse ata zgjodhën gabimin dhe jo udhën e drejtë").
- **Ajeti 16 b:** *ue me kanu muhtadin* ("... dhe as nuk gjetën udhëzim").

Siç mund të shihet nga kjo listë, katër nga ndërtimet kuranore janë përsëritur dy herë. Gjithsesi, asnjë nga 23 ndërtimet dhe shprehjet e radhitura këtu nuk ngjan me ato të arabishtes jokuranore, përfshirë edhe hadithet profetike. Ndaj edhe po t'i përziem ato me ndërtimet dhe shprehjet e poezisë e prozës arabe, lexuesit do të mund të dallonin me lehtësi se cilat janë prej Kuranit.

E si pra, e përballuan arabët e Gadishullit Arabik të shekullit të shtatë këtë stuhi shprehjesh që frynte mbi ta nga Meka? Ku qëndronte gjuha e Kuranit të Shenjtë në marrëdhënie me traditën massive gjuhësore që kishte lulëzuar në periudhën paraislame? Çfarë reagimesh do të shfaqnin arabët që, deri në atë kohë, ishin mësuar të bënë shkëmbime mes tyre në një treg gjuhësor me disa pak qindra modele gjuhësore bazike, kur ranë menjëherë në kontakt me një libër të mbushur me mijëra forma të reja gjuhësore, të panjohura për prozën dhe poezinë e atëhershme dhe që do të mbeteshin të panjohura edhe për produktin letrar arab të mëvonshëm?

MODELET GJUHËSORE KURANORE: NATYRA DHE PËRBËRJA E TYRE

Veçantia që manifestohet në nivelet e modeleve kuranore dhe të fjalëve të veçanta, njëherazi në marrëdhënien mes fjalëve, ndërtimeve dhe shprehjeve, shërben për të krijuar një gjuhë të dallueshme, që edhe një lexues i zakonshëm nuk do ta ngatërronte me stilet njerëzore. Nuk janë vetëm termat e veçanta kuranore që na bëjnë të mundur të gjejmë dallimet mes pohimeve

kuranore dhe pohimeve të thjeshta njerëzore. As strukturat mbi të cilat ndërtohet gjuha kuranore, apo ritmi i tyre; as figurat e reja letrare kuranore që aq shumë na mahnitin; as mesazhet e tij të mbushura me frymëzim hyjnor, me urtësi, solemnitet, forcë tërheqëse, me jokohësinë e tyre dhe me aftësinë për t'u ngritur mbi çdo mesazh njerëzor. As ligjërimi i dallueshëm qiellor që është kaq plotësisht zotërues, i sigurt, mjeshtëror, i mbushur me dije, bindës dhe ekzaltues mbi çdo shpirt të dobët njerëzor. Cilësia dalluese e tekstit kuranor shkon përtej gjithë kësaj, me mënyrën se si të gjitha këto bëhen bashkë, nëpër njësitë dhe modelet gjuhësore që, edhe po t'i bashkohesh me mijëra pohime e fraza gjuhësore, sërish mund të dallohen qartësisht dhe pagabueshëm, se janë kuranore.

Edhe ndryshimi më i vogël në një model apo shabllon gjuhësor kuranor do të shkaktonte humbjen e metrikës së tij. Dhe, në fakt, ka aq instrumente matëse, sa ka edhe modele gjuhësore kuranore. Këto metra nuk bazohen në zanore apo bashkëtingëllore të pazëshme, siç ndodh në metrikën normale. Nuk bazohen as në rregullat njerëzore që rregullojnë radhitjen dhe homogjenitetin e shkronjave. Në fakt, modelet kuranore për të cilat po flasim, u shmangen këtyre rregullave në plot raste. Megjithatë, pikërisht kjo shmangie i bën më të rrjedhshme dhe mjeshtërore. Për shembull, vargu i mëposhtëm përmban gjashtë shkronja *mim*, njëra pas tjetrës: *ue men adhlamu mimmen mana'a mesaxhida All-llahi en judhkara fiha ismuhu* ("Ndaj, kush mund të jetë më i poshtër se ata që ndalojnë përmendjen e emrit (të Zotit) nga shtëpitë e adhurimit të Tij..." - *Sure El Bekare, 2:114*). Kur lexohet sipas rregullave të texhuidit¹², ky varg del kështu: *ue men adhlamu mimmem-man'a* (وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّنْ مَنَّعَ)... Në suren Hud, 11:48, kemi tetë shkronja *mim*, njëra pas tjetrës: *ue 'ala umamin mimmen ma'ake* - "... mbi ata, si dhe mbi njerëzit (që janë me ta...)". Kur lexohet sipas texhuidit, ky varg del *umamim mimmem-ma...* (أُمِّمٌ مِّمَّنْ مَعَكَ). Me

12 Arti i recitimit të Kuranit, me rregullat e tij të shqiptimit dhe intonacionit.

gjithë këtë paradë të shkronjës *mim*, leximi nuk vjen i rëndë apo i padurueshëm, siç do të ndodhte me tekste të origjinës njerëzore.

Metrika, apo ritmi kuranor, vjen prej elementeve apo faktorëve të tjerë delikatë, të cilët nuk mund të përcaktohen qartë nga mjetet kritike që zotërojmë. Ky vëzhgim është konfirmuar edhe nga një numër mendimtarësh perëndimorë, të cilët kanë krijuar ndjenja për Kuranin gjatë studimit të tij dhe që kanë përshkruar ndikimin e veçantë psikologjik që Kurani ka pasur mbi ta, edhe nëse nuk e dinin kuptimin e tekstit. Autori Jeffrey Lang shkruan për ta:

Siç e dinë shumë të konvertuar, nuk duhet të jesh musliman për të ndërë fuqinë e brendshme të Kuranit dhe shumë syresh e pranojnë më pas Islamin, pikërisht për këtë arsye. Këtë e kanë raportuar edhe shumë studiues jomuslimanë të Kuranit. Studiuesi britanik i arabishtes, Arthur J. Arberry, kujton se si e ndihmoi Kurani të kalonte një periudhë të vështirë të jetës. Ai pohon se të dëgjonte Kuranin e kënduar në arabisht, ishte si të dëgjonte rrahjet e zemrës së vet. Frederick Denny, një shkrimtar jomusliman, e kujton përvojën e të dëgjuarit të Kuranit, si “një përvojë mrekullisht shqetësuese”, që përjetohet ndonjëherë gjatë atij procesi, kur lexuesi nis të ndjejë “një prani të mistershme, ndonjëherë të frikshme”. Në vend që të lexojë Kuranin, lexuesi ndjen se Kurani po e lexon atë.¹³

Në përpjekjen për të përshkruar natyrën e “pëlhurës” së re gjuhësore të Kuranit, nuk duhet të harrojmë faktin se ajo pëlhurë vazhdon të mbetet e re sot e kësaj dite. Çdo gjë që njerëzit shkruajnë apo thonë për herë të parë, me kalimin e kohës, është e paracaktuar të vjetërsohet. Modelet gjuhësore që një poet paraislam mund të ketë prezantuar për herë të parë, ishin të reja asokohe. Megjithatë, pas pak kohe, ato nisën të vjetroheshin, me përdorimin e herëpashershëm nga poetët e tjerë. Ndërsa pjesa më e madhe e modeleve gjuhësore kuranore e ndalën kohën, që

13 Jeffrey Lang, *Even Angels Ask: A Journey to Islam in America* (Beltsville, MA: Amana Publications, 1997), f. 139. Citimi është marrë nga Arthur J. Arberry, *The Koran Interpreted* (Oxford: Oxford university Press, 1964), Hyrja. Citimi është marrë nga Frederick Denny, *Islam* (New York: Harper & Row Publishers 1987), f. 88

nga momenti i parë kur u shpallën, meqë asnjë lloj përsëritjeje nuk mund t'ua rrëmbejë rininë.

Gjuha e përdorur nga Profeti Muhamed (a.s.) mori dy forma të dallueshme nga njëra-tjetra: *hadithi kudsî* (narracioni i shenjtë) – janë thënie, kuptimin e të cilave Profeti (a.s.) e mori me frymëzim hyjnor dhe që i tha me fjalët e tij. Së dyti, hadithet normale - janë thënie të vetë Profetit (a.s.), fjalët që përdori për atë që ai vetë kishte për të thënë. Gjuha e hadithit në të dy këto forma u shënjua nga një shkallë e jashtëzakonshme rrjedhshmërie dhe bukurie. Por njëkohësisht, ajo përmbante disa cilësi njerëzore që e dallonin qartazi nga e gjuha paimitueshme hyjnore e Kuranit. Imagjinoni, për shembull, një fabrikë ku drejtori i saj i mbledh punonjësit dhe u mban një fjalim, se si secili prej tyre është përgjegjës për gabimet e veta. Kur ua thotë këtë, ai dëshiron të mbështetet në një frazë kuranore: “*Ue la teziru uaziratun uizra uhra*” (dhe asnjë nuk do të mbajë barrën e tjetrit”, *sure Fatir*, 35:18), por pa e cituar direkt atë. Kështu, në përpjekje për të parafrazuar, drejtori shprehet duke zëvendësuar disa terma kuranore me të tija, por duke ruajtur strukturën e saj gjuhësore. Ai zëvendëson rrënjën arabe *u-z-r*, me fjalë që rrjedhin nga rrënjja *h-m-l*, duke thënë: “*ue la tahmilu hamilatun himla uhra*”. Duke huazuar këtë model gjuhësor kuranor të dallueshëm, ai e tejkalon aktin e citimit apo të parafrazimit. Ai e ruan të pandryshuar strukturën, ndërkohë që fut aty fjalë të vetat, duke zëvendësuar fjalët e Kuranit, me fjalë që kanë kuptim dhe metrikë të ngjashme. Gjithsesi, në fund, ky del një deformim gjuhësor qesharak.

“ATËHERË, KRIJO NJË SURE TË NGJASHME ME KËTË!” (KURAN, 10:38)

Kjo është arsyeja pse stërgjyshërit tanë talleshin me njerëzit që përpiqeshin, në mënyrë naive, të ulnin Kurandin dhe Islamin, duke sjellë shprehje me struktura gjuhësore qesharake, imitime

të dobëta e duke thënë se ishin sure kuranore. Kjo është arsyeja pse ne ende qeshim me të tilla përpjekje. Përpjekjet për të futur në Kuran diçka të huaj, apo për të formuluar fraza e fjali të nivelit mjeshtëror gjuhësor të Kuranit, bien menjëherë në sy, për shkak të veçantisë së fjalëve dhe shprehjeve të tij, njësoj siç ekspozon testi i ADN-së të vërtetën për atësinë e fëmijës, kur përpiqen që atij t'i japin tjetër atësi, apo kur përpiqen të bëjnë përgjegjës për të, dikë që nuk është. Gjuha e Kuranit është e prirë të refuzojë çdo lloj gjaku të ri gjuhësor që mund të përpiqemi t'i "injektojmë". Në rrjedhën e tij, grupi i gjakut që nuk është i përputhshëm me të, do të shkatërrojë çdo qelizë me të cilën do të jetë në kontakt.

MODELET QË SHËNJUAN TË FOLURËN PROFETIKE

Ekziston një numër i madh thëniesh profetike, që ka ardhur deri në ditët tona, ndaj mund të pyesim: A vlejné karakteristikat e gjuhës qiellore edhe për to? Nëse të njëjtin eksperiment, si më sipër, do ta realizonim edhe me fjalët e Profetit (a.s.), a do të përfundonim me të njëjtën lojë qesharake fjalësh? Si mund të jemi të sigurt, se gjuha e Profetit (a.s.), sado fisnike, superiore e me stil të veçantë, nuk mund të depërtohet apo sajohet, pasi është gjuhë njerëzore?! Edhe një herë, për të mos rënë në subjektivitet dhe për të mos qenë përzgjedhës, duke ruajtur parimin e përzgjedhjes së lirë që përdorëm gjatë analizës së modeleve kuranore, kur studiuam faqen e parë të plotë të Kuranit dhe kur vendosëm të fokusohemi në studimin e një prej sureve më të hershme të Kuranit (*Surja El-Mudeththir*), edhe këtu do të përdorim hadithin që shfaqet në pjesën hyrëse të librit *Rijad es-Salihin* (Kopshtet e të devotshmëve), të Imam Neveviut, që është një prej koleksioneve më të famshme të haditheve të Profetit (a.s.). Në këtë hadith hasim një dallim thelbësor mes së folurës së Zotit (xh.sh.) dhe asaj të Profetit (a.s.):

Omer ibn Hattabi (r.a.) ka thënë: "E kam dëgjuar Profetin (a.s.) të thotë: "Veprat vlerësohen sipas qëllimit (me të cilin kryhen) dhe çdo njeri (do të gjykohet në bazë të) qëllimeve që ka pasur. Nëse dikush emigron me qëllim për të qenë me Zotin dhe të Dërguarin e Tij, do të shpërblehet sipas tij (qëllimit). Por, nëse dikush emigron për gjëra të kësaj bote, apo sepse shpreson të gjejë grua për martesë, do të gjykohet në përputhje me ato qëllime".¹⁴

Secili prej nesh e ka shumë të lehtë të krijojë një shprehje të vetën, bazuar në strukturën e fjalëve hyrëse të Profetit (a.s.): "*innemal-a'malu bil-nijjat*" (e përkthyer në shqip - veprat vlerësohen sipas qëllimit). Dikush mund të thotë, për shembull: "*innemal-'ibrah bil-nata'ixh*" (prova është te shijimi), pa thyer rregullat gjuhësore të pranuar dhe pa u bërë objekt përqeshjeje. Do të ishte njësoj e thjeshtë për ju, të krijoni një pohim, bazuar në modelin e dytë gjuhësor të hadithit të mësipërm: "*ue innema li kul-li imri'in me neua*" (dhe çdo njeri do të gjykohet në bazë të qëllimeve që ka pasur). Mund të thuash, për shembull: "*ue innema li kul-li mutesabikin ma ahraza*" (çdo konkurrent do të marrë atë që meriton), pa ndjerë diçka të çuditshme në atë pohim, pa u trembur se dikush mund të bëjë sarkazëm me të. Në mënyrë të ngjashme, mund të përdoret gjuha e zakonshme për të formuluar pohime, bazuar në modelet e pjesës tjetër të hadithit. Duke imituar modelin: "*fe men kanat hixhratuhu il-Allahi ue resulih, fe hixhratuhu il-Allahi ue resulih*" (nëse dikush emigron me qëllim për të qenë me Zotin dhe të Dërguarin e Tij, do të shpërblehet sipas qëllimi të tij), mund të thuhet: "*fe men kanat gajatuhu el-hajr, fe exhruhu 'adhim*" (nëse dikush synon të bëjë vepra të mira, do të ketë shpërblim të mirë). Ose mbi modelin: "*ue men kanat hixhratuhu li dunia jusibuha au imra'atin jankikuha, fe hixhratuhu ile me haxhara ilejhi*" (por, nëse dikush emigron për gjëra të kësaj bote, apo sepse shpreson të gjejë grua për martesë, do të gjykohet në përputhje me ato qëllime), mund të thuhet: "*ue men kanat gajatuhu malan jarbahuhu au*

14 Ebu Zekeria Jahja ibn Sharaf el Nevevi, *Rijadus Salihin*, red. Abdulaziz Rabah dhe Ahmed Jusuf Dekaku, (Damask: Dar el-Ma'mun li el-Turath, 1980), f. 4.

shuhratan jenaluha, fe exhruhu huue ma ikhtara li nefsihi" (nëse dikush emigron për para dhe famë, atëherë shpërblimi i tij apo i saj do të jetë sipas asaj që ka zgjedhur), pa u ndjerë qesharak, apo pa çuditur lexuesit apo dëgjuesit.

Është fakt, se korpusi i haditheve profetike është depërtuar nga mijëra sajesa. Megjithatë, shkencëtarët e hadithit kanë arritur t'i identifikojnë hadithet e rreme. Duke zhvilluar një metodologji të sofistikuar dokumentuese, ata kanë arritur t'i dallojnë me siguri të plotë ato hadithe. Vetë Profeti Muhamed (a.s.) na ka paralajmëruar për mundësinë e këtyre ndërhyrjeve dhe na ka treguar disa parime mbi të cilat muslimanët do mund të dallonin thëniet e tij autentike, nga ato të depërtuara nga plagjiaturat me interesa personale. Në një hadith të tillë, ai thotë:

Nëse dëgjoni një thënie që më përket mua, që zemrat tuaja e njohin dhe që e ndieni të afërt, do të jem më i gatshëm se ju ta pranoj atë. Nëse, në të kundërt, dëgjoni një shprehje që më vishet mua, por zemrat tuaja e refuzojnë dhe e ndjeni të largët, edhe unë do i largohem asaj më shumë se ju.¹⁵

Duhet të kemi parasysh po ashtu, që, nëse kemi tri versione të një hadithi autentik, të paktën dy prej tyre përmbajnë disa formulime që nuk janë përdorur nga Profeti (a.s.) dhe që janë futur nga rrëfimtaret e zinxhirit të transmetimit. Megjithatë, këto ndryshime të vogla nuk e ndryshojnë natyrën e stilit gjuhësor të Profetit (a.s.).

RISIA E NDËRTIMIT DHE E SHPREHJES

Është e vetëkuptueshme se, kur studiojmë ndërtimet (*tarakib*, njëjës: *tarkib*), shprehjet (*ta'birat*, njëjës: *ta'bir*), modelet (*saba'ik*, njëjës: *sabikah*) dhe lidhjet gjuhësore në Kuran, e kemi të vështirë

15 Treguar nga Ahmedi (Ahmed ibn Hanbeli, *Musnedi*).

të vendosim kufij të qartë mes këtyre elementeve. Gjithsesi, në këtë syth do të përpiqemi të mbetemi brenda arealit gjuhësor që gjendet mes elementeve që po i quaj ndërtime (*tarakib*) dhe shprehje (*ta'birat*). Këtu nuk do t'i hyjmë arealit të fjalëve të veçanta. Nuk do të merremi as me njësitë gjuhësore të përbëra nga katër e më shumë fjalë, pasi, po ta bënim këtë, do të hynim në arealin e modelit (*sabikah*), që është njësi gjuhësore më e madhe dhe mund të përmbajë struktura e shprehje, por që vetë nuk përfshihet brenda tyre. Në këtë diskutim do të merremi vetëm me formulimet dy ose tri fjalëshe që shfaqin (*manifestojnë*) një marrëdhënie të re gramatikore ose retorike, e cila nuk ka ekzistuar në gjuhën arabe para ardhjes së Kuranit. Edhe kufijtë mes ndërtimeve dhe shprehjeve (*ta'birat*) shpesh mbivendosen, gjë që i vështirëson dallimet mes tyre në disa raste. Ndaj, për qëllimet e këtij studimi, kam zgjedhur ta përkufizoj ndërtimin (*tarkib*), si formulim verbal që nuk kumton një ide të plotë dhe që përbëhet kryesisht prej parafjalëve, lidhëzave, parashtesave e prapashtesave, shkronjave të veçanta e të tjera si këto. Ndërsa shprehjet (*ta'bir*) i përkufizoj si formulim verbal që kumtojnë një ide të plotë, ose përafërsisht të plotë, dhe që përbëhen kryesisht prej emrave e foljeve.

NDËRTIMI I STRUKTURËS KURANORE (*TARKIB*)

Kurani u solli arabëve, papritur, mijëra ndërtime dhe shprehje, brenda një harku të shkurtër kohor, nga fillimi, deri në fund të Shpalljes. Këto ndërtime dhe shprehje mbushin suret e shkurtra e të gjata të Kuranit dhe shumë prej tyre hynë në gjuhën arabe, si në gjuhën e përditshme, edhe në atë letrare, edhe pse pjesa më e madhe mbetën vetëm në Kuran, pasi veçantia e tyre e përqendruar nuk e mundësonte futjen në areale të tjera gjuhësore.

Sasi të ndryshme të këtyre ndërtimeve mund t'i hasim në çdo lexim Kurani. Gjithsesi, ne nuk ndalemi në to, nuk u kushtojmë vëmendje të veçantë, nuk shohim diçka të pazakontë aty. Arsyeya pse ndodh kjo, është se jemi kaq të mësuar me Kuratin, saqë këto dukuri janë të pritshme. Por, nëse u hedhim një vështrim të gjatë e të kujdesshëm, nëse përpiqemi ta zbrazim kujtesën, të distancohemi nga familjariteti me tekstin dhe të mbajmë në mendje vetëm gjuhën e përditshme, të shkruar apo të folur, sikur të mos kishim njohur gjë tjetër veç saj, do ta gjenim veten papritur, përballë një gjuhe tërësisht të re, që nuk mbart asnjë formë lidhjeje me gjuhën tonë njerëzore të përditshme, pavarësisht se bazohet në të njëjtat rregulla.

| Ndërtimi kuranor | Struktura e përdorur në arabishten e përditshme | Përkthimi shqip |
|----------------------------------|--|--|
| men dhe el-ledhi | men el-ledhi | Kush është ai/ajo? |
| hal ' asejtum | <i>Hal juntazaru minkum</i> | A mundesh/ mundeni? |
| <i>fa'idh lam ja'tu</i> | <i>fa me damu'axhizin'an an ja'tu</i> | Nëse nuk janë në gjendje të sjellin... |
| <i>ba'da idh</i> | <i>ba'da an</i> | Pas... |
| <i>ue kedhalike xhe'alna</i> | <i>ue hakadha xha'alna</i> | Kështu, Ne bëmë... |
| <i>ue'inne kul-lan lamma</i> | <i>ue kul-lu uehidin minhum</i> | Secili prej tyre... |
| <i>in kada la judil-luna</i> | <i>kada an judil-lanā</i> | Për pak na ngatërroi... |
| <i>eue leu xhi'tuke</i> | <i>hatta in xhi'tuke</i> | Edhe nëse ju sjell... |
| <i>fe lamma an xha'a</i> | <i>fe lamma xha'a</i> | Kur erdhi... |
| <i>Inna le nahnū al-ghalibun</i> | <i>innana sa naghlibuhum</i> | Ne do t'i mundim ata... |
| <i>fima hahuna aminin</i> | <i>aminin huna</i> | (je/jeni) të sigurtë këtu... |
| <i>kalilan ma</i> | <i>ma akal-la</i> | Rrallë... |

Tabela 1: Krahasimi i ndërtimeve të reja në Kuran me arabishten e përditshme.

Një vështrim i shpejtë mbi listën e mësipërme të ndërtimeve, pjesa më e madhe e të cilave përsëritet shpesh në Kuran, do të jetë i mjaftueshëm për të treguar se sa ndryshojnë prej formave gjuhësore që arabët përdorin në përditshmëri.

Ato përdoren rrallë, sepse, siç e kemi theksuar, përbëhen nga parafjalë, parashtesa e prapashtesa, lidhëza, shkronja të veçanta e të tjera si këto. Megjithatë, jemi në gjendje të gjurmojmë dymbëdhjetë ndërtimet e mëposhtme në *suren El Muddeththir* (shih tabelën 2).

Kur vijmë te çështja se sa shprehje të reja gjenden në këtë sure, do të ishte më mirë të pyesnim, nëse aty gjendet ndonjë shprehje që nuk është e re. Surja El Muddeththir ka 56 vargje që nuk zënë më shumë se dy faqe. E megjithatë, vetëm në këtë sure gjejmë rreth 65 shprehje dhe 12 ndërtime të reja, në një hapësirë prej 56 vargjes, 30 prej të cilave përbëhen vetëm prej dy ose tri fjalësh.

| Ndërtimet | Përkthimi shqip | Ajeti |
|-------------------------------|---|-------|
| <i>Fe dhalike jauma'idhin</i> | Atë ditë do të jetë... | 9 |
| <i>Kel-la innehu</i> | Jo, vërtet, është... | 16 |
| <i>Fe kutile kejfe</i> | E zëntë vdekja për mënyrën se si... ¹⁶ | 19 |
| <i>Thumme kutile kejfe</i> | Po, e zëntë vdekja për mënyrën se si... | 20 |
| <i>In hadha il-la</i> | Kjo e gjitha është vetëm... | 24 |
| <i>Ue ma edrake ma</i> | E çfarë mund të bëjë të kuptosh... | 27 |
| <i>Kedhalike judil-lu</i> | Kështu Zoti e lë të humbur,, | 31 |
| <i>Kel-la uel kamari</i> | Pasha hënën... | 32 |
| <i>Lem neku min</i> | Ne nuk ishim mes atyre që... | 43 |
| <i>Fe ma lehum'an</i> | Atëherë, çfarë është e keqe me ta... | 49 |
| <i>Kel-la bel la</i> | Jo, por ata nuk... | 53 |
| <i>Il-la en jeshu (Allāh)</i> | Vetëm nëse kështu do (Zoti)... | 56 |

Tabela 2: Dymbëdhjetë ndërtime të reja në suren El Muddeththir.

16 Në këtë varg mbështetem në përkthimet anglisht të Muhammed Asadit dhe Abdullah Jusuf Aliut.

Kjo do të thotë se zor të ndodhet në këtë sure ndonjë shprehje e njohur për arabët, para zbritjes së Kuranit. Akoma më i jashtëzakonshëm dhe ngacmues është fakti se 52 nga këto 65 shprehje ndodhen vetëm në këtë sure. Kjo konfirmon edhe njëherë, jo vetëm risinë e gjuhës kuranore, por edhe faktin se secila sure e Kuranit shënjohej prej një personaliteti të dallueshëm gjuhësor. Kjo është një dukuri që do ta hasim në mënyrë të vazhdueshme në studimin e sureve të shkurtra, në vëllimin e dytë. Tabela më poshtë, përmbledh 65 shprehjet e reja të sures El Muddeththir.

| Nr. | Shprehja | Përkthimi shqip | Ajeti |
|-----|---------------------------------------|--|-------|
| 1 | <i>ja ejuha al-muddeththir</i> | “O ti (në vetminë tënde) i mbuluar! | 1 |
| 2 | <i>kum fe’endhir</i> | Ngrihu dhe paralajmëro! | 2 |
| 3 | <i>ue rabbeke fe kebbir</i> | dhe madhëroje Mbajtësin tënd! | 3 |
| 4 | <i>ue thijabeke fetahhir</i> | dhe pastroje brendinë tënde (ose veshjet e tua)! | 4 |
| 5 | <i>ue er-ruxhze fehxxhur</i> | dhe largoju fëlliqësisë! | 5 |
| 6 | <i>ue la temnun testekthir</i> | dhe mos kërko përfitim prej asaj që jep (fal/dhuron)! | 6 |
| 7 | <i>ue li rabbike fesbir</i> | dhe ktheju Mbajtësit tënd me durim! | 7 |
| 8 | <i>fe’idha nukire fi en-nakur</i> | dhe (paralajmëro gjithë njerëzit se), kur të fryjë Suri | 8 |
| 9 | <i>jaumun ‘asirun</i> | ... një ditë angushtie | 9 |
| 10 | <i>alel kafirine gajru jesirin</i> | e vështirë për të gjithë ata që (tani) mohojnë të vërtetën | 10 |
| 11 | <i>dherni ue men khalektu uahidan</i> | më ler të vetëm (të merrem) me atë që e krijova vetëm | 11 |
| 12 | <i>ue xhealtu lehu malan</i> | dhe të cilit i dhashë burime | 12 |
| 13 | <i>malan mamdudan</i> | burime (rezerva/pasuri) të shumta | 12 |
| 14 | <i>benine shuhudan</i> | dhe fëmijë si dëshmitarë (të dashurisë) | 13 |

| Nr. | Shprehja | Përkthimi shqip | Ajeti |
|------------|--|---|--------------|
| 15 | <i>mehhedtu lehu temhidan</i> | jetës së të cilit i dhashë një qëllim kaq të madh | 14 |
| 16 | <i>jetma'u en ezid</i> | ai me grykësi dëshiron t'i jap edhe më shumë | 15 |
| 17 | <i>kana li ajatine 'anidan</i> | ai me vetëdije e kokëfortësi kundërshton mesazhet Tona. | 16 |
| 18 | <i>sa urhikuhu sa'udan</i> | Do ta detyroj atë të durojë një ngjitje të mundimshme | 17 |
| 19 | <i>fakara uekaddara</i> | sepse ai mendoi dhe bëri plan | 18 |
| 20 | <i>fe kutile kejfe kaddar</i> | e zëntë vdekja për mënyrën si mediton! | 19 |
| 21 | <i>'abese ue basar</i> | atëherë ai u vrenjt dhe vështroi | 22 |
| 22 | <i>edbere ue istekber</i> | ia kthen kurrizin (mesazhit Tonë) dhe lavdërohet me arrogancë | 23 |
| 23 | <i>sihrun ju'ther</i> | rrjedhshmëri magjepsëse e trashëguar (prej kohëve të vjetra) | 24 |
| 24 | <i>se'uslihi sekar</i> | do ta vë të durojë zjarrin e ferrit | 26 |
| 25 | <i>le tubki ue le tedher</i> | që nuk e lë të jetojë e as të largohet (të vdesë) | 28 |
| 26 | <i>leuahetun lil-besher</i> | duke e bërë (tërë të vërtetën) të dukshme për vdekatarin | 29 |
| 27 | <i>as'haba al nar</i> | Mbikëqyrës të zjarrit | 31 |
| 28 | <i>ue ma xhealna 'iddetehum</i> | Dhe numrin e tyre nuk e bëmë | 31 |
| 29 | <i>fitneten lil-ledhine keferu</i> | sprovë për ata që zotohen të mohojnë të vërtetën | 31 |
| 30 | <i>el-ledhine utul-kitabe</i> | Atyre që u ka zbritur Shpallja | 31 |
| 31 | <i>jezdade el-ledhine amenu imanan</i> | Se ata që i përmbahen besimit, mund ta forcojnë edhe më tej atë | 31 |
| 32 | <i>fi kulubihin maradun</i> | Ata që kanë sëmundje në zemrat e veta | 31 |

| Nr. | Shprehja | Përkthimi shqip | Ajeti |
|------------|---|--|--------------|
| 33 | <i>(madha) arada Allahu bi hadhe methelan</i> | (Çfarë) do të tregojë Zoti (yt) përmes kësaj parabole? | 31 |
| 34 | <i>judil-lu Allahu men jesha</i> | Kështu, Zoti i tij e lë të humbur | 31 |
| 35 | <i>ue jehdi men jesha</i> | dhe udhëzon atë që dëshiron | 31 |
| 36 | <i>xhunude rabbike</i> | ushtarët e Mbajtësit tënd | 31 |
| 37 | <i>dhikre lil-bashar</i> | Një përkujtim për njeriun e vdekshëm | 31 |
| 38 | <i>kel-la ue el-kamar</i> | Jo, pasha Hënën! | 32 |
| 39 | <i>ue el- lejli idha edbar</i> | dhe natën kur largohet | 33 |
| 40 | <i>ue el-subhi idha esfar</i> | dhe mëngjesin kur agon | 34 |
| 41 | <i>le ihde el-kubar</i> | një prej (paralajmëtimeve) të mëdha | 35 |
| 42 | <i>nadhiran lil-bashar</i> | një paralajmërim për njeriun e vdekshëm | 36 |
| 43 | <i>en jetekaddama au jete'ehhar</i> | për të ecur para, ose për t'u tërhequr | 37 |
| 44 | <i>bi ma kesebet rahinah</i> | do të mbahet peng për çdo punë (të keqe) | 38 |
| 45 | <i>as'hab el-jemin</i> | ata që i janë përmbajtur rrugës së drejtë | 39 |
| 46 | <i>fi xhennetin jetesa'elun</i> | (banues) në kopshte (të parajsës) do të pyesin | 40 |
| 47 | <i>jetesa'elune 'an el-muxhrimin</i> | do të pyesin ata që u përumbën në mëkat | 40-41 |
| 48 | <i>me salakakum fi seker</i> | Çfarë ju ka sjellë në zjarr? | 42 |
| 49 | <i>lem neku min el-musal'lin</i> | Nuk ishim prej atyre që faleshin | 43 |
| 50 | <i>ue lem neku nut'im el-miskin</i> | dhe as nuk e ushqyem atë që kishte nevojë | 44 |
| 51 | <i>nekhudu ma'a el-khaidin</i> | e kishim zakon të kënaqeshim duke mëkatuar, bashkë me tërë (të tjerët) që e gjenin kënaqësinë në mëkat | 45 |
| 52 | <i>jaum el-din</i> | Dita e Gjykimit | 46 |

| Nr. | Shprehja | Përkthimi shqip | Ajeti |
|-----|-----------------------------------|--|-------|
| 53 | <i>nukedhdhibu bi jaum el-din</i> | dhe e kishim zakon, që Ditën e Gjykimit ta quanim gënjeshtër | 46 |
| 54 | <i>atana el-jakin</i> | deri atëherë, kur ajo erdhi me siguri mbi ne (me vdekjen) | 47 |
| 55 | <i>shefa'at el-shafi'in</i> | ndërmjetësimi i kujtdo që mund të ndërhyjë për ta | 48 |
| 56 | <i>an el-tedhkirati mu'ridin</i> | ata largohen prej këshillës | 49 |
| 57 | <i>humurun mustenfirah</i> | Si gomerë të tmerruar | 50 |
| 58 | <i>ferrat min kasuarah</i> | që arratisen nga luani | 51 |
| 59 | <i>ju'ta suhufan muneshsherah</i> | t'u jepeshin shpallje të veçanta | 52 |
| 60 | <i>la jekhafun el-akhirah</i> | nuk i frikësohen jetës tjetër | 53 |
| 61 | <i>innehu tedhkirah</i> | kjo është këshillë | 54 |
| 62 | <i>fe men sha'a dhekerah</i> | cilido që dëshiron, mund ta fusë në zemër | 55 |
| 63 | <i>jesha' Allah</i> | kështu do Zoti | 56 |
| 64 | <i>ehlu el-tekua</i> | i Denjë për drojën tuaj | 56 |
| 65 | <i>ehlu el-megfirah</i> | i Denjë për t'ju falur | 56 |

Tabela 3: 65 shprehjet e reja të sures El Muddeththir.

Me përjashtim të dy shprehjeve: *lā tubkī ue lā tedher* (në ajetin 28) dhe *jeshāAllāh* (në ajetin 56), të cilat më vonë u bënë pjesë e gjuhës formale e joformale arabe, pjesa tjetër e tyre mbetën të përdorura vetëm në Kuran.

FJALËT E VEÇANTA DHE MREKULLIA E KOMBINIMIT TË RISISË ME QARTËSINË

Kurani është i mbushur me fjalë të reja, një fakt që ka nxitur disa autorë perëndimorë skeptikë të deklarojnë se gjuha e tij nuk

është arabishte e vërtetë. Duket se ata nuk kanë vënë re, se vetë Kurani pohon më shumë sesa një herë, se ka zbritur “në gjuhën e qartë arabe” (*Sure Esh Shu’ra*, 26:195).

Së fundmi, orientalisti gjerman Kristof Luksenberg, ithtar i një forme ekstreme të kësaj pikëpamjeje, në librin e tij “Një lexim sirio-aramaik i Kuranit”, të botuar në vitin 2000 në Gjermani, pretendon se Kurani është “farkëtuar” prej Muhamedit (a.s.) prej teksteve të krishtera. Ky nocion përsëritet vazhdimisht, si nga orientalistët, ashtu edhe nga evangjelistët e krishterë. Sipas Luksenbergut, gjuha e Kuranit nuk është arabisht, por sirio-aramaike, pra gjuha e folur nga tregtarët që vizitonin Mekën dhe ndërvepronin me banorët e saj. Luksenbergu shkon aq larg, sa të deklarojë se, nën dritën e këtij “fakti”, kuptimet e Kuranit janë krejt të ndryshme nga ajo që interpretuesit muslimanë kanë menduar.¹⁷

As që diskutohet, se teza e Luksenbergut mbi origjinën sirio-aramaike të Kuranit është diskretituar gjerësisht nga studiuesit muslimanë e jomuslimanë, pavarësisht nga zhurma dhe trumbetimi që shpesh shoqërojnë akuza të tilla, qartësisht të pavërteta.

Fakti është se, përkundër pretendimeve të Luksenbergut, fjalët e reja kuranore shfaqen në forma që përmbushin kriteret që përbëjnë thelbin e gjuhës arabe dhe të rregullave gjuhësore të saj. Vështirë se gjen një term të vetëm në Kuran, që nuk u përmbahet këtyre formave. Për më tepër, fjalët e reja të prezantuara në Kuran shfaqen në kontekste gjuhësore unike, të cilat ia mundësojnë lexuesit kuptimin e tyre, pavarësisht se janë të reja. Kështu, kombinimi i risisë me qartësinë përbën edhe një tjetër aspekt të mrekullisë inovative të gjuhës kuranore.

17 Christof Luxenberg, *The Syro-Aramaic Reading of the Koran: A Contribution to the decoding of the Language of the Koran* (Berlin: Verlag Hans Schiller, 2007).

RËNDËSIA E TERMAVE TË REJA QË GJENDEN NË KURAN

Prezantimi i një termi të ri konsiderohej ngjarje e madhe për një poet ose letrar arab, veçanërisht nëse ky term linte gjurmë në zemrat dhe mendjet e njerëzve, nëse hynte në bisedat e tyre të përditshme, apo nëse përdorej më pas edhe nga poetët e tjerë. Shfaqja e një fjale të tillë, qoftë edhe njëherë të vetme, në produktin e një poeti bënte që njerëzit ta thërrisnin poetin me atë fjalë, duke zëvendësuar emrin e tij të vërtetë. Kështu ishte, për shembull, poeti arab i periudhës para islame, Al Nabighah Al Dhujbani (vd. 604 e.s.), të cilin nisën ta thërrisnin sipas thënies së tij: *fa kad nabaghat lena minhum shu'unun* (فقد نبغت لنا منهم شؤون); Al Murekkesh Al Ekber e mori emrin bazuar në thënien e tij: *rakkasha fi dhahr al-adimi kalam* (رکش في ظهر الأديم قلم), ndërsa titulli i dhënë Musejeb ibn Alasit (vd. 575 e.s.), e kishte origjinën në thënien e tij: *ghizaran fe kulu lil-musajjabi jalhaki* (غزاراً فقولوا للمسيب يلحقي).

Ekzistojnë disa fakte që duhet t'i marrim parasysh, kur studiojmë gjuhën e Kuranit të Shenjtë, të lidhura me termat e tij të reja në veçanti. Edhe për një fëmijë do të ishte e lehtë të shpikte fjalë të reja, sapo të mësonte mirë alfabetin. Ai mund t'i kombinojë shkronjat sipas dëshirës, për të formuar miliona fjalë të reja. Por është e rëndësishme të pyesim: kush do t'i kuptonte më pas ato fjalë dhe cila do ishte vlera e tyre letrare? Në këtë pikë, realiteti i mrekullisë kuranore manifestohet qartësisht. Arabët e shkretëtirës në shekullin e shtatë e kuptuan tekstin e ri që në çastin e parë, pavarësisht faktit se u sollti një gjuhë të re në gjithë format dhe përmasat themelore: fjalët, parafjalët, emrat, foljet, ndërtimet, shprehjet dhe modelet, marrëdhëniet mes fjalëve, format e reja gramatikore, konceptet e reja dhe gjykimet ligjore, rrëfimet historike dhe faktet shkencore. Ata jo vetëm që kuptonin çka po dëgjonin, por edhe nisën të ndienin një admirim të thellë, gati-gati mrekullim. Si besimtarët, ashtu edhe dyshuesit, e

pranuan vetvetiu superioritetin dhe pamundësinë për të arritur lartësitë e Kuranit.

Termet e rinj kuranorë mund të klasifikohen lehtësisht në pesë grupe:

1. Fjalë që arabët i njihnin, por të cilave Kurani u dha kuptime të reja, sipas kontekstit gjuhësor ose retorik ku shfaqeshin. Për shembull, fjalët: *sultan* (autoritet), *marad* (sëmundje, metaforë për mungesën e besimit), *teuel-la* (largohu nga), *eslema* (dorëzim i vetes te Zoti), *el-dunia* (tokësorja, jeta e kësaj bote), *el-salihat* (veprimet e drejta) *el shuhada* (dëshmorët), *el-ruh* (shpirti, xhani, engjëlli Xhebrail), *khashi'in* (nderues, respektues), *nebtehilu* (lutemi para Zotit), *isr* (barrë, metaforë për ndalesën), *kitab* (zbulesë hyjnore), *el-bejjineh* (provë, dëshmi, një metaforë për shpalljen islame), *el-birr* (mëshirë, drejtësi), *'iuaxh* (i devijuar, kundërshtues), *el-harth* (kultura bujqësore, lërim, plugim, metaforë për gruan-bashkëshorte), *jandhurun* (gykoj, marr në konsideratë, vlerësoj), *jastun* (sulmoj), *el-muhtedun* (i udhëzuar për mirë, metaforë për besimtarin), *jakdir* (paracaktim) dhe *jukaddir* (shpërndarje).
2. Fjalë të reja, sa i përket prejardhjes etimologjike, por me rrënjë gjuhësore të njohura për arabët e asaj kohe. Kjo kategori, që është më e gjerë se e para, përfshin fjalë të tilla, si: *atahu* (i dha atij), *malakut* (mbretëri, areal, fushë, rajon, zonë), *taghut* (forcat e së keqes), *al-xhahilijah* (kohët e injorancës, periudha para islamike), *salauat* (shtëpitë e adhurimit), *hadu* (pasim i fesë judaike), *makami'* (kufizues, hekura, si hekura burgu), *el-furkan* (ajo që dallon të vërtetën nga e sajvara), *al-rakim* (mbishkrim, gdhendje), *markum* (regjistrim, i regjistruar, shënjim, i shënuar), *el-mihrab* (kamare), *el-kasas* (tregime, histori, rrëfenja), *ghuzza* (luftim), *el-muhtedhir* (vathë dhensh), *el-an'am* (bagëti), *dehhaha* (e mbështjell "Tokën"), *su'ur* (çmenduri),

tezaularu (u shmangën nga), *multahad* (strehim), *el-'adun* (ata që i tejkalojnë kufijtë), *rabbaniyyun* (njerëzit e Zotit), *kanitun* (i bindur), *el-munafikun* (hipokritët), *il-liyyun* (në formën më të lartë), *shakur* (thellësisht falënderues (ndaj një qenieje njerëzore), mirënjohës (ndaj Zotit)), *el-hajauan* (jeta e vërtetë), *el-su'ë* (e keqja), *el-selsebil* (burim në parajsë), *tilka'* (drejt diçkaje), *ua'adna* (lamë takim, u takuam me).

3. Fjalë që, pasi e kalojnë fazën e risisë, hyjnë në një fazë pasurie dhe ndërveprimi më të madh me jetën e përditshme. Kjo e fundit ishte fazë qëndrueshmërie, e një përhapjeje dhe përdorimi më të gjerë. Në raste të tilla, fjala apo grupi i fjalëve mori karakteristikat e një “termi teknik” që kishte fuqinë të përfshinte kuptime shumë më të gjera e gjithëpërfshirëse sesa vetë termi. Disa shembuj të tillë, janë fjalët apo termat si më poshtë vijon: *mu'min* (besimtar), *kafir* (jobesimtar), *dhikr* (përkujtim, Shpallja islame), *mesaxhid* (vende të adhurimit, ose fjalë për fjalë: “vende ku përulesh në adhurim”), *el-sa'ah* (Dita e Ringjalljes, fjalë për fjalë: “ora”), *exhr* (shpërblim, sidomos në jetën tjetër), *el-takua* (të jesh i vetëdijshëm për Zotin, frika ndaj Zotit), *hasanah* (një punë e mirë, fjalë për fjalë: “diçka e bukur”), *sejji'ah* (punë e keqe), *nikah* (martesë), *el-gajb* (bota e padukshme), *el-shehadeh* (bota e perceptimit), *el-salat* (falje rituale), *el-zekah* (lëmoshë pastrimi), *el-iman* (besimi), *el-xhihad* (përpjekje, luftë), *el-shirk* (t'i bësh ortak Zotit), *el-akhirah* (bota tjetër), *el-kijamah* (ringjallja) dhe *el-nar* (zjarri i Xhehenemit).
4. Fjalë të panjohura ose që nuk kanë qenë në qarkullim më parë ndër arabët, rrënjët e të cilave, po ashtu, nuk njiheshin prej tyre, por që Kurani i përdori në një kontekst gjuhësor që u mundësoi dëgjuesve dhe lexuesve

t'ua merrnin kuptimin përmes zbritjes. Pjesa më e madhe e fjalëve të kësaj kategorie janë fjalë të arabizuara, me prejardhje nga persishtja, greqishtja, abisinishtja, gjuha nabate, gjuha siriane, hebraishtja dhe gjuha kopte. Në këtë grup përfshihen fjalë të tilla, si: *sirat* (rrugë e drejtë), *subhaneke* (lavdia të takon Ty (o Zot)), *ebb* (bar), *kesvereh* (luan), *sixhxhin* (një mënyrë e pakapërcyeshme), *berzekh* (barrierë, hendek), *sixhil'l* (regjistrim), *sixhxhiil* (gur, baltë e pjekur), *tennur* (furrë balte), *diza* (e padrejtë), *kamtarir* (stresuese, shqetësuese), *sundus* (mëndafsh), *istebrak* (armaç), *ebarik* (ibrik, kanë), *el-kist* (masë, gur peshe), *el-kistas* (masë e plotë) *el-firdeus* (parajsë), *mishkah* (kamare llambe), *tuba* (lumturi, bekim), *keratis* (letra), *suradik* (tendë, pavion), *il'l* (pakt, marrëveshje, lidhje gjaku), *kursijj* (karrige, fron), *ara'ik* (kolltukë), *xhibt* (gropë) dhe *jemm* (det i hapur).

5. Fjalë që duken të reja prej kuptimit figurativ ose alegorik që Kurani u dha atyre. Në fakt, pjesa më e madhe e fjalëve në çdo gjuhë janë krijuar në këtë mënyrë. Kurani e pasuroi arabishten me qindra fjalë të tilla, kuptimet figurative të tyre nuk njiheshin më parë ndër arabët. Në këtë grup përfshihen fjalë të tilla, si: *islam* (dorëzim, heqje dorë nga diçka), *kufir* (mbulim, fshehje (e së vërtetës përmes mosbesimit)), *jetezekke* (të pastrohesh / purifikohesh përmes besimit), *sidrah* (shelg), *el-mizan* (peshorja ku do të peshohen veprat e mira dhe të këqija në Ditën e Gjykimit), *harth* (punim i tokës, lërim, përdoret edhe për bashkëshorten në kontekstin e intimitetit seksual), *el-huda* (udhëzim (në rrugën e vërtetë)), *el-dalalah* (humbje e rrugës, gabim), *el-tekua* (të jesh i vetëdijshëm, të frikësohesh, t'i shmangesh (zemërimin të Zotit, përmes veprave të mira)), *ummah* (komb, popull, tashmë përdoret për t'iu referuar popujve muslimanë në veçanti), *libas* (veshje, rrobë, si metaforë nënkupton mbrojtjen shpirtërore),

muhsanat (grua e virtytshme), *ajet* (shenjë, mrekulli; përdoret për t'iu referuar vargjeve të Kuranit), *el-evab* (ai që kthehet; përdoret për t'iu referuar Zotit, si Ai që pranon ata që i drejtohen Atij), *el-exhel* (koha e caktuar, vdekja), *uazirah* (mbajtësi i barrës, shpirti njerëzor), *el-hafirah* (toka, dheu), *el-sahirah* (tërësisht i zgjuar) dhe *el-khunnes* (yjet e fshehur ose të padukshëm).

Gjithsesi, siç mund të jetë e qartë për lexuesin, nuk po i rendisim fjalët e reja të Kuranit si provë për mrekullinë e gjuhës së tij. Kjo mund të shihet te fakti se nga 58 dukuritë e reja gjuhësore që mund të identifikohen në suren El Fatiha, vetëm pesë prej tyre janë fjalë të reja, përkatësisht: *el-rahman*, *el-alemin*, *el-din* (në kuptimin e Ditës së Gjykimit), *el-sirat* dhe *el-dal'lin*.

Kurani përmban fjalët e veta unike, sikurse përmban modelet, ndërtimet dhe lidhjet e veta gjuhësore dalluese. Gjithsesi, duhet të jemi të vetëdijsëm për ndryshimet domethënëse mes vendit që zënë fjalët kuranore në njërën anë dhe modelet kuranore në tjetrën. Ndërsa pjesa më e madhe e fjalëve të veçanta kuranore nuk ishin të panjohura për arabishten e kohës së Profetit (a.s.), këtë nuk mund ta themi për modelet kuranore (*saba'ik* سبائيق). Po ashtu, nuk ishte e vështirë apo e pamundur të huazoheshin fjalë të veçanta për përdorim të përditshëm, ndërkohë që kjo nuk mund të thuhet për përdorimin e modeleve gjuhësore të dallueshme kuranore. Për rrjedhojë, ato mund t'i quajmë “shenja dalluese” të Librit të Shenjtë, të cilat nuk mund të riprodhohen nga asnjë model gjuhësor njerëzor.

FJALËT E REJA TË SURES EL MUDDETHHIR

Në suren El Muddeththir, që përbëhet nga 256 fjalë, afërsisht dy faqe e gjatë, mund të gjejmë jo më pak se 84 fjalë të reja. Pra, në

këtë sure afërsisht një e treta e fjalëve janë të reja. Këtu po japim disa shembuj.

1. *El-ruxhz*: term i ri që përdoret për idhujt ose për torturën.
2. *El-nakur*: term i ri që i referohet bririt që fryn engjëlli Israfil në Ditën e Gjykimit.
3. *Sa'udan*: imazh metaforik ku tortura lidhet me rënien për poshtë, si në humnerë.
4. *Basar*: fjalë e re që ka kuptimin e nxirjes në fytyrë.
5. *Lauuahah lil-besher*: një frazë që merr kuptim të ri, ndërrimi i ngjyrës së lëkurës (*el-basharah*), ose diçka që i shfaqet qartë një qenieje njerëzore (*el-bashar*).
6. *Keferu*: ata që refuzojnë thirrjen islame. Kuptimi origjinal i foljes *kafara* është të fshehësh, të mbulosh. Pra kuptimi është që ata fshehën të vërtetën, duke ia mbyllur asaj mendjet dhe zemrat.
7. *Utu*: formulim i ri me kuptim të ri, pra “atyre iu dha”.
8. *Rahinah*: rrjedh prej foljes me lënë peng, fjala *rahinah* (peng) përdoret me kuptimin “përgjegjës për”.
9. *Selekakum*: formë e re që përdoret në vend të shprehjes “të çoi në”.
10. *Sekar*: term i ri për Xhehenemin (ferrin).
11. *Kasuerah*: term i ri për fjalën ‘luan’ ose hark, shigjetar.
12. *El-megfirah*: fjalë e re për ‘falje (gabimesh)’.

PËRDORIMI I RI I PJESËZAVE NË SUREN EL MUDDETHHIR

Mes gjithë kësaj pasurie me fjalor të ri që ka kjo sure, aty gjenden edhe mbi 14 përdorime të reja të pjesëzave të arabishtes (*edauat*). Për shembull, lidhëza *fe* vendoset në pozicione të ndryshme nga ato

të arabishtes së zakonshme. *Fe* vendoset zakonisht mes dy foljeve ose dy emrave, ku funksioni i saj është të lidhë foljen apo emrin e dytë me foljen apo emrin e parë. Ndërsa këtu, vëmë re se në tri ajetet të njëpasnjëshme (ajetet 3-5) ajo është e vendosur mes kundrinës (që udhëheq fjalinë, në vend që të jetë në fund të saj) dhe foljes së saj (që vendoset pas kundrinës, në vend që të jetë para saj). Kështu, ajetet 3-5 lexohen si më poshtë: *ue rabbeke fe kebbir* (fjalë për fjalë: Dhe Zotin tënd, pra, madhëroje!), *ue thijabeke fe tahhir* (Dhe veshjet e tua, pra, pastroi / purifikoi!), *ue el-ruxhza fe-hxhur* (Dhe fëlliqësisë, pra, largoju!). Në ajetin e shtatë e gjejmë atë mes kundrinorit me parafjalë dhe foljes nga e cila ai varet: *ue li rabbike fe-sbir* (dhe për Zotin tënd, pra, prit me durim).

Për më tepër, në ajetet 16, 32, 53 dhe 54 shohim se *kel-la*, që normalisht përdoret për të shprehur një "Jo!" të theksuar, këtu përdoret si qortim, e ndoshta në kuptimin "me të vërtetë".

Në ajetet 19 dhe 20: *fe kutile kaddere, thumme kutile kejfe kadder* (فَقُتِلَ كَيْفَ قَدَّرَ، ثُمَّ قُتِلَ كَيْفَ قَدَّرَ) (përkthyer në anglisht nga Asadi: "Dhe kështu, ai e shkatërron veten me mënyrën si mediton. Po, ai e shkatërron veten me mënyrën si mediton!" Ndërsa në përkthimin e Abdullah Jusuf Aliut: "Mjerim për të! Si komplotoi (tradhtoi) ai! Po, Mjerim për të; si komplotoi ai!") - pjesëza pyetëse *kejfe* nuk përdoret për pyetje, siç ndodh në arabishten jokuranore. Nuk përdoret as si ndajfolje. Në vend të këtyre, ajo përdoret me një kuptim të ngjashëm me *harf masdari*¹⁸, pra mund të interpretohet së bashku me foljen pasuese, si subjekt i foljes pasuese *kutula*. Në këtë mënyrë, kuptimi i frazës do të ishte *kutula takdiruhu*, që, fjalë për fjalë, do të thotë: "meditimi (ose komploti) i tij u shkatërrua", ose "u shkatërroftë meditimi

18 Shembulli i një *harf masdari* do të ishte pjesëza *an*, që mund të shoqërohet nga një folje e mënyrës dëshirore, ose nga një folje në kohën e shkuar. Mund të thuhet "pasi shkoi" (bada an dhehebe), ose "pasi shkon" (ba'da an jadhhebe). Secili prej këtyre kombinimeve të pjesëzës *an* mund të zëvendësohet me një emër foljor. Ndaj, në vend të *ba'da an dhahaba*, mund të thuhet *ba'da dhihabih* (pas largimit të tij) dhe, në vend të *ba'da an jadhhebe*, mund të thuhet *ba'da dhihabih* (pas largimit të tij).

(komploti) i tij!". Një tjetër interpretim do të ishte *kutilla khaza'a takdirihî*, d.m.th.: "ai u vra, apo u shkatërrua", ose: "u vraftë, u shkatërrroftë! - si kompensim për meditimn apo komplotin e tij". Nëse marrim këto dy interpretime, atëherë nuk ka bazë për ta kuptuar fjalën *kejfe* si pyetëse ose si ndajfolje.

Për më tepër, pjesëza *in* që shfaqet në ajetet 24 dhe 25, përdoret për të shënuar mohim, pra trajtohet si e barasvlershme me *ma* ose *lejsa*. Këto dy ajete thonë: *Fe kala in hadha il'la sihrun ju'thar. In hadha il'la kaulu al bashar.* (فَقَالَ إِنَّ هَذَا إِلَّا سِحْرٌ يُؤْتَرُ إِنَّ هَذَا إِلَّا قَوْلُ الْبَشَرِ) "Pastaj ai tha: 'Kjo nuk është tjetër, përveçse (*in hedhe il'le*) magji prej kohëve të vjetra. Kjo nuk është tjetër, përveçse (*in hedhe il'le*) fjalë e një vdekatarit"¹⁹. Ky përdorim i veçantë i pjesëzës *in*, po aq i përhapur dhe karakteristik sa përdorimi kuranor i fjalës *kana* dhe i frazës *ma zala* (që do të thotë "vazhdon të jetë", kur ndiqet prej një foljeje të kohës së tashme), gjendet kudo në Kuran. Megjithatë, ende nuk e kam gjetur të përdorur në këto mënyra, qoftë edhe një herë, në poezinë paraislame.

Prania e jo më pak se 84 fjalëve të reja në një sure të shkurtër si kjo, e shpallur herët, në fillimet e misionit profetik, kishte fuqinë të shkaktonte një kataklizëm (shembje) të vërtetë në zemrat dhe mendjet e atyre që e dëgjuan për herë të parë. Ndaj nuk duhet të na habisë, që «Utbah ibn Rabi'ah, një prej udhëheqësve kurejshë dhe mjeshtër i gjuhës arabe, pasi dëgjoji 13 ajetet e para të sures Fussilat (41), u kthye te njerëzit e vet i mpirë, i pazoti të kuptonte qoftë edhe një fjalë nga ajo që dëgjoji. Çfarë kataklizme pra, mund të presim, nëse marrim parasysh faktin se, përveç gjithë fjalëve të reja, në Kuran gjenden edhe plot ndërtime, shprehje, modele gjuhësore e metafora të reja, pohime që pranojnë shumë interpretime, ndryshime të përpikta frazash, për të mos përmendur përmasat e reja intelektuale e kulturore që ndërveprojnë me zhvillimet e sipërpërmendura gjuhësore e retorike?!

19 Përkthimi anglisht i Abdullah Jusuf Aliut.

RIKONFIGURIMI I NJËSISË GJUHËSORE

Kur shpërtheu stuhia e parë kuranore, po ashtu, plasën reagime të vrullshme, në përpjesëtim me vrullin e Librit të Shenjtë dhe gjithçkaje që ai sillte me vete. Gjithsesi, me kalimin e kohës, edhe ndikimi te dëgjuesit nisi të zvogëlohej, pasi brezat pasardhës po mësoheshin me gjuhën e tij. Për pasojë, po e humbnin ndjesinë e mahnitjes që kishte provuar brezi i parë i dëgjuesve. Dukuritë e reja kuranore nuk ishin më pengesë për njerëzit, si në fillim. Një nga dukuritë shqetësuese për ta, kishte qenë *ajah* - ajeti apo vargu kuranor. Ai përfaqësonte një koncept të ri, i cili dallonte nga fjalia e thjeshtë (*xhumle*) – njësia gjuhësore bazë e prozës arabe – dhe nga vargu i dyzuar (*bejt*), njësia poetike e poezisë arabe.

Kjo njësi e re gjuhësore (*ajah/ajet*) ndante ato që arabët ishin mësuar t'i bashkonin dhe bashkonte ato që arabët ishin mësuar t'i ndanin. Për pasojë, ajeti shkaktoi një krisje në bazamentin gjuhësor të arabëve, që i shtoi arabishtes përmasa të reja dhe që zgjeroi horizontet e saj tradicionale. Ju lutem, të lexojmë bashkë këtë pjesë të shkurtër nga fillimi i sures Al Imran (3):

وَأَنْزَلَ التَّوْرَةَ وَالْإِنْجِيلَ (3) مِنْ قَبْلُ هُدًى لِلنَّاسِ وَأَنْزَلَ الْقُرْآنَ إِنْ الَّذِينَ كَفَرُوا
بِآيَاتِ اللَّهِ لَهُمْ عَذَابٌ شَدِيدٌ

(v. 3 b) *Ue enzele el-teurate uel-inxhil* (v. 4) *min kablu hudan lil-nasi ue enzele al-furkana imne-l-lehdhine keferu bi ajat il-lahi lehum 'adhabun shedid.*

(v. 3 b)... është Ai që zbriti nga lart Torahun dhe Ungjillin

(v. 4) më herët, si udhëzim për njerëzimin, dhe është Ai që zbriti (mbi njeriun) dalluesin për të shquar të vërtetën nga e pavërteta. Vini re, ata që kanë mohuar mesazhin e Zotit - ata i pret një vuajtje torturuese...

Vini re, se si vargu 3 përfundon para fundit të fjalisë, pra, para “më herët” (*min kablu*), që lidhet me shprehjen foljore "zbriti nga lart Torahun dhe Ungjillin" (*Ue enzele taurah uel inxhil*). Vini

re, se e kundërta ndodh në vargun 4, që zgjerohet përtej fundit të fjalisë që mbyllet me fjalët “për njerëzimin” (*lil nas*) dhe vazhdon me fillimin e një fjalisë të re (“dhe është Ai që zbriti...”). Vargu i katërt pastaj, vazhdon përtej fjalisë që mbyllet me fjalët “... dalluesin për të shquar të vërtetën nga e gënjeshtërtja” (*el-furkan*) dhe përfshin një fjali të re që nuk ka lidhje gramatikore me atë pararendëse: Vini re, “ata që kanë mohuar mesazhin e Zotit - ata i pret një vuajtje torturuese” (*innel-ledhine keferu bi ajat il-lahi lehum ‘adhabun shadid*).

Duke iu kthyer pesë vargjeve të para të sures Er-Rum (30), kam vënë vija diagonale në vendet ku, po të ndahej pasazhi, sipas traditave dhe njësive gjuhësore të zakonshme, atëherë aty do duhej të mbaronte një ajet e të niste një tjetër:

(v. 1) *Elif. Lam. Mim. (v. 2) ghulibet er-rum (v. 3) fi adne el-erd // ue hum min ba'di ghalabihim sa jaghlibun (v. 4) fi bid'i sinina // lil-lahi el-emru min kablu ue min ba'du // ue jeume'edhin jafrahu al-mu'minun (v. 5) bi nasrillahi // jansuru man jasha'u // ue huel-aziz er-rrahim.*

(v. 1) Elif. Lam. Mim. **(v. 2)** U mundën bizantinët **(v. 3)** në tokat e afërta; // megjithatë janë ata që, pavarësisht humbjes, do të fitojnë **(v. 4)** brenda pak vitesh: // (sepse) te Zoti prehet gjithë pushteti i vendimeve, nga i pari tek i fundit. // Dhe atë ditë besimtarët (gjithashtu) do të gëzohen **(v. 5)** me ndihmën e Zotit: // (sepse) Ai ndihmon atë që Ai dëshiron, // sepse vetëm Ai është i Gjithëfuqishmi, Mëshirëbërësi.

Siç mund të shihet nga kjo pjesë, ndarjet kuranore të këtyre pesë vargjeve, pra, pika ku mbaron një varg e nis një tjetër, nuk ka lidhje me mënyrat se si jemi mësuar të ndajmë një fjali nga tjetra.

GJENDJA E RE E LIDHËZAVE TRADICIONALE

Kjo skemë e re e ndarjeve dhe e lidhjeve është një prej karakteristikave më të përhapura të peizazhit gjuhësor kuranor. Tipari

më i spikatur i kësaj skeme është nxjerrja e lidhëzave si *uau, fe, idh, inne, inneme* dhe *kad*, si dhe e përemrave që shfaqen si fjalë të veçanta (si *huue, hije, hum* etj.), prej vendit të tyre tradicional, mes fjalive dhe fjalive të thjeshta), një dukuri kjo që fshin ato që në gjuhësi njihen gjerësisht si “kufij rajonalë”. Si shembull për këtë dukuri, le të lexojmë suren Er-Rad (13:33):

Efemen huue ka'imun'ala kul-li nefsin bi me kesebat ue xhe'alu lil-lahi shureka'e. kul semmuhum em tunebbi'unehu bi ma la ja'lemu fil erdi em bi dhahirin minel kaul. bel zujjina lil-ledhine keferu mekruhumm ue suddu'an el-sebili ue men judlili Allahu fe ma lehu min hadin.

A është pra, Ai që ka nën kujdesin e Tij të Plotfuqishëm çdo qenie të gjallë, sipas asaj që ajo meriton (A është pra, Ai si çdo gjë tjetër që ekziston)? E megjithatë, ata përshkruajnë qenie të tjera si ortakë në shenjtërinë e Zotit! Thuaj: “Jepuni atyre një emër, çfarëdo emri (që dëshironi): por (vërtet mendoni se mund) ta informoni Atë për ndonjë gjë në tokë që Ai nuk e di, apo bëni lojë fjalësh?” Jo, e bukur u duket statuja e rreme atyre që priren të mohojnë të vërtetën dhe kështu, e humbin rrugën. Dhe ai të cilin Zoti e lë në humbje, nuk mund të gjejë kurrë udhërrëfyes.

Nëse shohim për fjalët e nxjerra nga kjo pjesë dhe i vendosim ato në vendet ku do të duhej të ndodheshin, për të shprehur të njëjtin kuptim, por me rregullat tona njerëzore gjuhësore, rezultati do të dukej diçka e tillë:

Efe (hakadhe jekunu) men huue ka'imun'ala kul-li nefsin bi me kesebat ue (kad) xhe'alu lil-lahi shureka'e (fe) kul (lehum) sammuhum (idhan) am (tadhunnune ennekum) tunebbi'unehu bi ma la ja'lemu (bi me juhad) fil erdi em (inne hadhe) bi dhahirin minel kaul (minkum) bel (el-hakku ennehu kad) zujjina lil-ledhine keferu makruhumm ue suddu'an el-sabili ue men judlili Allahu fe me lahu min hadin.

أَفَ [هكذا يكون] مَنْ هُوَ قَائِمٌ عَلَىٰ كُلِّ نَفْسٍ بِمَا كَسَبَتْ ۗ وَأَقْدَمَ [جعلوا لله شركاء] فِي [ف] أَقْلٍ [لهم] سَمُوهُمْ ۗ [إذن] أَمْ [تظنون أنكم] تَتَّبِعُونَ ۗ بِمَا لَا يَعْلَمُ [بما يوجد] فِي الْأَرْضِ أَمْ [إن هذا] يَظْهَرُ مِنَ الْقَوْلِ [منكم] ۗ بَلْ [الحق أنه قد] زَيْنَ لِلَّذِينَ كَفَرُوا مَكْرَهُمْ وَضَلُّوا عَنِ السَّبِيلِ ...

Shohim pra, se fjalët janë zhvendosur të paktën nga dhjetë vende vetëm në këtë varg. Tani, le të mundohemi të kujtojmë lidhëzën që është zhdukur nga vendet e theksuara në ajetet e mëposhtme:

ue kele el-ledhine la ja'lemune leule jukel-limune Allahu au ta'tine
ajetun kedhelike kele el-ledhine min kablihim mithle kaulihim tas-
habahat kulubuhum kad bejenne el-ajati li kaumin jukinun. (Sure
El Bekare, 2:118)

Dhe (vetëm) ata që nuk kanë asnjë dije, thonë: “Pse, pra, nuk na flet ne Zoti e nuk na shfaq as ndonjë shenjë (mrekulli)?” Dhe kështu, njësoj folën edhe ata që jetuan para këtyre, të ngjashme i kanë zemrat. Vërtet, Ne i kemi bërë të gjitha shenjat të qarta për njerëzit e pajisur me një siguri të brendshme.

Kul: inni'ala bejjinatin min rabbi ue kedhdhebtum bihi ma'indi ma
teste'xhilune bihi in el-hukmu il-la lil-lahi jakussu el hakka... (Sure
El-An'am, 6:57)

Thuaj: “Vini re! Kam qëndrimin tim, bazuar në një provë të qartë prej Mbajtësit tim, dhe (kështu) ju po ia vishni Atij gënjeshtëri! Nuk është në fuqitë e mia ajo që (me injorancën tuaj) e kërkon me kaq ngut. Gjykimi nuk i takon kujt tjetër veç Zotit. Ai do ta deklarojë të vërtetën...”

Ue sakhkhara esh-shemse ue el-kamere kul-lun jexhri li exhelin
musamman judebbiru el-emre jufassilu el-ajati la'al-lekum bi lika'i
rabbikum tukinun. (Sure Er-Ra'd, 13:2)

Ai i bëri diellin dhe hënën të binden (ndaj ligjeve të Tij), secili (trup qiellor) ndjek rrugën e tij për një kohë të caktuar (nga Ai). Ai drejton gjithçka që ekziston. Ai i shpjegon qartë këto mesazhe, në mënyrë që të jeni të sigurt thellë në vetvete, se do ta takoni patjetër Mbështetësin tuaj (në Ditën e Gjykimit).

Kjo lloj zhvendosjeje nuk është thjesht vetëm një stil i ri gjuhësor, që Kurani ia ka shtuar gjuhës arabe, por edhe një shtesë domethënëse kuptimore dhe retorike, pasi i jep shprehjes së Kuranit përmasa të pakapshme dhe imtësi imagjinare, që nuk

do t'i kishte pasur ndryshe. Kur brenda një vargu ndodhin lloje të ndryshme zhvendosjesh, shohim se ai bëhet më i rrjedhshëm dhe transparent, sesa kuptimi origjinal bazë.

MARRËDHËNIET E REJA MES FJALËVE

Të gjitha dukuritë e deritanishme kanë të bëjnë me atë që ndodh mes vargjeve e fjalive. Por çfarë mund të themi për fjalët e veçanta dhe marrëdhëniet e tyre të brendshme? Kurani ka qasje të re për thurjen mes fjalëve. Ky lloj i ri lidhjesh të brendshme nuk njihet nga kultura arabe, para shfaqjes së Kuranit dhe, meqë ra fjala, nuk njihet as nga kulturat e tjera, para shfaqjes së shkollave letrare të simbolizmit dhe surrelizmit në kohët moderne. Për pasojë, ai hapi horizonte të reja ideore dhe imagjinuese, që iu shtuan kuptimit fillestar të tekstit.

Marrim si shembull vargun e katërt të sures El Fatiha, që thotë: *maliki jeum el-din* “Zoti (Sunduesi) i Ditës së Gjykimit”. Ky varg përmban një lidhje mes fjalëve, mekanika e së cilës nuk njihet prej arabëve të kohës së Profetit (a.s.). Dëgjuesit e parë të Kuranit, me siguri, e ndjenë ndryshimin mes kësaj lidhjeje verbale dhe atyre me të cilat ishin mësuar, ndaj u tronditën kur e dëgjuan këtë varg për herë të parë. Në fund të fundit, “laboratori i tyre gjuhësor” ishte ende instiktiv dhe primitiv, pasi i mungonin mjetet e përparuara të kërkimit dhe analizës që kemi ne sot. Renditja e fjalëve *malik* - që do të thotë “zot, pronar”, dhe *jeum* - që do të thotë “ditë”, ishte e re, si për arabët, ashtu edhe për jo-arabët, në kohën e shfaqjes së Kuranit. Edhe më parë, edhe sot, ka qenë dhe është e zakonshme lidhja e fjalës pronësi (*mulk*) me objekte konkrete që mund të zotërohen. Ne themi: “pronari i pronës së patundshme”, “pronari i parave”, “pronari i tokës”, “pronari i makinës”, “pronari i deles” etj. Po si mund të flasim për pronar të një dite? A është koha subjekt

pronësie? A do të hapnin bankat apo institucione të tjera financiare llogari në orë e ditë? Përdorimi i frazës “pronar i ditës” ishte një surprizë gjuhësore me një nuancë të dallueshme për arabët e shekullit të shtatë. Gjithsesi, një surprizë tjetër i priste ata shumë shpejt.

Sapo nisën të mësohen me këtë ndërveprim, ata panë një tjetër sinjal, të një lloji që nuk e prisnin, që nisi të dukej mes fjalëve *jeum* (ditë) dhe *el-din* (gjykim). Arabët dhe popujt e tjerë i lidhnin fjalët që lidheshin me një njësi kohe, me fjalë që përshkruanin ngjarje që ndodhnin gjatë asaj njësie kohore. Mund të themi: “një sekondë qetësi”, “një orë pune”, “dita e betejës”, “muaji i agjërimit”, “viti i zisë”, “periudha e luftës”, “epoka e zgjimit” etj. Para se dëgjuesit e parë të Kuranit të kuptonin kuptimin e ri në këtë varg, fjala *din* nuk lidhej me një ngjarje, por me një koncept abstrakt (fetar). Pra, renditja pas një fjale që i referohet kohës (*jeum*), do t’i shkaktonte atyre një bllokim trafikku mendor, pikërisht pas asaj që kishte shkaktuar shoqërimi i pronësisë (*mulk, malik*) me ditën (*jeum*). Kjo kthesë e papritur ishte e theksuar dhe e shpejtë në rrugën që arabët e shekullit të shtatë kishin nisur me këtë dhe me sure të tjera në Kuran. Për pasojë, kapacitetet e tyre të kufizuara njerëzore duhej të përpunoheshin, për të kuptuar e pranuar “telegramet” e shkurtra, por intensive, që vinin njëra pas tjetrës nga Qielli, duke i prezantuar ato me një valë të re lidhjesh gjuhësore, mes fjalive, frazave dhe fjalëve. Me vërshimin e këtyre aspekteve të reja, revolucioni i nisur prej Kuranit, si në arabisht, ashtu edhe në gjuhët e tjera, kaloi përtej gjuhës në sferën e imagjinatës, në formën e imazheve grafike, përdorimeve metaforike dhe stileve retorike të shprehjes.

REPERTORI I RI KURANOR I FIGURACIONIT LETRAR

Poetët e periudhës paraislame përsërisnin shpesh të njëjtat figura letrare. Nëse një figurë letrare e një poeti pëlqehet nga një

poet tjetër, ky e huazonte, e riformulonte dhe e përdorte në një formë të re poetike. Ky ndikim para-islam mbi trajektoren e poezisë arabe vazhdoi për shumë shekuj më pas, duke gjetur rrugë edhe në veprat e disa poetëve dhe shkrimtarëve bashkëkohorë, mundësisht edhe në bisedat e përditshme të njerëzve. Figurat letrare të përdorura e kishin prejardhjen nga ambienti arab. Kështu, trimi ishte luan, frikacaku ishte struc, bujari ishte det, koprraci ishte shkretëtirë, njeriu i qetë e serioz ishte mal, i bukurri ishte diell ose hënë, personi i rafinuar ishte yll, personi kyç ishte shtyllë, personi i papjekur ishte flutur, personi i dashur e i butë ishte qengj, kokëforti ishte krimb ose larvë, mendjemadhi ishte pallua, dinaku ishte dhelpër, floku i zi ishte natë, floku gri ishte ditë, dhëmbët e të dashurit ishin kokrra breshëri, goja e saj ishte unazë ose margaritar, buzët e saj ishin mishtore, faqet e saj trëndafil ose mollë, lotët e saj perla, majat e gishtave të saj ishin fruta xinxife, sytë e saj lule narcisi, fiziku i saj ishte shtizë, balli i saj ishte mëngjes, vetullat e saj ishin shigjeta, flokët e saj që varen në tëmtha ishin akrepa ose skeptrat etj.

Sa i përket Kuranit të Shenjtë, ai i ka anashkaluar virtualisht tërë figurat e trashëguara letrare, duke i hequr nga inventari i tij i shprehjeve dhe duke i zëvendësuar me fjalorin e vet ilustrues, mbushur me figura të reja. Edhe pse nuk kam bërë një hulumtim shterues të figurave që gjenden në Kuran, mund të pohoj me siguri gati të plotë, bazuar në vargjet që kam ekzaminuar për këtë studim, se vullkani i shprehjeve që shpërtheu nga Kurani nuk kufizohet vetëm në krijimin e një inventari të ri kolosal që iu shtua repertorit tonë të figurave metaforike. Njësoj si kishte ndodhur me modelet gjuhësore tradicionale, Kurani i braktisi të gjitha figurat letrare përrshkruese të korpusit poetik para-islam, ku nuk kam mundur të gjej asnjërën prej tyre, në asnjë ajet të vetëm.

Akoma më i rëndësishëm është fakti se Kurani solli një revolucion thelbësor në strukturën artistike të figurave letrare tradicionale, me futjen e lidhjeve tejet të zhvilluara, të shumëllojshme

dhe në dukje të pamundura, mes përbërësve të vetë këtyre figurave letrare, që ishin shumë hapa para asaj kohe. Nëse figurat e përdorura deri atëherë kishin cilësi dhe shprehi të kufizuar, ishin të kufizuara në numër, përbëheshin nga elemente me lidhje të qëllimshme dhe të kufizuara dhe përdoreshin kryesisht vetëm në poezi, Kurani i shembi ato barriera, duke e futur imagjinatën arabe në një epokë të re dhe në një botë të tërë figurash letrare, që, me pasurinë e përmasave të tyre të reja, me dinamikën e brendshme dhe ndërlidhjet mes tyre, kishin qenë tërësisht të panjohura, si për poezinë, ashtu edhe për prozën arabe.

Rregullat tradicionale të vendosura dhe të respektuara nga retoricienët, i ndajnë figurat metaforike në katër elemente: 1. *Mushebbehu* - entiteti i krahasuar me diçka tjetër; 2. *Mushebbih bihi* - entiteti me të cilin bëhet krahasimi; 3. *Edat el-teshbih* - fjala që shënon krahasimin apo ngjashmërinë (është si...); 4. *Uexhh shebeh* - aspekti i ngjashmërisë mes entitetit që krahasohet dhe entitetit me të cilin bëhet krahasimi. Në këtë mënyrë, figura letrare klasifikohet dhe kategorizohet, sipas kriterit të përkatësisë, në një ose më shumë prej këtyre elementeve. Por, nëse përpikëmi që metaforat kuranore t'ua nënshtrojmë këtyre rregullave tradicionale dhe klasifikimeve, do shohim se shumë prej tyre nuk puqen me to. Për shembull, figurat e mëposhtme kuranore nuk mund të analizohen bazuar në rregullat tradicionale të retorikës:

- *Ue lekum fi el-kisasi hajah* - "sepse në (ligjin e) ndëshkimit.... ka jetë për ju" (*Sure El-Bekare, 2:179*).
- *Da'ufa el-talibu ue el-matlub* - "Me të vërtetë, i dobët është kërkuesi dhe e dobët (është) ajo çka kërkohet" (*Sure El Haxh, 22:73*).
- *Ue ef'idetuhum haua'un* - "Dhe zemrat e tyre një hon pafund" (*Sure Ibrahim, 14:43*)
- *Ue jekdhifun bil-gajbi min mekanin ba'id* - "...ata (vazhdimisht) hedhin (shpifje) mbi të padukshmen prej së largu" (*Sure Sebe', 34:53*).²⁰

20 Nga përkthimi anglisht i Abdulla Jusuf Aliut.

FIGURA LETRARE ME SHUMË PËRMASA

Me shfaqjen e Kuranit arabët e periudhës së Profetit u përballën për herë të parë me figurat letrare shumë-përmasore. Kur ekspertët arabë të retorikës nisën të formulojnë rregullat e saj dhe të analizonin figurat metaforike sipas pjesëve të tyre përbërëse, ata nuk patën zgjedhje tjetër përveçse të përjashtonin metaforat kuranore nga analiza, sepse nuk u shkonin për shtat atyre rregullave. Ose më mirë, sepse rregullat e tyre të kufizuara njerëzore nuk mund t'i përmbanin dot në vetvete shtresat shumë-përmasore të metaforave kuranore.

Ndërsa ata që synonin të zvogëlonin rëndësinë e Islamit dhe të Kuranit, i konsideronin si dobësi këto veçanti të metaforave kuranore, si dhe mospërshtatjen e tyre me rregullat tradicionale, mbi bazën e të cilave mund të sulmonin kredon e muslimanëve. Ibn el-Rauandi, mendimtari famëkeq, pasuesit e të cilit sot i thurin lavde për risitë, racionalitetin dhe nocionet përparimtare, i bëri njëherë koment gjuhëtarit dhe letrarit Ibn el-Arabi mbi këtë pasazh kuranor (16:112): *edhakaha Allahu libas el-xhu'i ue el-khafu'i* (fjalë për fjalë: Zoti i shkaktoi atij (qytetit mosmirënjohës) të shijojnë veshjen e urisë dhe frikës)²¹. “A mund të shijohet veshja”? pyeti ai Ibn el-Arabiun. Ky i fundit iu përgjigj: “O majmun, në rregull pra: supozo që Muhamedi nuk ishte profet. Por ti nuk mund të mohosh se ishte arab, apo jo?” Duket sikur Ibn Rauandi po e sfidonte vargun e mësipërm, duke thënë se do kishte qenë më e udhës, që vargu të thoshte: *fe kesaha Allahu libas el-xhu'i* (Zoti i veshi ata me veshjen e urisë) ose *fe edhakaha Allahu ta'm el-xhu'i* (“Zoti i bëri ata të shijojnë (hidhësinë) e urisë”)²².

21 Asadi e përkthen kështu këtë frazë: “Zoti e bëri të shijojë mjerimin gjithëpërfshirës të urisë e frikës”, duke iu referuar në poshtëshënim mënyrës se si fati i keq e mbështjell njeriun si rrobë (Taxh el-Arus). Shih: Muhammed Asad, *The message of the Qur'an* (Gibraltar: Dar el-Andalus, 1984), f. 414.

22 El-Shaukani, *Tefsir Fath el-Kadir*, (Kairo: Dar el-Fikr, pa datë), vëll. 3, f. 200.

FIGURA HIPOTETIKE

Këtu e kam fjalën për atë figurë letrare, e cila ia lë në dorë imagjinatës sonë njerëzore ta përfytyrojmë deri në fund, sepse e pranëvendos *mushebbeh*-un (entitetin e krahasuar) me *mushebbeh bihi* (entitetin me të cilin bëhet krahasimi), gjë që shqisat tona njerëzore e kanë të vështirë ta kapin. Ose mund të krahasojë diçka me diçka tjetër të panjohur, ose që nuk është provuar apo vëzhguar ndonjëherë nga lexuesi.

Një figurë e tillë, natyra e së cilës tërhoqi vëmendjen e ekspertëve të hershëm të retorikës arabe, është ajo ku Kurani krahason frutën e pemës së *zekumit* në ferr (e përkthyer në anglisht nga Asadi, si “pema e frutës vdekjeprurëse”, kurse nga Jusuf Aliu thjesht si “pema e *zekumit*”), me “kokën e shejtanit” (*Sure Es Safat, 37:65*). Meqë asnjë nga ne nuk ka parë ndonjë shejtan e as kokën e tyre, kjo figurë letrare nxit imagjinatën tonë, në përpjekje për të përfytyruar neverinë e kësaj peme që merr formën e krijesës më të ndyrë në faqe të tokës. Kjo lloj figure letrare rrafshon barrierat e ngritura prej metaforave të logjikshme, racionale e të fundme në udhën e imagjinatës njerëzore, që tani gjenden para horizonteve të pafundme të ngjyrave dhe konceptimeve. Tani do përpiqemi të kënaqemi ngadalë dhe thellë, me një numër metaforash kuranore, duke i përthithur në imagjinatën, ndjenjat dhe emocionet tona:

Le tudrikuhu el-ebsaru, ue huue judriku el-ebsar (Sure el-An'am, 6:103) - “Asnjë vështrim njerëzor nuk mund ta përfshijë Atë, kurse Ai e përfshin gjithë vështrimin njerëzor”.

Jeume tubeddelu el-erdu gajre el-erdi ue el-semeuatu (Sure Ibrahim, 14:48) - “Në ditën kur Toka do të ndërrohet me një tjetër tokë, sikurse edhe qiejt”.

Ue asbahafu'adu ummi musa farighan (Sure El Kasas, 28:10) - “dhe zemra e nënës së Moisiut u zbraz” (e përkthyer në anglisht nga

Asad: “një boshllëk i dhimbshëm nisi të zmadhohej në zemrën e nënës së Moisiut”).

Uel lau ennem fi el-erdi min shexheretin aklamun ue el-bahru jemu-dduhu min ba'dihi seb'atu abhurin ma nefidat kelimatu Allah (Sure Lukman, 27)- “Sikur të gjithë drurët që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut”.

Uel erdu xhemian kabdatuhu jeume el-kijameti ue el-semauatu matuijatun bi jeminih (Sure El-Zumar, 39:67) – “... e gjithë toka do jetë sa një grusht për Të, në Ditën e Ringjalljes, dhe qiejt do të mbështillen në dorën e Tij të djathtë”.

Fe idhe inshakkat el-sema'u fe kanat uardaten kel-dihani (Sure Er-Rrahman, 55:37) - “E, kur të çahet qielli e të bëhet kuq, si jav që digjet”.

Uel lekad zejjana el-sema' el-dunia bi mesabiha ue xhe'alnaha ruxhunan lil shejatin (Sure El-Mulk, 67:5) - “Dhe vërtet, Ne i kemi zburuar qiejt pranë tokës me drita dhe i kemi bërë ato objekte të hamendësimeve të kota për të këqijtë” (Asadi), ose: “Dhe Ne kemi (prej kohëve të vjetra) zburuar qiellin e poshtëm me llamba dhe i kemi bërë ato gjuajtës për të larguar djajtë” (Abdullah Jusuf Ali).

Ue in jekadu el-ledhine keferu le juzlikuneke bi ebsarihim (Sure El-Kalem, 68:51) - “Dhe jobesimtarët do të donin të të zhduknin me një shikim...” (Abdullah Jusuf Ali).

LLOJET E FIGURAVE LETRARE NË SUREN EL-MUDDETHIR (74)

Nëse i hedhim një sy sures El-Muddeththir, do të shohim se përmban jo më pak se 31 figura të tipave të përmendura këtu. Nuk duhet të harrojmë, se këto figura ishin tërësisht të reja për arabët e kohës së Profetit (a.s.), si ato që bazoheshin në elemente të njohura paraislame, ashtu edhe ato përtej tyre.

| Figura letrare | Përktimi shqip | Ajeti | Klasifikimi retorik |
|-------------------------------------|---|-------|--|
| Ue thijabeke fe tahhir | “Dhe vetveten tënde (rrobat tua) pastroji” | 4 | Metaforë (fjala rrobë përdoret për t’iu referuar vetvetes së brendshme) |
| Sa urhikuhu sa’udan | “Do ta detyroj atë të durojë një ngjijtje malore të dhimbshme” | 17 | Metonimi ose nënkuptim për një vuajtje intensive të paspecifikuar. |
| edbara ue istekbera | “ai i kthen kurrizin (mesazhit Tonë) dhe vetëlëvdohet me arrogancë” | 23 | Metonimi apo aludim, ku fraza “i kthen kurrizin” lidhet me aktin e refuzimit dhe mohimit. |
| Keferu | “janë të prirë për të mohuar të vërtetën” | 31 | Metaforë, ku mohimi i së vërtetës lidhet me aktin e mbulimit të mendjes (fjala <i>kefera</i> do të thotë të mbulosh, të fshehësh). |
| Judil-lu Allahu men jesh’a’u | “Zoti çon në humbje atë që dëshiron (të gabojë udhë)” | 31 | Krahasim, ku akti i lënies në mosbesim krahasohet me çuarjen e dikujt në rrugë të gabuar. |
| Jehdi men jesh’a’u | “dhe udhëzon atë që dëshiron (të udhëzohet)” | 31 | Krahasim, ku akti i shpënies drejt (apo mundësimit të) besimit krahasohet me udhëzimin e dikujt në rrugën e drejtë. |
| Uel subhi idha asfara | “Dhe për agimin, kur nis të zbardhë” | 34 | Krahasim, ku agimi lidhet me aktin e heqjes së mbulesës së natës (fjala <i>asfara</i> do të thotë zbulim apo shpalosje). |
| Kul-lu nefsin bi ma kesebet rahinah | “çdo qenie njerëzore do të mbahet peng i së keqes që ka bërë” | 38 | Krahasim, ku qenia njerëzore krahasohet me kycjen pas hekurave për veprimet që ka bërë. |

| Figura letrare | Përkthimi shqip | Ajeti | Klasifikimi retorik |
|-----------------|--|-------|---|
| As-hab el jemin | “ata që do të kenë arritur mirësinë” (fjalë për fjalë: të zotët e së djathtës) | 39 | Metonimi ose personifikim për banorët e parajsës. |
| El-takua | “të vetëdijshëm për Zotin” | 56 | Simbol i frikës nga ndëshkimi i Zotit (emri <i>el-takua</i> rrjedh nga rrënja t-k-j, që do të thotë të kesh frikë, apo të kesh kujdes nga...), që përshfaqet me bërjen e veprave të mira. |

Tabela 4: Klasifikimi retorik i figurave letrare të sures El-Muddeth-thir.

Duhet të kujtojmë gjithashtu, se klasifikimi retorik i secilës prej figurave letrare nuk përfaqëson kategorizimin përfundimtar apo të vetëm, pasi, siç e kemi theksuar, shumë figura letrare kuranore i sfidojnë kategorizimet që mbështeten në kriteret e përcaktuara nga studiuesit e retorikës arabe. Figura të tilla, përfshihen në tabelën 4.

El-iltifat: arti gjuhësor unik i Kuranit

Retoricienët kanë diskutuar shpesh një dukuri gjuhësore, të cilën e klasifikojnë në kategorinë e semantikës dhe që njihet si *iltifat*, ose kalim i menjëhershëm, i papritur. Në një kontekst letrar, *iltifati* i referohet ndërrimit të papritur që autori ose folësi i bën vetës së ligjërimit. Për shembull, ndodh një ndërrim i papritur nga veta e tretë e numrit njëjës ose shumës (ai, ajo, ata, ato), në vetën e dytë (ti, ju), ose nga veta e dytë (ti, ju), në vetën

e parë (unë, ne), ose nga numri njëjës, në numrin shumës. Disa retoricienë gjithashtu mund të përfshijnë zhvendosje nga koha e shkuar, në të tashmen, ose në mënyrën urdhërore, ose shndërrimin nga folje në emër etj. Në vargun e mëposhtëm, për shembull, kemi një zhvendosje nga numri njëjës, në numrin shumës: *bala men asleme uexhhehu lil-lahi ue huue muhsinun fe lehu exhruhu'inda rabbihi ue la khaufun'alejhim ue le hum jahzenun*. - “Po, vërtet, secili që ia dorëzon tërë qenien **e tij** Zotit, e për më tepër, **bën** të mira, do të ketë shpërblimin **e vet** te Mbështetësi **i tij**. Dhe **ata** nuk do të **kenë** frikë dhe as **do të vuajnë**” (*Sure El-Bekare, 2:112*). Ajeti nis me vetën e tretë, numri njëjës dhe mbyllet me vetën e tretë, numri shumës, edhe pse personat të cilëve u drejtohet vargu, janë të njëjtët.

Kur citojnë shembuj të kësaj dukurie, fatkeqësisht, retoricienët nuk kanë bërë dallim mes vargjeve kuranore dhe atyre të poezisë para-islame. Megjithatë, ata kanë cituar më shumë vargje kuranore për *iltifatin*, sesa vargje poezish para-islame, që në vetvete është pranim i tërthortë i prioritetit të Kuranit në këtë drejtim. Por, nga pikëpamja akademike, vargjet e poezive para-islame të përzgjedhura për këtë çështje nuk kanë atë vlerë, sa të vihen baras, përkrah vargjeve kuranore. Në librin “*Miftah el’ulum*”, autori El-Sakaki citon këto dy vargje nga poeti Alkamah el-Fahl (vd. 603 e.s.)²³, te kapitulli mbi *iltifatin*:

| | |
|--|--|
| Taha bike kalbun fil hisani tarubu (طحا بك قلب في الحسان طروب) | Bu'ajdal shababi 'asra hana mashibu (بَعِيدَ الشَّبَابِ عَصْرَ حَانَ مَشِيْبٍ) |
| Zemra jote e gëzuar e ka humbur ndjeshmërinë ndaj gruas së bukur | Edhe pse rinia ka ikur për t'i lënë vendin plakjes |
| Tukel-lifuni Lejla ue kad shatta uelijjuha (تُكَلِّفُنِي أَلِيْلَى وَكَدَّ شَطْرَ وَلِيْهِيَا) | Ue 'adat 'auadin bejnena ue khutubu (وَعَادَتِ عَوَادِ بَيْنَنَا وَخُطُوبِ) |
| Ajo (zemra ime) më mundon të jem pranë Lejlës, tani që ajo është nisur | Dhe merakun, pengesat e pikëllimi na ndajnë |

23 El-Sakaki, *Miftah el-Ulum* (Beirut: Dar el-Kutub el-Ilmija, 2000), f. 298.

Pyetja ime është: a mund të gjejmë ndonjë lloj *iltifati* në këto rreshta, ose qoftë edhe diçka që i ngjan atij së largu? Pjesa më e madhe e retoricienëve këmbëngulin që po, mund të gjejmë. Gjithsesi, këto rreshta nuk përmbajnë gjë tjetër, veçse një bisedë të zakonshme me veten. Siç është e zakonshme për poetët, por edhe për shumë të tjerë, 'Alkamahu i flet vetes në vetën e dytë dhe vazhdon të bisedojë me veten, sikur të ishte dikush tjetër, ulur përballë. Pastaj i rikthehet vetes dhe nis të flasë në vetën e parë. Sa herë i flasim vetes në këtë mënyrë? Unë mund të them, "Çfarë po të ndodh, Bassam? Nuk ndjehem mirë me çka ti po i bën vetes. Kështu pra, po i rikthehem edhe njëherë vendimit tim. Po, kjo do ishte më e mira për ty, Bassam!"

Në rrjedhën e monologut, shkova disa herë para-mbrapa, mes të folurit vetes në vetën e dytë dhe asaj në vetën e parë. Por, a mund t'i referohem këtij procesi si *iltifat* dhe a do kisha të drejtë ta vendosja këtë përkrah artit kuranor të *iltifatit*?

Iltifati në Kuranin e Shenjtë është tërësisht një art i ri, i panjohur për letërsinë para-islame arabe, por edhe për atë të mëvonshmen, deri në ditët tona. Ajo mbetet një dukuri e panjohur për shkrimtarët njerëzorë. Personalisht, nuk di të ketë diçka të ngjashme në asnjë gjuhë tjetër. As nuk është *iltifati* diçka që ndodh rastësisht aty-këtu. Përkundrazi, ai përbën një dukuri retorike të vazhdueshme, që gjen aplikim vetëm në Kuran. *Iltifatit* i referohem si dukuri, për të theksuar shpeshësinë me të cilën forma të ndryshme të këtij arti shfaqen përgjatë tekstit kuranor. Vëmë re gjithashtu, edhe një tipar të jashtëzakonshëm në ndërrimin e përemrave, ku vëmendja e lexuesit kërkon energji të vazhdueshme që i duhet trurit për të menduar, duke lëvizur nga 'unë, ne, ti, ai, ata' me shpejtësi, gjë që e bën mendjen të angazhohet dhe të fokusohet me intelekt. Siç do ta shohim shkurtimisht, përemri që i referohet Zotit, zhvendoset jo më pak se gjashtë herë mes "ai" (huue), "unë" (ene) dhe "ne" (nahnu) në tri ajetet e para të sures El Isra' (17:1-3).

Subhanel-ledhi esra bi'abdihi lejlen min el-mesxhidi el harami ile el-mesxhidi el aksa el-ledhi barekna haulehu li nurijehu min ajatina innehu huue el-sami'u el-basir, ue atejne musa el-kitabe ue xhealnahu hudan li beni isra'ile el-la tettekhidhu min duni uekilan. Dhurri-jete man hamelna ma'a Nuh, innehu kana 'abdan shakuran.

"I pakufi në lavdinë e Tij është Ai që e transportoi shërbyesin e Tij natën, prej Xhamisë së Shenjtë (në Mekë), në Xhaminë Aksa (Jerusalem) - rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi. Edhe Musait Ne i dhamë librin, të cilin e bëmë udhërrëfyes për Bijtë e Izraelit, që të mos marrin Kujdestar tjetër, përveç Meje. Pasardhës të atyre që i bartëm (i shpëtuam) së bashku me Nuhun (bëhuni mirënjohës!). Vërtet, ai ishte rob shumë falënderues!" (Sure El Isra', 17:1-3)

Iltifati në marrëdhënie me kohën

Ekzistojnë disa lloje të *iltifatit* kuranor, njëra prej tyre merret me mbivendosjen kohore, ku e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja shkrihen në një. Këtu kemi të bëjmë me përmasat hyjnore të kohës dhe hapësirës, që nuk mund të përkufizohen nga njerëzit. Shpesh, shprehjet kuranore enden mes këtyre tri sferave kohore njerëzore, pa pyetur për normat dhe kufijtë tanë tokësorë. Ato e çlirojnë veten prej shtrëngesave tokësore dhe sfidojnë limitet që ne u përcaktojmë atyre, me anë të mendjeve tona të fundme. Vargjet e mëposhtme kuranore do të na japin një ide për mënyrën se si turbullohen e ngatërrohen këta kufij kohorë:

*Ue leu tara idh **vukifu'**ala el-nar fe **kalu** ja lejtene nuraddu ue le nukadhdhiba bi ajati rabbina. - "Sikur t'i shihje (ata), kur **iu tregua** zjarri, **duke thënë**: 'Oh, sikur të ktheheshim (në jetë): atëherë nuk do të mohonim mesazhet e Mbështetësit tonë...'" (Sure El-An'am, 6:27).*

Edhe pse vargu flet për Ditën e Gjykimit, në të ardhmen, aty përdoret koha e shkuar për t'i përshkruar ato ngjarje.

Ue kedhelike nuri ibrahima melekute el-semauati uel erdi... - "Dhe kështu, Ne i japim Ibrahimit mundësinë të shohë madhësitë e qiejve dhe të tokës..."

Pasazhi përshkruan një veprim të Zotit, të kryer në të shkuarën, me përdorimin e së tashmes.

Ue jasna'ul fulka ue kul'leme marra'alejhi mele'un min kaumihi sek-hiru minhu. - "Dhe kështu, (Nuhu) nis të ndërtojë arkën; dhe sa herë që paria e popullit të tij kalonin andej, talleshin me të" (Sure Hud, 11:38)

Veprimi i Nuhut, i kryer në të shkuarën, na silllet në kohën e tashme, kurse veprimet e të tjerëve përshkruhen duke përdorur kohën e shkuar.

Iltilfati në rasën kallëzore

Gjithsesi, *iltifati* më i shquar dhe që meriton më shumë vëmendjen tonë, nga të gjitha llojet e tij, është ai që unë e quaj "*iltifati gramatikor*". Ky lloj shfaqet veçanërisht në rastet kur rasa kallëzore përdoret në mënyrë ose vend të papritur. Situata të tilla kanë zënë ngushtë një numër të madh gjuhëtarësh, të cilët, siç kanë bërë edhe për dukuritë e tjera kuranore që nuk u binden rregullave të papërshtatshme njerëzore, kanë sajuar justifikime gramatikore, edhe nëse u është dashur, herë pas here, t'i largohen kuptimit origjinal të vargut në diskutim. Kështu, derisa gjuhëtarët të arrijnë të krijojnë një formulim gramatikor fiks për këtë lloj kallëzoreje, nëse do ta bëjnë ndonjëherë, unë propozoj që, në vend se të humbim nëpër labirintet gramatikore, ta klasifikojmë këtë dukuri

thjesht si “kallëzorja kuranore”, ose “kallëzorja me bazë *iltifatin*”. Sa për pohimet e orientalistëve, apo të skeptikëve të tjerë, se këto përdorime kuranore të papritura dhe jo të sakta të kallëzores janë ‘gabime’, ato bien poshtë, po të marrim parasysh se:

1. Kurani është shfaqur para se të formuloheshin rregullat gramatikore të arabishtes. Në fakt, Kurani ishte motivi që nxiti gjuhëtarët dhe retoricienët të shkruajnë rregullat gramatikore që njohim sot. Po të mos ishte ai, këta studiues nuk do të ishin në gjendje të formulonin rregulla të tilla, gjatë asaj faze të hershme të gjuhës arabe. Shkurt, është Kurani që ndikon rregullat gramatikore të arabishtes dhe jo e kundërta.
2. Nëse Profeti Muhamed (a.s.), të cilit miqtë tanë skeptikë orientalistë i atribuojnë autorësinë e Kuranit, paska gabuar në Libër, atëherë ngrihet pyetja: pse ai nuk gabonte kurrë në bisedat e përditshme, si janë regjistruar ato nga hadithet që kanë ardhur deri në ditët tona?! A nuk do kishte pasur ai kujdes t’i rregullonte ato gabime, po të kemi parasysh se thëniet e tij janë më të shumta sesa vargjet e Kuranit, sidomos po të kemi parasysh se hadithet profetike që njohim, janë produkt i një gjuhe spontane të përditshme, që ai përdorte me njerëzit rreth tij?! A ka kuptim të thuash se, kur fliste në mënyrë të zakonshme, gjuha e tij ishte pa gabime, ndërsa kur izolohej larg prej syve të botës, ai bënte gabime në atë tekst që më vonë do t’ia atribuonte Zotit?!
3. Nëse vërtet do të kishte gabime në Kuran, pse shokët e Profetit (a.s.), që ishin njohës të mirë të poezisë dhe të imtësisë së të folmes së rrjedhshme, nuk mund t’i korrigjonin ato, për t’u siguruar se Kurani do të na vinte pa gabime?! Dhe më e rëndësishmja, a nuk do ishin distancuar ata prej një feje, profeti i së cilës nuk arrinte të mësonte rregullat më të thjeshta të shkrimit dhe hartimit?!

4. Për hir të argumentit, po supozojmë se vërtet ka gabime gjuhësore në Kuran. Atëherë duhet të mbajmë parasysh, se shumë shembuj të *iltifatit* gramatikor në Kuran kanë të bëjnë me vendosjen e fjalës në rasën kallëzore (si për shembull: vendosja e kryefjalës në rasën kallëzore, si tek *el-shemsa mushrikah*) - me një zanore *fet'ha* (e/a) - kur normalisht duhet të ishte me një zanore *damma*(u). Gabime të tilla janë kaq elementare, saqë edhe një fillestar i arabishtes nuk do t'i bënte ato. Po japim këtu shembuj të përdorimit të kësaj rase kallëzore:
- *Khalidine fiha abeden ua'da Allahi hakk* - “të banojnë aty përgjithmonë. Premtimi i Zotit është e vërteta” (Sure Nisa, 4:122, përkthimi i Abdullah Jusuf Aliut). Fjala "premtim" (ua'd) në arabisht është në rasën kallëzore, edhe pse ky emër është kryefjala e fjalisë “premtimi i Zotit është e vërteta”.
 - *Fe innehu rixhsun au fiskan uhil-le li gajri Allahi bihi* - “sepse, kujdes, ato janë ndyrësi - ose kurbanin mëkatar që bëhet për tjetër (idhull) veç Zotit” (Sure El-En'am, 6: 145). Fjala *fisk*, e përkthyer “kurban mëkatar”, është vënë në rasën kallëzore, edhe pse emri *rixhs* - “ndyrësi”, është në rasën emërore dhe të dyja fjalët janë pjesë e të njëjtit emër frazor.
 - *Uelekad xha'at rusuluna ibrahime bil-bushra kalu selaman kala selamun* - “Erdhën të dërguarit tanë tek Ibrahimimi me sihariq dhe thanë: “Selam - Paqe!” Ai iu përgjigj: “Paqe!”²⁴ (Sure Hud, 11:69). Pjesa e parë e fjalës *Selam* është në rasën kallëzore, ndër- sa e dyta është në emërore, edhe pse, nga ana gramatikore, ndërtimi është i njëjtë.
 - *Dhalike 'isa ibnu merjeme kaule el-hakk* - “I tillë ishte, me fjalët e së vërtetës, Isai, i biri i Merjemes”

24 Nga përkthimi në anglisht i Abdullah Jusuf Aliut.

(Asadi), ose: “Kështu (ishte) Isai, i biri i Merjemes, (ky është) një pohim i së vërtetës” (Aliu) (Sure Merjem, 19:34). Fjala *kaul* do duhej të ishte në rasën emërore, por këtu e gjejmë në kallëzore.

- *Inne hadhihi ummetukum ummeten uahideten*: “Vërtet (o ju që besuat), kjo bashkësia juaj është një bashkësi e vetme” (Sure El-Enbija, 21:92). Si treguesi kryesor i një fjalie emërore, fraza “një bashkësi e vetme” do duhej të ishte në rasën emërore, por është në kallëzore.
- *Ue ma xheala ‘alejkum fid-dini min haraxhin mil-le-teebikum ibrahim*: “(Ai) nuk iu detyroi me vështirësi në fe (dhe ju bëri të ndiqni) besimin e stërgjyshit tuaj, Ibrahimit” (nga Asadi), ose: “... është kulti i babait tuaj, Ibrahimit” (nga Aliu) (Sure El-Haxh, 22:78). Fjala *mil-leh* (kult ose besim) do duhej të ishte në rasën emërore, por është në kallëzore. Vini re, si Asadi fut një frazë që do të ‘shpjegonte’ pse është këtu në rasën kallëzore.
- *Selamun kaulen min rabbin rahim*: “Paqe!’- një fjalë (përshëndetjeje) nga Zoti, më Mëshirëbërësi” (nga Aliu) (Sure Ja Sin, 36:58). Fjala *kaul* do duhej të ishte në rasën emërore, por është në kallëzore (në versionin origjinal). E njëjta gjë vlen edhe për fjalët e nënvizuara në pasazhet e mëposhtme.
- *Kel-la inneha ledha nezza’aten lil sheuva* - “Vërtet, ajo është një fjalë e tërbuar, që rryep lëkurët” (Sure El-Ma’arixh, 70:15-16)
- *Ue mizaxhuhu min tesnim ‘ajnen jeshrebu bihe el-mukarrabun* - “Dhe ai (musht) do të përzihet me ujin e Tesnimit, burim nga i cili do të pinë më të afërmit” (Sure El-Mutaffifin, 83: 27-28).

- *Se jasla naran dhate lehebin uemreatuhu hammalate el hatab* - "atij do i duhet të durojë një zjarr që bubulon, së bashku me të shoqen, mbajtësen e tregimeve të poshtra" (Sure El-Mesed, 111:3-4).

Së fundi, prania e të paktën 15 shembujve të *iltifatit* të llojeve të ndryshme në suret e vogla e të hershme, si ajo *Muddeth-thir*, është provë e qartë e peshës dhe e rëndësisë së *iltifatit* mes dukurive gjuhësore të reja e të larmishme që gjenden në Kuran. Po ashtu, ajo na lë të mendojmë mbi përmasat e shokut gjuhësor dhe retorik që kanë përjetuar arabët e hershëm, ndërsa dëgjonin për herë të parë fjalët e Shpalljes.

GJUHA E HAPUR

Kurani i habiti arabët e kohës së Profetit (a.s.) me një lloj të ri gjuhe që përmbante shumë aspekte të veçanta, në harmoni me njëra-tjetrën. Kjo gjuhë hyjnore elastike kishte aftësinë të gjallonte përgjatë shekujve, në një mënyrë të tillë, që njerëzit të zbulonin brenda saj kuptime që të parët nuk i kishin vënë re, pasi realitetet e epokës apo brezit të tyre dhe njohuritë e kufizuara nuk e krijonin atë mundësi. Për pasojë, çdo brez dhe mundësisht, secili vend dhe kulturë, e kuptojnë këtë gjuhë, duke mbajtur mënyrën e tyre të mendimit, zbulimet që kanë bërë dhe dijet që kanë në dispozicion. Më duhet ta pranoj, se m'u desh një kohë e gjatë për të çmuar urtësinë e fshehur pas refuzimit të Omar ibn Hattabit, që njerëzit të lejohen të interpretojnë Kurandin, apo të pyesin për kuptimin e tij. Ai ishte kaq i vendosur për këtë, sa që në atë kohë pati edhe ndëshkime fizike e burgosje për ata që e thyenin atë. Ebu el-Adabbas tregon si më poshtë vijon: "Ishim në praninë e Omar ibn Hattabit (r.a.), kur një burrë

iu afrua dhe i tha 'O prijës i Besimtarëve, cilës gjë i referohet shprehja "el-xheuari el-kunnes" (Sure Takuir, 81:16)?' Omari në përgjigje goditi turbanin e tij që fluturoi matanë. Pastaj i tha: <Mos je gjë arixhi (cigan endacak)? Për Atë që ka në dorën jetën e Omar ibn Hattabit, nëse nuk do të kishe pasur mbulesë mbi krye, do të ta kisha prerë!'”²⁵

Nga pikëpamja jonë, një interpretim i Kuranit nga ajo periudhë historike - periudha kur jetoi Profeti (a.s.) dhe shokët e tij - do të ishte thesar i mbushur me çelësa të artë për botën e mistereve gjuhësore që fshihen në Kuran. Gjithsesi, nga këndvështrimi i një njeriu vizionar si Omar ibn Hattabi, kjo do të thoshte të mbyllje mendjet e njerëzve të mëvonshëm, pasi nuk do t'u duhej edhe aq të përipiqeshin për të zbuluar vetë misteret dhe mrekullitë e Kuranit. Fundja, siç ka thënë edhe vetë Profeti Muhamed (a.s.), Kurani është një libër, mrekullitë e së cilit nuk mbarojnë kurrë (*la tankadi axha'ibuhu*). Kush, pra, do të guxonte, qoftë edhe në shekullin e dytë pas hixhrit, të sugjeronte një interpretim të ri të këtij apo atij ajeti, nëse do ekzistonte një interpretim që në shekullin e parë, në periudhën e shokëve të shkëlqyer të Profetit (a.s.), siç ishte Omeri (r.a.)? Dhe sa do të hezitonte ky njeri, po ta dinte se Omari (r.a.) kishte dëgjuar për një interpretim të tillë, por kishte heshtur?!

Zbulimet e pafundme që bëhen në kohën tonë mbi njohuritë kuranore, për çështje që i përkasin njohurive shkencore, kanë të bëjnë me fakte që nuk i njihin më parë njerëzimi, e që për këtë arsye, për shekuj me radhë, kishin mbetur të fshehura nën flatrat e gjuhës me shumë nuanca për të cilën po flasim. Për pasojë, zbulime të tilla janë thjesht fryt i këtij tipari të veçantë gjuhësor të Librit të Zotit. Ato janë gjithashtu, fryt i ruajtjes së Kuranit nga Shokët fisnikë, që nuk lejuan interpretime të tij asokohe për

25 Treguar nga Hakimi. Për tregime të ngjashme mbi Omerin, shih Xhelaledin Sujuti: *Xhami' el-Ahadith li el-Masanid uel Marasil*, përpiluar dhe rregulluar nga Ahmed Abdul-Xhevat dhe Abaz Ahmed Sakri (Damask: Matba'at Muhammed Hashim el Kutubi, 1981), pjesa për *masanidin* (shumësi i fjalës musned, tradita e transmetimit zinxhir deri tek i burimi i parë autorial), vëll. 2, f. 143-145.

brezat e ardhshëm. Fjalë e shprehje me kuptim të qartë qofshin, apo me shumë nuanca, gjenden në shumë prej vargjeve që njihen si *muteshabih* (alegorike - shih suren Al Imran, 3:7). Gjithsesi, ato nuk gjenden në vargjet që njihen si *muhkam* (bazike ose themelore, me kuptim të vendosur qartë, të qarta brenda e jashtë), që ka të bëjë me mësimet themelore të Kuranit mbi njëshmërinë e Zotit. Komentuesit mund të kenë mendime të ndryshme, sa i përket termit “shumëfaqësh” - *es-samed*, që përkthehet si “i Përjetshmi, Shkaku i Pashkak i gjithçkaje që ekziston” (Asad) dhe “i Përjetshmi, Absoluti” (Abdullah Jusuf Ali) në suren Ihlas (112), meqë kuptimet e tij të mundshme, sado të larmishme të jenë, nuk i largohen esencës së monoteizmit. Në të kundërt, nuk ka vend për dallime mendimesh ose interpretimesh, sa i përket shprehjes pararendëse dhe asaj pasuese të fjalës *samed*, si fjala *ehad* (Zoti Një, Një dhe i Vetmi), *lem jelid* (As nuk lind), *ue lem juled* (as është i lindur), pasi këto janë zemra e monoteizmit dhe nuk ka vend këtu për debate apo interpretime të ndryshme, pavarësisht ndryshimeve në kohë, hapësirë dhe kulturë.

Fraza “*Allahu Ekber*” përbën një shembull të prekshëm të asaj që ne e quajmë “gjuhë e hapur”. Kjo shprehje zakonisht është përkthyer ose “Zoti është i madh”, ose “Zoti është më i madhi”. Por asnjë prej këtyre nuk është përkthimi i saktë, pasi fjala *ekber* ka kuptimin “më i madh”. Pra, përkthimi i saktë për *Allahu Ekber* do të ishte “Zoti është më i madh”. Pavarësisht faktit se kjo thyen rregullat gjuhësore, që pas shkallës krahasore të mbiemrit kërkojnë lidhëzën “se” (*min.*), Islami e ka lënë të hapur këtë shprehje, në mënyrë që t’i lejojë shqiptuesit e saj të imagjinojnë atë përfundim që i përshtatet më mirë rrethanave të tyre. “Zoti është më i madh...” se gjithçka: se çdo dhimbje, se çdo gëzim, se çdo shqetësim, se çdo epush, pasion ose dëshirë, se çdo shtypës etj. Nëse shprehja do të ishte *Allahu El-Ekber* (Zoti është më i madhi) ose *Allahu El-Kebir* (Zoti është Ai i madhi), do të ishte e vetëmjaftueshme dhe jo e hapur, çka nuk do të linte hapësira veprimi për imagjinatën apo mendimet tona. Familjarizimi me të, na bën ta humbim aftësinë për të kapur aspektet më

të bukura të risisë së kësaj shprehjeje, të veçantisë dhe hapjes së saj. Ne e përsërisim atë, si të mos kishte kuptim tjetër, përveç "Zoti është i madh", dhe kjo i ka hapur rrugë përkthimit të gabuar të saj në gjuhët e tjera.

Njësia matëse më e mirë e pasurisë dhe e shumësisë përmatore të një fjale apo shprehjeje është numri i funksioneve sintaksore që mund të marrë. Sa më shumë mënyra të ketë për ta ndryshuar funksionin sintaksor (*i'rab*) të një fjale apo shprehjeje, aq më ndriçuese bëhet ajo, aq më tepër kuptime komunikon dhe aq më e nuancuar, sugjестive dhe e larmishme bëhet ajo. Kurani i tejkaloi edhe prozën, edhe poezinë e kohës, duke i habitur arabët e shekullit të shtatë me një gjuhë që mund t'i përballonte ndryshimet e kohëve, ngjarjet dhe zbulimet e reja, personalitetet e reja dhe evoluimin e mendimit, kulturës dhe dijes njerëzore. Si rezultat, njerëzit marrin nga Kurani atë që të kuptuarit dhe kultura e tyre ua lejojnë, atë që i përshtatet epokës së tyre të veçantë, vendit, ambientit, mentalitetit dhe nevojave të tyre të veçanta. Gjithsesi, përmbajtja e vetë Kuranit, sado të palidhura dhe të ndryshme të jenë kushtet të cilave u përgjigjet ky Libër, mbetet i vetëmjaftueshëm. Bollëku i fjalëve dhe shprehjeve në Kuran u ka dhënë arabëve mundësinë për të pasuruar letërsinë dhe poezinë e tyre, përtej të zakonshmes.

Është e thjeshtë ta gjesh këtë lloj gjuhe të hapur në tekstet e shkrimeve të shpallura të mëparshme, p.sh. në Testamentin e Vjetër (*Teurati*) dhe në Testamentin e Ri (*Inxhili*). Gjithsesi, nuk jemi në gjendje të kemi një gjykim të saktë e të drejtë për këto tekste, pasi pjesa më e madhe e atyre që zotërojmë sot, rrëfehen prej njerëzve, ose në rastin më të mirë, prej profetëve, dhe shumë rrallë hasim në tekste ku Zoti flet direkt (pra në vargje të rastësishme aty-këtu në Testamentin e Vjetër). Kështu, në pjesën më të madhe këto tekste nuk janë *ipsissima verba*: vetë gjuha e Qiellit, por, në rastin më të mirë, janë interpretime të fjalës së Zotit. Po ashtu, nuk zotërojmë tekste në origjinal. Ndaj, sado të kujdesshme e të sakta të jenë përkthimet, ato nuk janë gjë tjetër,

veçse interpretime personale që shprehin, në mënyrë të kufizuar, këndvështrimin e përkthyesit mbi tekstin që ai përkthen. Kësaj shtoi edhe faktin se përkthimet janë shpesh të paqarta, të ngatërruara, sidomos nëse përkthyesi është aq rigoroz, objektiv e i ndershëm, saqë nuk mundet me vetëdije të pastër, që pjesët e mugëta e të paqarta t'i përkthejë me gjuhë të qartë. Për pasojë, ai ose ajo përdor stil të turbullt (jo të qartë), që e mbush tekstin me pjesë të turbullta e të paqarta, që të lë përshtypjen e gjuhës së hapur, kur, në fakt, është thjesht e paqartë. Dhe në fund, janë vështirësitë që lidhen me ndryshimet gramatikore, shprehëse dhe kulturore, pra, prej përpjekjes për t'i transferuar ato në një gjuhë tjetër që ka rregullat, shoqërimet kulturore dhe kushtet e veta.

Ne do të ishim të justifikuar, nëse do të ngurronim, për shembull, të klasifikonim një frazë të mugët të Testamentit të Vjetër, si: “ke vendosur lëvdimin, për shkak të armiqve të tu” (Psalmet 8:2). Përkthimi i saj në arabisht është “*esseste hamdan bi sebebi addadike*” (أسست حمدًا بسبب أصدادك)²⁶ dhe lexohet si shembull i gjuhës së hapur, veçanërisht po të marrim parasysh se përkthimi i saj në anglisht është më i saktë sesa në arabisht. Përkthimi im i kësaj fraze, që si çdo përkthim tjetër ka të metat e veta, është “*lakad eksebeke a'da'uke ku-ueten*” (Armiqtë e Tu kanë shtuar fuqinë Tënde), ndërsa në një tjetër përkthim arabisht lexojmë “*te'azzazte fi uexhhi khusumike*” (تعززت في وجه خصومك)²⁷, (Ti je fuqizuar përballë armiqve të Tu), që është më pak e paqartë sesa përkthimi arabisht i cituar më parë, por jo dhe aq i qartë sa përkthimi anglisht. Nuk e hasim këtë problem në Kuran, ku Zoti flet në vetën e parë, nga fillimi në fund. Për më tepër, Kurani ekziston në gjuhën origjinale, për pasojë, nuk kemi nevojë të këshillohemi me një ose më shumë gjuhë e mesme për të gjetur kuptimin, siç bëjmë kur kemi punë me Zbulesat e tjera.

26 Përkthimi arabisht është marrë nga botimi i Dar el-Kitab el-Mukades fil 'Alam al-'Arabi, 1981.

27 Dar el-Kitab el-Mukades fil 'Alam al-'Arabi, 2004.

SHEMBUJ TË “GJUHËS SË HAPUR” NË SUREN EL-MUDDETHTHIR

Deri më tani jemi mbështetur te surja El-Muddeththir (74), për të analizuar dukuritë e shumëllojshme të reja gjuhësore që gjenden në Kuran. Kjo sure na ofron shembuj të shumtë të gjuhës “së hapur”, që kanë shkaktuar debate mes komentuesve, gjuhëtarëve dhe gramatikanëve, dhe që janë subjekt i interpretimeve dhe analizave gramatikore të shumëfishta. Për më tepër, nëse marrim parasysh edhe leximet e shumta e të ndryshme të Kuranit, të njohura si të vlefshme gjatë shekujve, atëherë mund të japim më e pakta 29 shembuj fjalësh apo shprehjesh “të hapura”. Në tabelën 5 kemi radhitur disa syresh, duke sugjeruar vetëm nga një kuptim për secilën.

| Fjalët dhe shprehjet “e hapura” | Përkthimi shqip (nga versioni anglisht i Muhamed Asadit) | Ajeti |
|--|---|-------|
| Kum fe endhir | “Çohu dhe paralajmëro!” | 2 |
| Ue rabbeke fe kebbir | “dhe lavdëro madhësitë e Mbështetësit tënd” | 3 |
| Uel ruxhza fehxhur | “dhe shmangu ndyrësisë” | 5 |
| Ue la tammun testekthir | “dhe mos u mburr me atë që jep e të duket shumë!” | 6 |
| Ue benine shuhuda | “dhe fëmijë si dëshmitarë (të dashurisë)” | 13 |
| Ue mehhedtu lehu temhida | “atij që ia bëra jetën të lehtë e të rehatshme” | 14 |
| Kel-la | “me të vërtetë” | 16 |
| Leuuahatun lil-besher | “duke e bërë të dukshme (të vërtetën) për vdekatarin” | 29 |
| Li men sha’a minkum en jetekaddama au jete’akhhkar | “për secilin nga ju që zgjedh të bëjë para, apo të bëjë mbrapa” | 37 |
| Il-le as-hab el-jemin | “përveç zotëruesve të mirësisë” | 39 |
| Nakhudu ma’a el-khaid’in | “dhe jemi përzier me të tjerët në punë të kota” | 45 |
| En ju’ta suhufan muneshsherah | “t’i jepej një Shpallje e posaçme” | 52 |
| Huue ehlu tekua | “Burimi i frikës nga Zoti” | 56 |

Tabela 5: Pasqyrim i disa fjalëve e shprehjeve “të hapura” që gjenden në suren El-Muddeththir.

Nëse ndalemi dhe reflektojmë pak mbi secilën prej këtyre fjalëve dhe frazave, mund të dallojmë edhe vetë përmasat dhe nuancat e shumta që ato mbartin. Le të marrim, për shembull, frazën e parë, *kum fe endhir*, të përkthyer nga Asadi: "Çohu dhe paralajmëro!". Urdhri *kum* mund të ketë disa kuptime. Ai mund të jetë "Ngrihu", " Çohu", "Lëviz", "Futju punës" ose "Përgatitu". Sa për urdhrin *endhir*, me të mund të kuptohet "shpërnda mesazhin", "paralajmëro orën e pashmangshme të gjykimit", "paralajmëro ndëshkimin në këtë jetë tokësore", ose "paralajmëro për të qenit në përjetësi në zjarrin e ferrit". Ngjashëm, fraza e fundit *hue ehlul-takua*, përkthyer nga Asad si "Burimi i gjithë vetëdijes për Zotin", ka shumë kuptime të mundshme. Emri *ehlu* mund t'i referohet pronarit të diçkaje, dhënësit të saj, dikujt që është i vlefshëm për të, ose burimit të tij të besueshëm. Sa për emrin *el-takua*, gama e tij semantike përfshin kujdesin, maturinë, ose prirjen për t'iu frikësuar apo shmangur diçkaje, siç është shmangia ndaj ndëshkimit të Zotit në Ditën e Gjykimit, për shkak të virtutit të besimit tonë në Të. Ai mund t'i referohet gjithashtu, parandalimit ose mbrojtjes, siç është mbrojtja që Zoti u bën njerëzve nga ky ndëshkim, kur ata besojnë tek Ai, apo mbrojtja e Tij nga të këqijat e kësaj bote.

Pasuria e gjuhës së hapur në suren El-Muddeththir na ndihmon të krijojmë një ide mbi përhapjen e këtij tipi gjuhe, si në nivel fjalësh, ashtu edhe shprehjesh, në gjithë suret e tjera. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se hapja e kësaj gjuhe nuk do të thotë se ekziston një çarje e rrezikshme në Kuran, që do t'i lejonte ata me shpatë në dorë të shtrembërojnë mesazhin e tij. Të tillë janë përpjekur me shekuj ta bëjnë diçka të tillë dhe ende vazhdojnë. Përkundrazi, ky tipar dallues pasuron kuptimet që sjell Kurani, duke u dhënë atyre më shumë gjallëri e gjenialitet me kalimin e shekujve, me evoluimin e dijeve njerëzore dhe me ndryshimin e zhvillimin e ambienteve dhe kulturave njerëzore.

LEXIMET E NDRYSHME KURANORE TË GJUHËS “SË HAPUR”

Ekzistenca e varianteve të certifikuara të leximeve të Kuranit²⁸ është një prej ilustrimeve më të shquara të gjuhës së hapur. Ky është, në fakt, një tipar që nuk është krahasuar apo shoqëruar me libër tjetër në historinë e njerëzimit. Orientalistët dhe të tjerë të sojit të tyre, kanë hapur polemika rreth këtij aspekti të mrekullueshëm të gjuhës së Kuranit, duke shkruar studime të tëra mbi të dhe duke ofruar financime të bollshme për kërkime të tilla, me shpresën për të gjetur justifikime për skepticizmin e tyre dhe për të minuar besueshmërinë dhe autoritetin e Kuranit. Gjithsesi, asnjëherë të vetme nuk janë ndalur të reflektojnë ndershmërisht mbi qasjet e tyre shkencore, prej të cilave ne lindorët kemi mësuar kaq shumë. Nëse do ta bënin këtë, do t'u duhej të pranonin se shtatë variantet e leximit të Kuranit janë thjesht një aspekt më shumë i mrekullisë së gjuhës së jashtëzakonshme të këtij libri.

A keni dëgjuar ndonjëherë të ekzistojnë disa libra në një, apo për një tekst që mund të lexohet në më shumë se një mënyrë, apo të përcjellë më shumë se një kuptim, pa pasur ndërkohë asnjë kundërshti apo mospërputhje mes atyre kuptimeve? Kjo nuk është çështje mospajtimi mes muslimanëve, por e mënyrave të ndryshme të leximit të Kuranit, të zbritura nga lart, për të pasuruar gjuhën dhe mesazhin kuranor, për të lehtësuar leximin e tij dhe për të theksuar natyrën e hapur të gjuhës së tij, në mënyrë që të jetë në harmoni me ndryshimin e vendeve dhe kohëve. Ndaj të shtatë leximet e Kuranit përfaqësojnë edhe një tipar më shumë, që është unik vetëm për këtë libër. Nëse ka ndryshime mes gjuhëtarëve apo lexuesve, ato janë thjesht çështje përparësish, pasi që të shtata u shpallën në mënyrë hyjnore:

28 Shih: Ahmed Ali Imam, *Variant Readings of the Qur'an: A Critical Study of Their Historical and Linguistic Origins* (Maltë: IIIT, 2011)

“Omar ibn Hatabi (r.a.) thotë: “Një ditë, gjatë kohës së Profetit (a.s.), dëgjova Hisham ibn Hakimin (r.a.) të recitonte suren Furkan (25). Duke e dëgjuar, vura re një lloj shqiptimi që nuk e kisha dëgjuar kurrë të përdorej nga Profeti i Zotit. Për pak e ndërpreva në mes të faljes. Gjithsesi, u mendova dhe prita derisa mbaroi. Pastaj e zura nga jaka dhe i thashë: ‘- Kush ta mësoi ty këtë sure që sapo dëgjova?’ Ai u përgjigj: ‘- Profeti i Zotit, ai ma mësoi ta recitoj në këtë mënyrë’. ‘- Po gënjen’, i thashë. ‘- Të betohem që Profeti (a.s.) ma mësoi ta recitoj me një mënyrë tjetër!’ Pastaj e çova te Profeti i Zotit dhe i thashë: ‘- O Profet i Zotit, dëgjova këtë njeri të recitojë Suren Furkan, në një mënyrë të ndryshme nga ajo që më ke mësuar mua’. Profeti (a.s.) m’u përgjigj, ‘Lëre të shkojë, Omar!’ Pastaj iu drejtua Hishamit: ‘- Recito Hisham!’ Ai e recitoi suren njësoj si e kisha dëgjuar gjatë faljes. Atëherë, i Dërguari i Zotit (a.s.) tha: ‘Kështu është zbritur kjo’. Pastaj u kthye nga unë e më tha: ‘- Recito Omar!’ Kështu, edhe unë e recitova atë, siç ma kishte mësuar Profeti (a.s.) dhe ai tha: ‘- Kështu është shpallur kjo sure. Ky Kuran është shpallur me shtatë lloje shqiptimesh (fjalë për fjalë: shkronja), ndaj recitohen duke përdorur formën që keni më të lehtë!’”²⁹

Është e rëndësishme të theksojmë këtu, se mënyrat e ndryshme të recitimit të Kuranit - që kanë qëlluar të jenë shtatë, sepse numri i recituesve me të cilët zinxhiri i transmetuesve mbi të cilët bazojmë këto lexime, ishte shtatë - nuk duhen ngatërruar me “shtatë shkronjat” (*el-huruf el-sabah*) të përmendura në hadithin profetik më sipër, që u referohet dialekteve lokale dhe shqiptimeve të ndryshme të lidhura me arsimimin dhe grupmoshën. Kjo pikë sqarohet në hadithin më poshtë:

29 Treguar nga Buhariu dhe Muslimi, me pak ndryshime në fjalë. Për më shumë hadithe mbi këtë çështje shih librat për variantet e ndryshme të leximit të Kuranit, veçanërisht hyrjen e Ibn Xhazariut (vd. 833 H / 1429), *Takrib el-Nashr fil Kira'at el'Ashr*, red. Ibrahim Atuah Auad, (Kajro: Dar el-Hadith, 1966), f. 47-51.

I Dërguari i Zotit takoi njëherë Xhebrailin³⁰ dhe i tha: “- O Xhebrail! Je dërguar në një popull analfabet, disa prej të cilëve janë të brishtë e të moshuar, disa janë shumë të rinj, disa janë gra shërbyese e disa janë burra që nuk kanë lexuar asnjë libër në jetë”. “- O Muhamed”, u përgjigj Xhebraili, “- Kurani është shpallur me shtatë shqiptime (ose “në shtatë dialekte”, fjalë për fjalë: “me shtatë shkronja” - ‘*ala sab’ati ahruf*’ dhe me një tjetër formulim të ndryshëm), ndaj lëri ta recitoni me një prej këtyre të shtatave”.³¹

GJUHA E HAPUR DHE ZBULIMET SHKENCORE

Zbulimet e shumta shkencore që janë bërë kohët e sotme, mbi vëzhgimet e mrekullueshme kuranore në çështje që i përkasin dijes shkencore, kanë të bëjnë me fakte të panjohura më parë për njerëzimin e që, për këtë arsye, për shekuj kanë mbetur të fshehura nën krahët e kësaj gjuhe të hapur e shumëkuptimëshe, për të cilën po flasim. Zbulime të tilla janë thjesht fryt i këtij tipari të veçantë të Shpalljes hyjnore dhe për këtë, i jemi borxhlinj vizionit largpamës të Sahabëve fisnikë që e ruajtën Kuranin, duke mos lejuar që interpretime të tij të regjistroheshin për brezat e ardhshëm.

Gjithsesi, pasuesit e tyre (komentuesit e përkthyesit) u përpoqën të deshifrojnë apo shpjegojnë gjëra që ishin (për kohën - sh.p.) përtej të kuptuarit të tyre, duke e shtrembëruar në këtë proces, pa dashje, kuptimin e Kuranit prej njerëzve. Diskutimi i mëposhtëm fokusohet në një shembull të tillë, mes shumë të tjerëve:

وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدَةً وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ ۗ صُنْعَ اللَّهِ الَّذِي أَتَقَنَ كُلَّ شَيْءٍ ۗ إِنَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَفْعَلُونَ ۗ

30 Në një version tjetër të kësaj ngjarjeje thuhet se ai e takoi Xhebrailin “në shkëmbinj të Marasë”, që i referohet një mali në Kuba’.

31 Treguar nga Tirmidhiu, me autoritetin e Ubejd ibn Ka’bit.

"*Ue tera* (Dhe ti sheh) *el-xhibala* (malet) *tahsebuha* (i mendon ato) *xhamidaten* (të palëvizshëm) *ue hije* (ndërsa ata janë) *temurru* (duke lëvizur) *marra* (si lëvizja e) *al-sehab* (reve), *sun'a Allah* (një punë e Zotit) *el-ledhi atkana* (që ka përsosur) *kul-le shejin* (gjithçka). *Innehu* (Pa shih!) *khabirun* (Ai është i gjithëdijshtëm) *bime* (për atë) *tefalun* (që ju bëni)". (*Sure El-Neml, 27:88*)

Kur po meditoja në fillim për këtë varg, u mahnita nga qartësia me të cilën afirmohet se malet "rrotullohen" bashkë me rrotullimin e Tokës, tamam siç lëvizin retë në qiell. Duke menduar për këtë, vendosa të lexoj komentet e hershme të këtij vargu, për të parë se si e kishin kuptuar atë autorët, duke pasur parasysh njohuritë e kufizuara të kohës së tyre mbi Tokën dhe marrëdhënien e saj me universin. Atëbotë, askush nuk dinte gjë akoma për rrotullimin e Tokës, apo se ajo ishte e rrumbullakët. Për më tepër, gjeologët kanë zbuluar relativisht vonë, se toka përbëhet nga shtresa, dy prej të cilave përbëjnë koren (që është e hollë, krahasuar me shtresat e tjera) dhe mantelin (shtresë e dendur nën kore). Sipas teorisë së pllakave tektonike, korja e tokës lëviz mbi mantelin çdo vit disa centimetra, duke shkaktuar lëvizjen graduale të kontinenteve (shih teorinë e lëvizjes së kontinenteve të Alfred Vegnerit, që u propozua vetëm në 1912 dhe që u kritikua shumë nga shkencëtarët, deri në vitet '1950, pas vdekjes së tij, kur faktet, më në fund, mbështetën këtë zbulim).

Më poshtë, jepen në mënyrë të përmbledhur përpjekjet për ta interpretuar këtë varg nga disa prej komentuesve të hershëm më të shquar të Kuranit:

- **El-Khazin:** "Malet lëvizin si retë, derisa bien mbi Tokë dhe sheshohen... Ngjashëm, lëvizja e maleve në Ditën e Gjykimit nuk do të jetë e perceptueshme, për shkak të përmasave të tyre gjigante, ashtu siç nuk perceptohet lëvizja e reve për të njëjtën arsye".
- **El-Tabari** (bashkë me El-Nasafin, Ibn Xheuzijen, El-Zamahsharin dhe El-Kurtubiun): "Raportohet se Ibn Aba-

zi ka thënë që fjala *xhamidah* në këtë ajet do të thotë “e qëndrueshme, e fiksuar”, ose “qëndron drejt”. Sa për shprehjen “*ue hija temurru marra al-sehab*”, ajo do të thotë se malet do të grumbullohen bashkë (në Ditën e Gjykimit), pastaj do të lëvizin në një mënyrë që, kur dikush t’i shohë, të mendojë se ato janë të palëvizura, për shkak të numrit të tyre të madh, edhe pse ato po lëvizin para”.

- **El-Razi** (në pajtim me El-Bejdavin): “Arsyeja pse malet (në Ditën e Gjykimit) do të perceptohen si *xhamidah* (përkthyer nga Asad si solidë, të palëvizshëm), është se, kur trupa të mëdhenj lëvizin shpejt dhe në unitet, ata që i vështrojnë, mendojnë se këto nuk po lëvizin, edhe pse po u kalojnë para syve me shpejtësi të madhe”.
- **Ebu Hajan**: “Thuhet se arsyeja që personi që vështron malet, mendon se ato nuk lëvizin, edhe pse ato janë duke lëvizur, është (perceptimi i tij do të ndryshohet nga) momenti i frikshëm i asaj dite (Ditës së Gjykimit). Me fjalë të tjera, ai nuk do të jetë në terezi për të përcaktuar me siguri se ato, në fakt, nuk janë duke qëndruar në një vend”.
- **Ibn Kethir**: “Pra, ty ato do të duken sikur janë në një vend dhe të pandryshueshme, kur, në fakt, po të kalojnë para syve si re, pra, duke lëvizur nga vendi i tyre”.
- **El-Farra’** (së bashku me El-Ahflash el Ausat): këta komentues nuk bëjnë koment mbi këtë varg.

Akoma më shqetësues është fakti se edhe disa interpretues modernë të Kuranit këmbëngulin të mbeten te këto pika të arritura shekuj më parë nga studiuesit e hershëm, të kënaqur me interpretimet e arritura në kushtet e njohurive tepër të kufizuara. Për shembull, nëse përzgjedhim dhjetë komente moderne të

Kuranit (tetë të shkruara nga muslimanë dhe dy nga orientalistë jomuslimanë), do të shohim se të tetë komentet e muslimanëve (ose më mirë përkthimet e tyre nga arabishtja) mbeten me kokëfortësi tek interpretimet e mëhershme.

Si rezultat i kësaj, fraza “*ue hije temurru marra al-sehab*” (ndërkohë që ato lëvizin, si lëvizja e reve) nuk është lënë si është. Gjatë interpretimit, u konsiderua e nevojshme të transferohej në të ardhmen, një hap që e bën kuptimin aktual të saj tërësisht të padepërtueshëm për lexuesit e anglishtes (apo të gjuhëve të tjera). E megjithatë, secili përkthim mundohet ta paraqesë vargun si “do të kalojë-lëvizë” dhe jo: Ato po lëvizin apo udhëtojnë.

Po të vazhdojmë më tej me këtë shembull, madje edhe përkthyesit modernë të Kuranit kanë rënë në këtë mospërputhje të habitshme, duke e përkthyer foljen e shprehjes *tahsebuha* (mendon se ato janë) në kohën e ardhme dhe jo në të tashmen. Folja frazore *tahsebuha* i referohet një veprimi të tanishëm dhe jo të ardhshëm, ndaj nuk ka kuptim, nëse përkthehet në të ardhmen. Megjithatë, disa përkthyes bashkëkohorë vazhdojnë të bëjnë kështu. Disa përkthime (p.sh. Hilali dhe Han), duke u përpjekur ta zgjidhin këtë mospërputhje, e shtrembërojnë edhe më tej kuptimin e vargut, duke e vënë këtë folje dhe shprehjen ndajfoljore që e pason (*ue hija temurru marra el-sehab*), në të ardhmen: “Dhe ti do të shohësh malet dhe do të mendosh se janë të palëvizshëm-solidë, por ato do të ecin, si ecja e reve” (shtuar nënvijëzimi).

Fatmirësisht, orientalisti jomusliman Riçard Bell nuk ishte i ndikuar nga komentuesit e hershëm, kur u mor me përkthimin e Kuranit (mes viteve 1937-39). Ai iu qas tekstit, ndoshta jo me ndonjë ide moderne, por me përkushtim ndaj gramatikës arabe. Duke zbatuar rregullat e saj, ai e përktheu këtë varg në kohën e tashme, duke prodhuar një përkthim të saktë si vijon: “*Dhe i sheh malet në dukje të palëvizshëm, solidë e megjithatë që ecin si retë*”.

Riçard Bell u pasua nga përkthyesi musliman Muhamed Marmaduke Pkthal, përkthimi i parë i Kuranit, prej të cilit u botua së pari në 1930 (ndërsa këtu zgjodhëm versionin e rishikuar të tij, të botuar në 2002). Pkthal e përktheu vargun në këtë mënyrë: “Dhe ti i sheh kodrat dhe i mendon ato si të palëvizshme-solide, ndërsa ato fluturojnë si retë”.

Për ta përmbledhur, shembulli i mësipërm na shpërfaq një tablo të qartë të faktit se si një aspekt i jashtëzakonshëm dhe i mrekullueshëm i Kuranit vazhdoi të mbetet në hije, në vend që të shpërfaqej qartë, kur disa prej përkthyesve të tij në anglisht vendosën të imitojnë interpretimet shekullore, duke harruar faktin se në kohën kur ato u bënë, niveli i njohurive ekzistuese ishte shumë i kufizuar.

Së fundi, më duhet të rrëfej se, duke iu afruar fundit të udhëtimit tim të parë në studimin e risive të mrekullueshme të gjuhës kuranore, kjo ishte një “aventurë” njerëzore zbulimi, që, si çdo përpjekje njerëzore, mbetet e dobët dhe e papërshtatshme, pavarësisht përpjekjeve për të qenë sa më shkencore, akademike dhe objektive. Asnjë përpjekje njerëzore për t’u marrë me gjuhën hyjnore të Kuranit nuk mund të meritojë përshkrim tjetër, përveçse “aventurë”.

Sfida hyjnore që iu bë arabëve të kohës së Profetit (a.s.) për “të krijuar një sure të një cilësie të ngjashme...” (Asad), ose “... për të krijuar një sure si këto...” (Abdullah Jusuf Ali) (*Sure El-Bekare*, 2:32), mbetet në fuqi ende, sikur Kurani të ishte shpallur dje. Sado gjeni të ketë pasur kjo botë, askush nuk ka arritur t’ia pakësojë vlerën madhështisë së tij imponuese.

Burimet dhe bibliografia e përzgjedhur

Lista e mëposhtme nuk përfshin koleksionet e haditheve, fjalorët, enciklopeditë, veprat për gjuhën dhe gramatikën, apo komentet e Kuranit, të cilave nuk u jemi referuar në këtë studim. Nuk përfshin as enciklopeditë e shumta në versionet elektronike (CD) ku jemi mbështetur, përfshi enciklopeditë e Kuranit të Shenjtë, haditheve dhe poezisë arabe, veçanërisht edicionet e viteve 1998, 2000 dhe 2003 të enciklopedisë së rëndësishme të përpiluar nga Akademia Kulturore e Emirateve të Bashkuara Arabe.

BURIMET NË GJUHËN ARABE

Alalueri, Taha Xhabir. *Nahua Mauqif Qur'ani min al-Naskh* (Kairo: Maktabat al-Shuruk al-Daulijah, 2007).

Al-Ansari, Ahmed Makki. *Nazarijjat al-Nahu al-Qur'ane* (Xheddah: Dar al-Kiblah, 1405/1984).

Al-Asbahani, Ebu Bekr Ahmed ibn al-Husejn. *Al-Mabsut fi al-Kira'at al-'As-har*, red. Subai Hamzah Hakimi, (Jeddah: Dar al-Kibla and Beirut: Mu'assasat 'Ulum al-Qur'an, 1995).

- Al-Baqillana, al-Kadi Ebu Bekr Muhammed ibn al-Tajjib. *I'xhaz al-Kur'an*. Redaktimi dhe shënimet: Salah ibn Uuejda, (Beirut: Dar al-Kutub al-'Ilmijja, 2001).
- Al-Faraha, Abdulhamid. *Tefsir Nizam al-Kur'an ue Ta'uul al-Furkan bil-Furkan* (India: Al-Da'irah al-Hamidijjah, 2000).
- Ibn al-Xhazari, Muhammed ibn Muhammed. *Takrib al-Nashr fi al-Kira'at al-Ashr*, ed. Ibrahim Atuah Auad, (Cairo: Dar al-Hadith, 1996).
- Al-Xhurjani, 'Abd al-Kahir. *Dala'il al-I'xhaz*, me komente nga Mahmud Muhammed Shakir, (Kairo dhe Xheddah: Dar al-Madani, 1992).
- Al-Kitab al-Mukaddes* (Beirut: Dar al-Kitab al-Mukaddes fi al-Shark al-Ausat, 2004).
- Al-Kitab al-Mukaddes* (Dar al-Kitab al-Mukaddes fi al-'Alam al-'Arabi, 1981).
- Al-Kattann, Mana'. *Mabahith fi 'Ulum al-Kur'an* (Beirut: Mu'assasat al-Risalah, 1998).
- Al-Razi, al-Fakhr. *Al-Tafsir al-Kabir* (Beirut: Dar Ihja' al-Turath al-'Arabī, 2001).
- Al-Sakaki, Ebu Ja'kub Jusuf. *Miftah al-'Ulum*, ed. 'Abdulhamid Hindau, (Beirut: Dar al-Kutub al-'Ilmijah, 2000).
- Al-Shaukani, Muhammed ibn 'Ali. *Fath al-Kadir: al-Xhami' bajn Fannaj al-Riuajah ue al-Dirajah min 'Ilm al-Tafsir* (Kairo: Dar al-Fikr, pa datë).
- Al-Sujuti, Xhelaledin. *Al-Itkan fi 'Ulum al-Kur'an*, ed. Muhammed Selim Hashim, (Beirut: Dar al-Kutub al-'Ilmijjah, 2003).
- Xhami' al-Ahadith li al-Masanid ue al-Marasil*. Përpiluar dhe rregulluar nga Ahmed Abdulxhevat dhe Abaz Ahmed Sakriu, (Damask: Matba'at Muhammed Hashim al-Kutubi, 1981).
- Udajmah, Muhammed Abdulhalik. *Dirasat li Uslub al-Kur'an al-Kerim* (Kairo: Dar el-Hadith, 2004).
- Al-Zarkashi, Bedr al-Din Muhammed ibn Bahadir. *Al-Burhan fi 'Ulum al-Qur'an*, red. Muhammed Abu al-Fadl Ibrahim, (Kairo: Dar Ihja' al-Kutub al-'Arabijah, 1958).
- Al-Zayid, Samira. *Mukhtasar al-Xhami' fi al-Sirah al-Nabauijjah* (Damask: Al-Matba'ah al-'Ilmijjah, 1995).

BURIMET NË GJUHËN ANGLEZE

- Asad, Muhammad. *The Message of the Qur'an* (Bristol, England: The Book Foundation, 2003), vol. 5.
- The Bible*. King James Version (London: Collins' Clear-Type Press, 1950).
- Good News for Modern Man: The New Testament in Today's English Version* (American Bible Society, 1966).

Gjuha e mrekullueshme e Kuranit

The Holy Bible. Revised Standard Version (Division of Christian Education of the National Council of the Churches of Christ in the U.S.A. Great Britain, 1971).

The Holy Bible (London: Trinitarian Bible Society, 2000).

Islahi, Amin Ahsan. *Pondering over the Qur'an*, trans. M. S. Kayani. (London, 2003).

Lang, Jeffrey. *Even Angels Ask: A Journey to Islam in America* (Beltsville, MA: Amana Publications, 1997).

Luxenberg, Christoph. *The Syro-Aramaic Reading of the Koran: A Contribution to the Decoding of the Language of the Koran*. English Edition. (Germany, 2007).

Murry, Middleton. *The Problem of Style* (1922) (London: Oxford Paperbacks, 1960).

Ky studim shtjellon arsyet se përse gjuha e Kuranit është mahnitëse, e pashoqe dhe dëshmi e autoritetit të tij hyjnor. Autori krahason gjuhën e Kuranit me gjuhën e poezisë para islamike, thëniet (hadithet) e të Dërguarit (a.s.) dhe gjuhën e arabëve, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, për të treguar që, megjithëse Kurani u shpall në gjuhën arabe, ajo ishte një arabishte krejtësisht e re. Dëgjuesit e parë dhe më të hershëm muslimanë e shihnin këtë si mrekulli dhe iu përgjigjën fjalëve, tingujve dhe ritmit të Kuranit, me një qëndrim thellësisht vlerësues të bukurisë dhe madhështisë së tij, gjuhën e të cilit dëgjuesit modernë, edhe pse të familjarizuar tashmë me të, apo përkundër faktit se munden të përdorin një shumëllojshmëri fjalorësh dhe studimesh, nuk ia arrijnë ta kapin plotësisht.

Për të sjellë në jetë diçka nga kjo mrekulli, autori përpiqet ta heqë këtë pengesë dhe t'ua paraqesë Kuranin lexuesve, sikur ta dëgjonin për herë të parë. Kështu, ai i udhëheq lexuesit drejt vlerësimit të bukurisë së Kuranit, përfshirjes më thellë në të dhe drejt një kuptimi më të qartë të strukturës dhe rrjedhës së tij. Për të mbështetur analizën e tij, Saeh i kushton vëmendje të veçantë sures El Muddethir. Në këtë mënyrë, e rijetëzon Shpalljen, duke treguar që secila sure ka tipare dhe karakteristika të dallueshme, që e bëjnë atë të qëndrojë në mënyrë unike, në skemën dhe tërësinë e saj.



Bassam Saeh është diplomuar për Letërsi Arabe në Universitetin e Damaskut, Siri, dhe ka kryer studimet e Masterit dhe Doktoraturës për Poezinë Bashkëkohore Arabe, në Universitetin e Kajros. Ai ka qenë drejtues i Departamentit



ISBN 978-9928-126-33-7

